



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

TEMA E DOKTORATËS

**“INSTITUCIONET PUBLIKE NË FUNKSION TË MBROJTJES SË DREJTAVE
DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS”**

Mentori:

Prof. Dr. Etem Aziri

Kandidati:

LLM. Petrit Hajdari

Datë: Korrik 2022

PËRMBAJTJA

Abstrakti	7
Hyrje	10
INSTITUCIONET PUBLIKE NË FUNKSION TË MBROJTJES SË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....	12
Metodologjia e hulumtimit	15
Të dhënat e mbledhura primare dhe sekondare.....	17
Rishikimi i literaturës	18
Hipotezat e hulumtimit	19
Rëndësia e problemit studimor.....	20
Qëllimet e këtij punimi, dhe hulumtimit të kësaj teme janë	21
Lista e akronimeve dhe shkurtesave	22
KREU I PARË: “MEKANIZMI DHE SISTEMI INSTITUCIONAL I SHTETIT”	24
Parimi i ndarjes së pushtetit shtetëror (Pushteti Legjislativ, Ekzekutiv-administrativ dhe pushteti Gjyqësor;	25
Raporti ndërmjet tri degëve të pushtetit shtetëror – bilanci dhe kontrolli reciprok’.	27
Sistemi Institucional në Republikën e Kosovës.....	29
Organet qendrore dhe vetëqeverisja lokale;.....	30
Administrata Shtetërore – publike në Republikën e Kosovës	34
KREU I DYTË: “SISTEMI KUSHTETUES DHE LEGJISLATIV I FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONEVE SHTETËRORE”	36
Kushtetuta e Republikës së Kosovës si bazë për funksionimin e institucioneve shtetërore;.....	37
Funksionimi i institucioneve shtetërore mbi bazën e parimeve kushtetuese;	38
Legjislacioni i brendshëm dhe raporti me të drejtën ndërkombëtare;.....	41
Pushteti Ekzekutiv – administrativ si mekanizëm kushtetues dhe legjislativ;.....	42
Vetëqeverisja lokale si sistem i veçantë i pushtetit shtetëror.....	44
KREU I TREË: “DISKUTIMI TEORIK DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT”	47
Zhvillimi historik i të drejtave të njeriut	48
Burimet ligjore për të drejtat e njeriut.....	51
Konsiderimi subjektiv dhe objektiv i të drejtave të njeriut.....	53
Funksionet e të drejtave të njeriut.....	54

Efekti juridik i të drejtave të njeriut	56
Standardet ndërkombëtare	58
Instrumentet kryesore ndërkombëtare.....	60
Mekanizmat institucional ndërkombëtar.....	66
KREU I KATËR: “MBROJTJA DHE GARANTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SISTEMIN JURIDIK TË KOSOVËS”	69
Sistemi kosovar i të drejtave të njeriut.....	70
Inkorporimi i standardeve ndërkombëtare	71
Katalogu kushtetues: Kapitujt II dhe III	74
Legjislacioni dhe zbatimi i tij	79
Respektimi i standardeve ndërkombëtare dhe parimeve kushtetuese për të drejtat e njeriut nga institucionet publike në Republikën e Kosovës.....	80
Gjykata Kushtetuese dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.....	81
Të drejtat dhe liritë sipas sistemit të rregullt gjyqësor	86
Pamundësia e ngritjes së çështjes në Gjykatën e Strasburgut.....	87
Roli i avokatit të popullit;	89
Roli i mekanizmave parlamentar: Komisioni i të drejtave të njeriut dhe për të drejtat dhe interesat e komunitetit	106
KREU I PESTË:TË DREJTAT E NJERIUT: ASPEKTE KRAHASUESE.....	107
Republika e Kroacisë	107
Republika e Sllovenisë.....	109
Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës	110
Republika e Maqedonisë së Veriut	111
Republika e Malit të Zi	112
KREU I GJASHTË: PJESA EMPIRIKE –PYETËSORI DHE INTERVISTAT.....	114
Pyetëtori.....	114
Intervistat e planifikuara dhe të realizuara;.....	133
Përfundime dhe Rekomandime.....	145
Shtojca.....	151
Literatura.....	183

Titulli punues i temës:

**“INSTITUCIONET PUBLIKE NË FUNKSION TË MBROJTJES SË DREJTAVE
DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS”**

Përkthimi i titullit në gjuhën angleze:

**“PUBLIC INSTITUTIONS IN THE FUNCTION OF PROTECTING
FUNDAMENTAL HUMAN RIGHTS AND FREEDOMS IN THE REPUBLIC OF
KOSOVO”**

Përkthimi i titullit në gjuhën maqedonase:

**“ЈАВНИТЕ ИНСТИТУЦИИ ВО ФУНКЦИЈА НА ЗАШТИТА НА ОСНОВНИТЕ
ЧОВЕКОВИ ПРАВА И СЛОБОДИ ВО РЕПУБЛИКА КОСОВО”**

Une, Rrustem Gërguri, me profesion gjuhëtar-lektor, nën përgjegjësi morale dhe materiale, në datë 28.04.2022, jap këtë;

DEKLARATË

Me të cilën deklaroj se kam lekturuar temën me titull: "INSTITUCIONET PUBLIKE NË FUNKSION TË MBRQITËS SË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS", në kandidatit Petrit Hajdari.

Pejë, 28.04.2022

LEKTORI
Emri dhe mbiemri
Rrustem Gërguri





UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

DEKLERATA E STUDENTIT PËR PUNË ORIGJINALE

Me këtë deklaratë, unë Petrit Hajdari me përgjegjësi te plotë deklaroj se:

është punim i imi origjinal dhe pune individuale e imja nën monitorimin e Prof.Dr: Etem AZIRI ;

është rezultat i punës sime hulumtuese, kontribut origjinal;

të gjitha burimet e shfrytëzuara janë cituar komform rregullave akademike;

punimi në tersi apo pjesë të punimit nuk janë kopjuar nga punimet e tjera dhe njëherit as nuk është prezantuar dhe botuar deri tani nga ndonjë institucion tjetër.

Ky punim i diplomës vlen për ciklin e studimeve _____ dhe ka titullin:

**“INSTITUCIONET PUBLIKE NË FUNKSION TË MBROJTJES SË DREJTAVE
DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS”**

Tetovë, më __/__/____

Studenti/Nënshkrimi

Abstrakti

Vërtet gjysma e dytë e shekullit XX mund të quhet edhe pesëdhjetëvjeçari i të drejtave të njeriut. Janë dhjeta akte juridike ndërkombëtare të miratuara gjatë kësaj periudhe kohore, dhe gjithashtu me qindra akte shtetërore. Sidoqoftë, trajtimi i të drejtave të njerut vazhdon edhe sot e kësaj dite, dhe paraqet një relevancë të jashtëzakonshme në politikën ndërkombëtare. Duke pasur parasysh të kaluarën historike të Kosovës, dhe vizionin e orientimin e sajë drejt Bashkimit Evropian, Kosova është përqendruar te mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut. Në këtë punim të diplomës, janë trajtuar mekanizmat dhe kapacitetet institucionale, si dhe aktet juridike të drejtave të njeriut në mënyrë të posaçme në Republikën e Kosovës, si dhe aspekti krahasues me vendet e rajonit. Republika e Kosovës tashmë ndodhet në një rrugëtim të mirë, natyrisht me sfida të ndryshme në procesin e shtetndërtimit, demokratizimit dhe integritimit në organizatat ndërkombëtare.

Abstract

Indeed, the second half of the twentieth century can also be called the fiftieth anniversary of human rights. There are dozens of international legal acts adopted during this time period, and also hundreds of state acts. However, the treatment of human rights continues to this day, and presents an extraordinary relevance in international politics. Given Kosovo's historical past, state-building circumstances and aspirations towards European Union integration, Kosovo has paid particular attention to human rights and freedoms. In this Master's thesis, the institutional mechanisms and capacities are treated, as well as the human rights legislation in particular in the Republic of Kosovo, as well as the comparative aspect with the countries of the region. The Republic of Kosovo is already on a good path, of course with various challenges in the process of state building, democratization and integration into international organizations.

Апстракт

Несомнено, втората половина на XX век може да се смета како период на придавање се поголема значајност на човековите права и слободи. Во овој период се имаат донесено десетици меѓународни како и стотици национални правни акти во областа на заштитата на основните човекови права и слободи. Но, и во современиот свет, проблематиката на човекови права и слободи нема воопшто изгубено во значајност, и има прераснато во значаен фактор при структурирање и водење на меѓународните политики. Имајќи го предвид историското минато на Република Косово и нејзините стремехи за приклучување кон Европската Заедница, сосема е разбирлива значајноста која Косово ја придава на заштитата на човековите права и слободи. Имајќи го ова предвид, во рамки на докторската дисертација се разработени институционалните механизми и капацитети, како и правната рамка за заштита на човековите права и слободи, со посебен осврт кон реалните состојби во Република Косово. Покрај ова, понудени се споредбени анализи на состојбата во Република Косово и други земји од регионот. Како што покажува трудот, Република Косово е на прав пат, се разбира имајќи ги предвид и предизвиците кои ја следат земјата во целокупноста на активностите за изградба на својата државност, демократизација и зачленување во меѓународни тела и организации.

Hyrje

Bota ka ndryshuar pas dy luftërave botërore. Shtetet kanë filluar një qasje të re në jetën politike dhe bashkëpunimin midis tyre. Por, për të arritur deri në këtë nivel, për ta krijuar një qasje të re dhe pozicionim të ri të qenies njerëzore ndaj strukturave shtetërore - pushtetit, mekanizëm për të mbrojtur të drejtat themelore të njeriut e mbi gjitha për ekzistencën e tij, për përcaktimin e standardit të jetës së tij, u deshtë të humbin shumë jetë njerëzish në dy luftëra të mëdha globale brenda gjysmë shekulli.

Vlen të theksohet se mendimi dhe konceptimi i të drejtave është i lidhur me nocionin specifik të shtetit dhe të së drejtës në përgjithësi e në veçanti të asaj pozitive të shteteve specifike, në të cilin një vendin qëndror e nxen individi respektivisht njeriu si qenje humane, respekti ndaj dinjitetit të tij apo të saj dhe avancimi i këtyre të drejtave është mbi të mirën e grupit dhe të shtetit. Andaj, në këtë drejtim, theksimi i themeleve ekstra-juridike të së drejtës pozitive dhe modelimi i sistemit juridik në bazë të respektimit të të drejtave të njeriut ndihmon që të pengohet degjenerimi i së drejtës pozitive në “paligjshmëri juridike” (Piechowiak, 1999).

Qindra akte juridike ndërkombëtare dhe shtetërore, që rregullojnë çështje të ndryshme të këtyre të drejtave, janë miratuar që nga përfundimi i luftës së dytë botërore. Po ashtu, janë themeluar institucione të ndryshme ndërkombëtare, si dhe brenda shteteve që trajtojnë ekskluzivisht të drejtat e njeriut. Është me rëndësi për tu theksuar se, me të drejtë shkruan Marek Piechowiak, thekson se “shteti (neni 81) modern, zakonisht karakterizohet si një shtet demokratik ku sundon ligji dhe i cili realizon një politikë të përshtatshme për qytetarët i bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut saj. Këto aspekte gjithmonë duhet të shikohen në një kontekst më të gjerë në mënyrë që asnjëri të mos bëhet absolut. Demokracia, e cila i përkrah para së gjithash për shkak se individi, qenia njerëzore është personalitet i lirë dhe qenie racionale (një qenie “e pajisur me arsye dhe vetëdije”), nuk mund të kuptohet si përparësi absolute e vullnetit të shumicës së njerëzve”(Piechowiak,1999).

RKS-ë në rrugëtimin e saj të shtet ndërtimit dhe prosperitetit demokratik, si dhe orientimi i saj drejtë integritimeve euro-atlantike, legjisllacionin e vet e ka përshtatur respektivisht sinkronizuar në tërësi me aktet juridike ndërkombëtare, ku trajtim të veçantë u kushtohet të drejtave të njeriut. Para së gjithash, Kushtetuta e RKS-sës ka paraparë aplikimin direkt të të drejtave juridike ndërkombëtare. Duke pasur parasysh rrjedhat historike dhe

problemet me komunitetin serbë, kapitulli i tretë i Kushtetutës i kushtohet posaçërisht të drejtave të komuniteteve.

Punimi trajton mekanizmin institucional në mënyrë analitike dhe komparative, institucionet shtetërore dhe kushtetuese të Kosovës dhe krahasimin me vendet e tjera të rajonit dhe në veçanti me shtetet e ish-Jugosllavisë, si dhe institucionet e vetëqeverisjes lokale. Në punim, po ashtu, trajtim të posaçëm u është bërë akteve ndërkombëtare dhe jetësimit të tyre në Republikën e Kosovës, institucioneve dhe mekanizmave të tjerë që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në këtë drejtim, në kreun e parë të punimit, është trajtuar mekanizmi dhe sistemi institucional i shtetit. Parimi i ndarjes së pushtetit shtetëror në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Gjithashtu raportit ndërmjet këtyre pushteteve si dhe harmonizimi dhe kontrolli i tyre. Po ashtu, trajtim këtu gjënë edhe sistemi institucional shtetëror, organet qendrore dhe vetëqeverisja lokale, si dhe administrata shtetërore – publike në Republikën e Kosovës.

Në kreun e dytë të punimit janë trajtuar sistemi kushtetues dhe legjislativ i funksionimit të institucioneve shtetërore. Ku saktësohet mënyra e funksionimit të institucioneve shtetërore sipas Kushtetutës si akti themelor juridik i shtetit. Më pastaj, funksionimi i institucioneve shtetërore mbi bazën e parimeve kushtetuese, legjislacioni i brendshëm dhe raporti me të drejtën ndërkombëtare, më pastaj Pushteti Ekzekutiv – administrativ si mekanizëm kushtetues dhe legjislativ, si dhe vetëqeverisja lokale si sistem i veçantë i pushtetit shtetëror.

Në Kreun i tretë dhe i katërt flitet ekskluzivisht për jetësimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës, për standardet dhe aktet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe implementimin e tyre në Republikën e Kosovës. Po ashtu flitet për realizimin kushtetues të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe institucionet shtetërore që merren me jetësimin e këtyre lirive dhe të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.

INSTITUCIONET PUBLIKE NË FUNKSION TË MBROJTJES SË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS”

Kushtetuta e RKS-sës në nenin e parë të saj, e përkufizon shtetin si:

- RKS-ë është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm.
- RKS-ë është shtet i shtetasve të vet.
- RKS-ë ushtron autoritetin e saj bazuar respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj.(rks-gov..net)

Të zgjedhurit e popullit të Kosovës të tubuar në Kuvendin si organ përfaqësues i popullit, kanë venë parim themelor “respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve dhe të gjithë individëve brenda shtetit”. Kjo bëhet me qëllim që të dëshmojë përkushtimin e shtetit të ri në respektimin e standardeve më të larta evropiane dhe botërore.

RKS-ë si shtet i ri, synon t’i bashkëngjitet dhe të jetë pjesë e integriteteve evropiane dhe botërore të shtetit të ri. Kjo qasje bëhet me arsye, ngase Kosova synon të ndërtojë një shtet të mirëfilltë demokratik, që bazohet dhe respekton vlerat më të mira të demokracisë. Te shtetit të së drejtës si dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka paraparë dy kapituj për të drejtat dhe liritë themelore, përkatësisht kapitulli i dytë (2) “Të Drejtat dhe Liritë Themelore”, dhe kapitulli tre (3) “Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre”. Në këtë mënyrë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, hyn në rangun e akteve kushtetuese moderne dhe model për shumë vende të botës për bazën e mirë kushtetuese të përcaktuar për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.(md.rks-gov.net, 2019) Kosova është shembull për bazën shumë të mirë kushtetuese dhe ligjore në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve si dhe pjesëtarëve të tyre. Të drejtat e privileguara të garantuara me Kushtetutë, kanë bërë të krijohet termi **“Diskriminim pozitiv”**.

Kushtetuta ka shkuar përtej bazës juridike të brendshme dhe ka pranuar instrumentet ndërkombëtare të cilat garantojnë të drejtat dhe liritë themelore. Përkatësisht neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, të njëjtat garantohen me Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- 7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.”

Kosovës, nuk i ka nënshkruar asnjë nga këto konventa ndërkombëtare, por i ka inkorporuar direkt në legjisllacionin e Kosovës. Ky veprim tregon një rast të pa precedent të zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare në legjisllacionin e brendshëm.

Duke marrë parasysh kuadrin kushtetues të brendshëm dhe inkorporimin e instrumenteve ndërkombëtare në të drejtën e brendshme, punimi analizon funksionimin e këtyre akteve në territorin e Republikës së Kosovës.

Fokusi i punimit përqendrohet tek analiza, doktrinarë e bazës kushtetuese të sistemit kombëtar (të Republikës së Kosovës) për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore. Si dhe kompetencat dhe në rolin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në interpretimin e Kushtetutës në aspektin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Në punim është përfshirë analiza krahasuese me disa vende të rajonit (Sllovenia, Kroacia, Maqedonisë Veriore, Malit të Zi, Bosnja dhe Hercegovina Analiza krahasuese me

disa vende të rajonit ,mundëson të krijojmë një pasqyrim gjithëpërfshirës të dallimeve dhe përputhshmërisë së sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë dhe vendeve të përfshira në analizë.

Punimi synon t'i vë në pah përparësitë dhe të tregoi efektet pozitive të zbatimit të akteve juridike për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe problemet me të cilat përballlet ky vend në zbatimin e standardeve ndërkombëtare.

Në punim është përfshirë edhe hulumtimi empirik kuantitativ i cili është realizuar me qytetarë të moshave madhore, sipas mostrës së rastit. Me qëllim që të jetë në tërësi i kompletuar hulumtimi empirik, janë realizuar edhe intervista me struktura të ndryshme institucionale të shoqërisë: profesorë nga fusha e lirive dhe të drejtave të njeriut, dhe udhëheqës të institucioneve të cilat merren me promovimin këtyre të drejtave.

Punimi përbehet nga pjesa hyrëse (qëllimet, objektivat, pyetjet hulumtuese, hipotezat shkencore dhe metodologjia), nga rishikimi i literaturës dhe pjesa hulumtuese empirike.

Rishikimi i literaturës përbëhet prej katër kapitujve dhe kapitullit të pestë aspekti krahasues me vendet e rajonit.

Në kreun e parë **“MEKANIZMI DHE SISTEMI INSTITUCIONAL I SHTETIT”**, do të trajtohet parimi i ndarjes së kompetencave përkatëse të pushtetit shtetëror. Përkatësish ndarja e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësori mekanizma institucional me kompetenca dhe detyra të ndara. Në këtë pjesë do të analizohet raporti ndërmjet këtyre institucioneve, i **ashtuquajturi** parimi i balancës dhe kontrollit reciprok. Gjithashtu, në këtë pjesë do të shtjellohet mekanizmi institucional në Republikën e Kosovës pasi që përbën objekt të veçantë të studimit.

Në kreun e dytë: **“SISTEMI KUSHTETUES DHE LEGJISLATIV I FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONEVE SHTETËRORE”**, - do të trajtohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës si bazë për funksionimin e institucioneve shtetërore; Funksionimi i institucioneve shtetërore mbi bazën e parimeve kushtetuese; Legjislacioni i brendshëm dhe raporti me të drejtën ndërkombëtare; Pushteti ekzekutiv – administrativ si mekanizëm kushtetues dhe legjislativ; Vetëqeverisja lokale si sistem i veçantë i pushtetit shtetëror.

Në kreun e tretë **“DISKUTIMI TEORIK DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT”**, është bërë analizë e zhvillimit historik i të drejtave të njeriut, burimet juridike kryesore të cilat garantojnë liritë dhe të drejtat individuale. Përfillja e

konsiderimit subjektiv dhe objektiv i të drejtave të njeriut, funksionet e tyre dhe efekti juridik i të drejtave të njeriut.

Në kuadër të kësaj pjese, është paraqitur një pasqyrim i përgjithshëm i standardeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Në kreun e katër “**MBROJTA DHE GARANTIMI I TE DREJTAVE TE NJERIUT NË SISTEMIN JURIDIK TË KOSOVËS**”, ky kapitull përfshin kryesisht diskutimet themelore të këtij punimi, ku dhe është analizuar kuadri kushtetues i lirive dhe të drejtave themelore në RKS-ë. Theksi i këtij kapitulli, përkatësisht i kësaj pjesë është përqendruar në: Sistemi Kosovar i të drejtave të Njeriut; Përfshirja e standardeve ndërkombëtarë; Katalogu kushtetutës: Kapitujt II dhe III; Legjislacioni dhe zbatimi i tij; Respektimi i standardeve ndërkombëtare e kushtetuese për të drejtat e njeriut nga institucionet publike në Republikën e Kosovës; Gjykata Kushtetuese dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në RKS-ë; Te drejtat dhe liritë sipas sistemit të rregullte gjyqësor; Pamundësia e ngritjes së çështjes në Gjykatën e Strasburgut; Roli i Avokatit të Popullit; Roli i mekanizmave parlamentar: Komisioni i te drejtave te njeriut dhe për te drejtat e komuniteteve.

Në kreun e pestë “**TË DREJTAT E NJERIUT: ASPEKTE KRAHASUESE**”, është bërë krahasimi i sistemit kushtetues të Kosovës me atë të disa vendeve të rajonit si: Republika e Kroacisë; e Sllovenisë; e Bosnjës dhe Hercegovinës; e Maqedonisë Veriore; dhe Republika Malit të Zi.

Kreu i gjashtë përbëhet prej dy pjesë: **Hulumtimi në terren dhe intervistat me individë dhe njohës me përvojë** – studiues të fushës së të drejtave të njeriut dhe udhëheqës të institucioneve, të cilët merren me të drejtat e njeriut.

Në kapitullin e parë të pjesës empirike (analiza kuantitative)do të realizohet hulumtimi me qytetar të moshave nga 18 deri në 65 vite, sipas mostrës së rastit. Hulumtimi është realizuar në shtatë qendrat kryesore të Republikës së Kosovës.

Në fund do të bëhet paraqitja grafike e rezultateve të hulumtimit, gjetjet dhe diskutimi – interpretimi i rezultateve të hulumtimit

Metodologjia e hulumtimit

Përzgjedhja e metodologjisë shkencore adekuate në kërkimin shkencor është një sfidë më vete dhe shumë e rëndësishme. Realizimi i këtij punimi do të mbështetet në metodat si në vijim:

Metoda e kërkimit doktrinar përkon në shfaqjen sistematike të parimeve dhe vlerave, mbi të cilat është ndërtuar dhe është zhvilluar drejtësia kushtetuese dhe e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut,. Nga kjo pikëpamje dhe në këtë drejtim duke u marrë me analizën e marrëdhënieve midis këtyre parimeve vlerave kushtetuese dhe instrumenteve ndërkombëtare.

Metoda historike -Studimi ka për qëllim të identifikojë, bazuar në metodën e kërkimit historik, komponentën historike në të cilin kanë lindur parimet kushtetuese dhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Punimi është bazuar edhe në **metodat empirike të kërkimit (cilësor dhe sasior)**.

Metoda sasimore - Krahas analizës analitike dhe përshkruese – rishikimit të literaturës dhe kuadrit juridik, punimi e pasqyron edhe hulumtimin empirik të realizuar me qytetarë të Republikës së Kosovës. Për hulumtim është përdorur mostra e rastit me qytetarë të moshave nga 18 deri në 65. .Hulumtimi ka për qëllim të mat perceptimin e qytetarëve për sfondin e të drejtave dhe lirive individuale në Republikën e Kosovës.

Metoda cilësore –për ta kompletuar hulumtimin empirik kemi përdorur edhe metodën sasimore si metodë jo probabilitare, ku kemi përzgjedhur mostrën e qëllimshme. Pra kemi përzgjedhur ekspertë që i përkasin fushës së të drejtave të njeriut dhe të së drejtës kushtetuese, të cilët dhe do t'i intervistojmë për temën tonë të doktoratës.

Intervistat do të zhvillohen ballë për ballë me të intervistuarit, në ambiente të institucioneve të caktuara. Informatat e marra nga këto intervista do të inkorporohen në punim. Kjo formë e aplikimit të metodës cilësore është bërë me qëllimi që të gjenerohen të gjetura sa më origjinale, që njëkohësisht konsiderohen edhe primare.

Metoda e kërkimit dhe analizës së jurisprudencës kushtetuese - është një nga metodat më të rëndësishme të hulumtimit shkencor. Kjo metodë shërben për të krahasuar dhe kuptuar mënyrën e interpretimit të Kushtetutës që i bëjnë Gjykata Kushtetuese e RKS-ë në lidhje me mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të njeriut në vend. Kjo metodë konsiston fillimisht në kërkimin e vendimeve kryesore dhe specifike të vlerave kushtetuese, me theks të veçantë vlerat që shërbejnë për mbrojtjen e të drejtave dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

Metoda e krahasimit – Kjo metodë synon që të bëj krahasimin përmes evidentimit të ngjashmërive dhe dallimeve të sistemit kushtetues, të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të njeriut të Republikës së Kosovës, me atë të disa vendeve të rajonit, siç janë: Republika e Kroacisë, R.e Sllovenisë, e Bosnjës dhe Hercegovinës, R. e Maqedonisë Veriore dhe Republika e Malit të Zi.

Qëllimi i trajtimit krahasues, është identifikimi i veçorive të tyre këtyre sistemeve, pikave përafruese dhe dalluese. Gjithashtu, në plan të kësaj analize krahasuese ka qenë edhe identifikimi i ndikimit që mund të ketë ushtruar sistemi kushtetues i ndonjërit nga këto vende në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës. Ky punim do të rishikohet me përkushtim dhe do të ketë edhe një shqyrtim në frymë kritike të sistemit tonë kushtetues në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore. Kjo metodë vlen për të kuptuar më mirë gjithashtu nëse ka edhe dallime specifike për çështje të ngjashme në sistemet kushtetuese të këtyre vendeve.

Të dhënat e mbledhura primare dhe sekondare

Në këtë hulumtim të dhënat e mbledhura janë primare dhe sekondare:

1. Të dhënat primare janë ato burime të literaturës të cilat do t'i tubojë vet autori i hulumtimit duke përdorur një metodë të mbledhjes të përshtatshme për llojin e të dhënave që do të mblidhen. Këto të dhëna janë mbledhur përmes metodës së grup fokusit me akterë institucional, përfshirë këtu gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese në RKS-ë, këshilltarët juridik që veprojnë pranë kësaj gjykate, hartues të kushtetutës, e po ashtu edhe hartuesit e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të RKS-sës dhe profesorë universitar. Teknikat për sigurimin e të dhënave primare janë edhe intervistat gjysmë të strukturuar me të lartë cekurit, si dhe anketimi i individëve tjerë me përgjegjësi shtetërore dhe jo shtetërore në Republikën e Kosovës.

1. Të dhënat sekondare janë publikimet nga Gjykatat Kushtetuese, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komisioni i Venecias dhe organizata tjerat vendore dhe ndërkombëtare që merren me hulumtimin e jurisprudencës kushtetuese.

Rishikimi i literaturës

Rishikimi i literaturës është pjesa që realizohet pas Hyrjes dhe Metodologjisë. Rishikimi i literaturës i referohet shqyrtimit teorik të koncepteve themelore të temës së hulumtimit, duke cituar autor të njohur vendor dhe ndërkombëtar.

Në këtë pjesë teoritë kryesore do të trajtohen për aspektin kushtetues të të drejtave të njeriut, në veçanti në RKS-ë, si shtet i ri i cili synon të bëhet pjesë e mekanizmave ndërkombëtare.

Hipotezat e hulumtimit

Hipotezat kryesore të punimit janë:

1. Institucionet publike në Republikën e Kosovës janë të përkushtuara gjerësisht në Mbrojtjen e Lirive Themelore të Njeriut.
2. Akti më i lartë juridik i ngërthen standardet ndërkombëtare në fushën e problematikës në fjalë.
3. Gjykata Kushtetuese e RKS-ë, ndjek dhe ndërmerr aktivitete ,gjegjësisht vlerëson dhe gjykon në raste të shkeljeve eventuale të drejtave dhe lirive të njeriut .
4. Shteti i ligjor në RKS-ë, është në shërbim të njeriut dhe mbrojtjes së lirive individuale në përputhjeje Kushtetutën dhe ligjet e vendit.
Kosova, krahasuar me vendet e rajonit, avancoon në kontekst të garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare.

Nga pyetjet kërkimore të cilave punimi u jep përgjigje dallojmë:

1. Të drejtat e njeriut, a janë kategori universale që burojnë nga e drejta natyrore dhe instrumentet juridike vendore dhe ndërkombëtare?
2. A ekziston shteti i së drejtës – shteti ligjor në mungesë të sistemit adekuat të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të individit?
3. Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, a ka sistem kushtetues Republika e Kosovës ?
4. Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut a zbatohen në Republikën e Kosovës?

5. Gjykata Kushtetuese a përbën mekanizëm më efektiv për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore dhe forcimin e shtetit të së drejtës?
6. A gëzojnë të drejta kushtetuese komunitetet jo shumicë në Republikën e Kosovës?
7. A kanë Institucionet e Kosovës mekanizma efektiv për përkrahjen e OJQ-ve ,sa i përket mbrojtjes se të drejtave të lirive dhe të ju dalë në ndihmë OJQ-ve?
8. Avokati i Popullit a përbën mekanizëm më efektiv për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe forcimin e shtetit të së drejtës?

Fjalët kyçe:

Të drejtat e njeriut; sistem kushtetues, instrumente ndërkombëtare, Kosovë, etj.

10. Fusha e studimeve

Kjo tezë e disertacionit të doktoratës bënë pjesë në kuadër të fushës së studimeve pesëqindënëntë (509), Qeverisja dhe Administrimi Publik, sipas fraskatit.

11. Rëndësia e problemit studimor

Tema e propozuar për punim doktrate në kuadër të programit studimor Qeverisja dhe Administrata Publike, në Universitetin e Evropës Juglindore është **“Institucionet publike në funksion të mbrojtjes së drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovës”**.

Qëllimet e këtij punimi, dhe hulumtimit të kësaj teme janë:

- » Analizimi i institucioneve juridiko kushtetuese dhe funksionimi i tyre në RKS-ë;
- » Për t`u njohur dhe kuptuar forma e organizimit shtetëror, dhe mënyra e realizimit të akteve juridike dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës;
- » Në kontekst të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe krahasimi i tyre me vendet e tjera fqinje dhe më gjerë, të njihen ndryshimet legislative në RKS;
- » Mbrojtja juridiko-kushtetuese e të drejtave dhe lirive të njeriut në RKS-ë, analizimi dhe arritjet që ka bërë Kosova ndër vite;
- » Bashkëpunimi i Republikës së Kosovës, ndërinstucional dhe ndërkombëtar në realizimin e të drejtave të njeriut .

Parime fundamentale të demokracisë liberale dhe shtetit të së drejtës, janë të drejtat dhe liritë themelore të individit. Ato janë parime bazë mbi të cilin funksionon demokracia liberale, mishërohen vlerat njerëzore dhe respektohet qenia humane.

Shteti i Kosovës është një shtet i ri dhe po kalon fazën e ndërtimit të institucioneve demokratike dhe krijimit të një sistemi juridik në harmoni me vlerat civilizuese dhe parimet e të drejtës ndërkombëtare. Në këtë aspekt vendi ynë, sistemin kushtetues e ka ndërtuar në bazë të Planit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, i njohur si “Pakoja e Ahtisaarit”. Ky plan ka paraparë përcaktime kushtetuese të bazohen në vlerat perëndimore dhe universale të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, dhe të komuniteteve jo shumicë në vend. Punimi përbën një analizë krahasuese me vendet e rajonit dhe përpiqet të shpjegojë pikat për afruese dhe dalluese të sistemit kushtetues të Kosovës me vendet e krahasuara.

Një Gjykatë Kushtetuese kredibile ka ndërtuar Kosova, e cila është autoriteti kyç në RKS-ë për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën (Kosoves, n.d.), dhe mbron të drejtat dhe liritë themelore. *Kjo gjykatë, përveç këtyre funksioneve, kujdeset edhe për kohezionin dhe rendit kushtetues, konsolidon dhe forcon shtetin e së drejtës dhe demokracinë liberale.*

Ky punim doktorate përbën, një trajtim shkencor përkushtues dhe serioz ,duke artikuluar ndërlidhje ndërmjet të drejtës administrative, drejtës kushtetuese, të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe zbatimit të parimeve kushtetuese dhe ndërkombëtare brenda Republikës së Kosovës.

Rëndësia e punimit konsiston në vlerësimin e zbatueshmerisë së standardeve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës, të proklamuar dhe të vendosura në Kushtetutë dhe legjislacionin pozitiv të Kosovës.

Andaj ky punim synon të shërbejë si një kontribut shkencor për sistemin kushtetues të RKS-ë në garantimin dhe mbrojtjen e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut.

Lista e akronimeve dhe shkurtesave:

DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuar
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNHCR	Komisariati i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNIFEM	Fondi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuar për Gratë
BE	Bashkimi Evropian
KDF	Konventa e të Drejtave të Fëmijës
KEDKG	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KKMPK	Konventa Kornizë e Mbrojtjes së Pakicave Kombëtare
PNDKP	Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike
UNMIK	Misioni i Administrimit të Përkohshëm në Kosovë

OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
KNKK	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
KRK	Kushtetua e Republikës së Kosovës
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KDF	Konventa për të drejtat e fëmijëve
KE	Këshilli i Evropës
KDESK	Komiteti i drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore
KEDNG	Konventa për eliminimin e diskriminimit ndaj grave
KEDS	Komiteti evropian i të drejtave sociale
KERJ	Komisioni evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës
KSR	Karta sociale evropiane (e revizionuar)
KADNJ	Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut
KADNJP	Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve
KEDR	Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor
AP	Asambleja e Përgjithshme e OKB-së
KS	Këshilli i Sigurimit i OKB-së
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut

KREU I PARË

MEKANIZMI DHE SISTEMI INSTITUCIONAL I SHTETIT

Shteti mund të konsiderohet si organizimi më i mirë shoqëror që ka arritur shoqëria njerëzore. Sot, mund të thuhet pa mëdyshje se, nuk ka asnjë pjesë tokë në gjithë globin që nuk është pjesë e ndonjë shteti, apo që nuk kontrollohet nga ndonjë shtet. Në këtë mënyrë “rendi politik, ekonomik e shoqëror mbarë njerëzor është i organizuar në kuadër të shtetit dhe rendi botëror konsiston në marrëdhëniet ndërmjet shteteve” (Baliqi, 2017, p. 71). Shtetet përmes mekanizmave të tyre institucionale zbatojnë pushtetin politik dhe juridik duke mbajtur rendin dhe sigurinë publike brenda territorit të caktuar.

Në aspektin historik, shteti është zhvilluar gradualisht dhe është paraqitur në trajta të ndryshme të pushtetit politiko-juridik. Siç thekson edhe Fadakinte, “në analizat politike, nga koha antike në atë moderne, shteti, si koncept, ka dalë gjithnjë në pah, madje edhe sot, çështja mbizotëruese për politikën është shteti (Fadakinte, 2013, p. 552)”. Duke pasur parasysh kompleksitetin e konceptit të shtetit, me të drejtë shkruan edhe Fukuyama, ku veç tjerash thekson se “shteti është një organizatë hierarkike, e centralizuar që mban monopolin e forcës legjitime mbi një territor të përcaktuar. Përveç karakteristikave të tilla si kompleksiteti dhe përshtatshmëria, shtetet mund të jenë pak a shumë jo personale: shtetet e hershme nuk dalloheshin nga familja e sundimtarit dhe përshkruheshin si "patrimoniale" sepse favorizonin dhe punonin përmes familjes dhe miqve të sundimtarit. Përkundrazi, shtetet moderne, më të zhvilluara, bëjnë një dallim midis interesit privat të sundimtarëve dhe interesit publik të të gjithë komunitetit. Ato përpiqen të trajtojnë qytetarët mbi një bazë më jo personale, duke zbatuar ligje, rekrutuar zyrtarë dhe duke ndërmarrë politika pa favorizime” (Fukuyama, 2014, p. 1). Në këtë kuptim, konstaton në mënyrë të drejtë Fadakinte kur thekson se, “sot, koncepti i

shtetit është përdorur aq gjerësisht në një mënyrë të pakoordinuar sa që dikush fillon të pyesë se çfarë do të thotë sepse mënyra se si studiuesit / filozofët / teoricienët kanë përdorur dhe analizuar konceptin e bën atë kaq të përgjithshëm sa nuk është konkretisht i rëndësishëm” (Fadakinte, 2013, p. 552).

Së këndejmi, shtetet kanë krijuar mekanizma dhe institucione të ndryshme në realizimin e politikave të tyre shtetërore, dhe në vazhdimësi i kanë përsosur ato. Është për tu përmendur se funksionimi i institucioneve shtetërore në të gjitha shtetet demokratike është rregulluar me kushtetutë dhe ligje, dhe funksionojnë mbi bazën e parimeve të përcaktuara në to. Në lidhje me shtetin dhe të drejtën, teoricienti Marek Piechowiak shprehet me shumë të drejtë duke theksuar se, “shteti dhe e drejta ekzistojnë për individin i cili jeton në shoqëri. Shteti dhe e drejta janë mjete për mbrojtje të individit nga ajo që të trajtohet si një mjet i thjeshtë dhe e përkrahin krijimin e kushteve për zhvillimin e gjithanshëm të tij/saj. Detyrat e tjera të shtetit u nënshtrohen funksioneve dhe mund të realizohen vetëm përbrenda kufijve të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore” (Piechowiak M. , 1999, p. 11). Shpjegimi i Marek, tregon saktësisht rëndësinë e pakontestueshme që ka shteti për njerëzit që jetojnë brenda një shteti, si dhe sa e vështirë është jetesa pa një organizim shtetëror.

1. Parimi i ndarjes së pushtetit shtetëror (Pushteti Legjislativ, Ekzekutiv-administrativ dhe pushteti Gjyqësor)

Ndarja e pushteteve nënkupton përcaktimin e detyrave për secilin pushtet dhe mosndërhyrjen në punët e pushtetit tjetër, duke funksionuar mbi bazën e kushtetutës dhe ligjeve pozitive të vendit përkatës. Në aspektin e paraqitjes dhe zhvillimit historik, “shekujt XVII dhe XVIII shënuan pikën kryesore, padyshim, politike dhe teorike të konceptimit ‘të pastër’ të ndarjes së pushteteve. Në një kohë të ngritjes së inatit ndaj ortodoksisë shtypëse të monarkive absolute dhe rregullit jo përfaqësues, përshkrimi i idealizuar i Monteskjeut të organeve angleze të jetës publike si një paradigmë e qeverisjes së drejtë dhe të ekuilibruar, shërbeu si model për ata që kërkonin të reformonin ose zëvendësonin sistemet ekzistuese të shtetit” (Carolan, 2009, p. 18). Konform ndarjes së pushteteve, vlen të përmendet se edhe “nacionet origjinale kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe funksioneve bazoheshin jo vetëm në "ndarjen e pushteteve", por edhe në një koncept të "qeverisë së ekuilibruar" dhe "kontrolleve dhe ekuilibrave" gjithashtu” (Kurland, 1986, p. 593).

Të gjitha kushtetutat demokratike përmbajnë parimin e ndarjes së pushteteve duke i veçuar pushtetin Legjislativ, pushtetin ekzekutiv dhe pushtetin Gjyqësor. Në këtë drejtim kushtetuta e RKS-ë në nenin 4 paragrafi 1, ka paraparë se Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre (neni 4, par.1), në mënyrë të njëjtë është paraparë edhe në kushtetutat e vendeve tjera të rajonit, kështu kushtetuta e Shqipërisë në nenin 7 ka paraparë se sistemi i qeverisjes në Repu Shqipërië bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, kushtetuta e Maqedonisë së Veriut në nenin 8 ka listuar vlerat themelore të rendit kushtetues të këtij shtetit ku një ndër këto vlera përmendet edhe ndarja e pushtetit shtetëror në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, njëjtë është e paraparë edhe në kushtetutën e Malit të Zi e cila është miratuar pas shkëputjes përfundimtare nga Serbia, të cilat patën mbetur si të fundit që përbënin ish Jugosllavinë, në nenin 11 të kësaj kushtetute thuhet “pushteti është i organizuar sipas parimit të ndarjes së pushtetit në: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Pushtetin legjislativ e kryen Kuvendi, pushtetin ekzekutiv e kryen Qeveria, kurse atë gjyqësor gjykatat”.

Po ashtu, edhe kushtetutat e vendeve tjera të ish Jugosllavisë parashohin parimin e ndarjes së pushteteve. Në këtë mënyrë kushtetuta e Republikës së Kroacisë në nenin 4 ka paraparë se, në Republikën e Kroacisë qeverisja do të organizohet mbi parimin e ndarjes së pushtetit në pushtetin legjislativë, ekzekutivë dhe gjyqësor, por gjithashtu e kufizuar nga e drejta e garantuar me kushtetutë për vetëqeverisjen lokale dhe rajonale. Gjithashtu edhe kushtetuta e Sllovenisë në paragrafin e dytë të nenit 3, ka paraparë që pushteti është i dhënë te njerëzit, dhe qytetarët e ushtrojnë këtë pushtet drejtpërdrejt dhe përmes zgjedhjeve, me parimin e ndarjes së pushtetit si: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Mënyrë e ngjashme e ndarjes së pushteteve është e paraparë edhe në kushtetutat e vendeve të Bashkimit Evropian. Pra, parimi i ndarjes së pushteteve është edhe parim kushtetues, andaj në këtë drejtim “Kushtetuta përcakton parimet dhe mekanizmat e përgjithshëm e të posaçëm të organizimit të shtetit. Ajo krijon institucionet e qeverisë duke ndarë pushtetet mes tyre në mënyrë që vënia e rregullit të fillojë që nga mekanizmat shtetërore. Zakonisht pushtetet që u jepen institucioneve shtetërore kufizohen dhe vendoset një mekanizëm ndër-kontrolli mes tyre duke ruajtur kështu ekuilibrin e funksionimit normal të tyre. Pra, pushtetet ndahen nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm kështu që kompetencat apo pushtetet e këtyre institucioneve janë të kufizuara në fushën në të cilën është përcaktuar që institucioni të funksionojë” (Zaganjori, Anastasi, & Çani, 2011, p. 12).

Ndarja e pushteteve në atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, është e ngjashme edhe në shtetet federative. Në këtë kontekst vlen të përmendet ndarja e pushteteve në SHBA, ku një nga karakteristikat e qeverive kombëtare dhe shtetërore në Shtetet e Bashkuara është ekzistenca e tri departamenteve të ndara, legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit, secili i koordinuar dhe kryesisht i pavarur nga të tjerët. Është Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara e cila përcakton tri departamente të tilla, Kongresin me pushtet legjislativ, Presidentin me pushtet ekzekutiv dhe Gjykatën e Lartë dhe gjykatat e tjera të Shteteve të Bashkuara të krijuara me ligj, me pushtet gjyqësor. Gjithashtu, vlen të theksohet se secila prej kushtetutave të shtetit parashikon gjithashtu tri departamente të ngjashme në pushtetin shtetëror (Fairlie, 1923, p. 393).

2. Raporti ndërmjet tri degëve të pushtetit shtetëror – balanci dhe kontrolli reciprok

Parimi i ndarjes së pushtetit nënkupton në të njëjtën kohë edhe balancimin dhe mosndërhyrjen në punët e njëri tjetrit, përveç çështjeve të bashkëpunimit dhe kontrollit të paraparë me Kushtetutë dhe ligje. Natyrisht, puna e të tri pushteteve është e ndërlidhur. Pushtetet janë të balancuara por njëkohësisht edhe ushtrojnë kontroll kushtetues dhe ligjor ndaj njëri tjetrit. Në këtë kontekst Kushtetuta nevojitet jo vetëm për të përshkruar në mënyrë të qartë ato, por edhe t'i kufizojë ato, prandaj për realizimin e këtij qëllimi ndihmon shumë edhe kontrolli që kanë pushtetet ndaj njëri tjetrit nëpërmjet mënyrave të përcaktuara qartë në Kushtetutë (Fairlie, 1923, p. 13). Veç tjerash vlen të theksohet se, “ndarja e pushteteve bën të mundur realizimin dhe zgjidhjen e problemeve me një efikasitet shumë të madhe. Një mënyrë e tillë bën që gjithçka të jetë më e lirë nga pikëpamja e kostos, duke kërkuar gjithashtu një konsum kohe shumë më të pakët. Përfitimet janë shumë të mëdha parë edhe nga këndvështrimi i abuzimeve dhe arbitraritetit si dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive. Kështu mbrohen më mirë individët, pra duke përcaktuar qartë pushtetet, duke përcaktuar kufijtë e ushtrimit të tyre dhe mekanizmin e kontrollit mbi to” (Fairlie, 1923, p. 13).

Pra, detyrat dhe kompetencat e pushteteve legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor janë të përcaktuara me kushtetutë. Se këndejmë, “parë nga perspektiva e teorisë kushtetuese, Kushtetuta e një vendi, natyrisht, supozohet të sigurojë një kornizë legjitime ligjore për ushtrimin e pushtetit shtetëror. Gjatë hartimit të një kushtetute, duhet të bëhen disa "zgjedhje kushtetuese" në lidhje me krijimin e institucioneve të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe

gjqësor dhe mënyrën se si ato lidhen me njëri-tjetrin, si dhe marrëdhëniet e individëve ose grupeve ‘vis avis’ autoritetet shtetërore dhe ndërmjet tyre, i ashtuquajtur ‘efekt horizontal’ i rregullimeve të të drejtave të njeriut dhe të pakicave” (Marko, 2008, pp. 437-438).

Kushtetutat demokratike të cilat parashohin ndarjen e pushteteve, zakonisht funksionin legjislativ e ka parlamenti, funksionin ekzekutiv qeveria dhe funksionin gjyqësor e kryejnë gjykatat. Në këtë mënyrë Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar se “Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës” (neni 4, par. 2-6 të Kushtetutës së RKS). Në kontekst të kontrollit midis pushteteve, Kushtetuta i jep mjaftë kompetenca Kuvendit të Republikës konformë pushteteve tjera. Mund të thuhet se shumica e institucioneve publike derivojnë nga Kuvendi i Republikës. Në këtë drejtim, Kushtetutat e Republikës së Kosovës përpos funksionit legjislativ ka paraparë edhe këto kompetenca të Kuvendit:

- vendos të ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;
- shpall referendum,
- ratifikon traktatet;
- miraton Buxhetin e RKS-së;
- zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët;
- zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës
- zgjedh Qeverinë;
- mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike,
- zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe të Këshillit Prokurorial
- propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese;
- mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë;

- jep pëlqimin për dekretin e Presidentit mbi shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme;
- vendos për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj (neni 65, par. 2-14 të kushtetutës së RKS).

Kompetenca thuaj se të ngjashme i atribuohen parlamenteve nga të gjitha kushtetutat demokratike të cilat parashohin ndarjen e pushteteve dhe kontrollin midis tyre. Për fund, kur jemi te raporti ndërmjet tri pushteteve vlen të theksohet se “kur tek i njëjti person ose i njëjti organ, pushteti legjislativ është bashkuar me atë ekzekutiv, atëherë nuk ka më liri, sepse mund të supozohet se i njëjti monark ose i njëjti senat miraton ligje tiranike, për t’i zbatuar më vonë po në mënyrë tiranike. Nuk ka liri nëse pushteti gjyqësor nuk është i ndarë nga pushteti legjislativ dhe nga pushteti ekzekutiv. Nëse ai i bashkëngjitet pushtetit legjislativ, e drejta e jetës dhe liria e qytetarëve do të trajtoheshin në mënyrë arbitrare, sepse gjyqtari do të jetë edhe ligjvënës” (Zaganjori, Anastasi, & Çani, 2011, p. 29).

3. Sistemi Institucional në Republikën e Kosovës

Secili shtet e ka të ndërtuar sistemin e vet institucional. Sistemi institucional në vendin tonë është i përcaktuar nga Kushtetuta e RKS-ë. Respektivisht, “struktura e Kushtetutës së re të Kosovës ndjek kushtetutat moderne demokratike duke siguruar, pas preambulës, një sërë "dispozitash themelore" të ndryshme në kapitullin I pasuar nga një katalog i të drejtave të njeriut në kapitullin II, dhe të drejtat e bashkësive (etnike) dhe anëtarëve të tyre në kapitullin III. Kapitujt IV deri VIII përshkruajnë strukturat institucionale të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit” (Marko, 2008, p. 443).

Sipas Kushtetutës, RKS-ë ka këtëorganizim institucional: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, Sistemi i Drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese, po ashtu, në kuadër të sistemit institucional është i paraparë edhe organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale. Gjithashtu me Kushtetutë janë të parapara edhe institucionet e pavarura ku bëjnë pjesë: Avokati Popullit, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, Banka Qendrore e Kosovës, Komisioni i Pavarur i Mediave dhe Agjencitë e Pavarura. Në këtë drejtim shihet qartë se “përveç institucioneve me të cilat identifikohet ndarja e balancimi i tri pushteteve nga neni 4 i Kushtetutës, ekzistojnë edhe organe tjera kushtetuese, të pavarura dhe të mandatuara me norma kushtetuese, që kanë për qëllim të shërbejnë si lehtësues dhe kontrollues i levave të

pushtetit shtetëror në të gjitha nivelet me qëllim të realizimit efektiv të parimit kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve” (Bajrami, et al., 2019, p. 60).

Veç tjerash, vlen të theksohet se “kapitulli i XII i Kushtetutës përbën bazën kushtetuese për themelimin e institucioneve, komisioneve dhe agjensioneve të pavarura të cilat luajnë rol të rëndësishëm në moderimin e pushtetit publik në Kosovë. Në këtë qasje të re të neutralizimit, e lindur si pasojë e rritjes së nevojave të shtetit për rregullim të shpejtë të jetës dhe aktiviteteve tjera shtetërore dhe me qëllim të ruajtjes së individit dhe lirisë së tij, vendet e Evropës kanë ndërtuar edhe rregullativë administrative të nivelit evropian. Kjo e bën këtë mënyrë të neutralizimit të pushtetit shtetëror mjaft specifik” (Bajrami, et al., 2019, p. 62).

4. Organet qendrore dhe vetëqeverisja lokale

Pjesa më e madhe e institucioneve publike i takojnë organeve qendrore. Ajo që vlen të theksohet në këtë rast, një gamë e gjerë e organeve të cilat janë organe kushtetuese, si dhe një pjesë e madhe e organeve tjera derivojnë nga Kuvendi i RKS-sës.

Në këtë rast do të trajtojmë shkurtimisht disa nga organet më të rëndësishme të nivelit qendrorë të Republikës së Kosovës, e që relevancë të veçantë kanë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe pushteti gjyqësor duke përfshi edhe Gjykatën Kushtetuese si një nga institucionet gjyqësore që konsiderohet ‘gardian i Kushtetutës’.

Kuvendi i RKS-sës – Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar që “Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli” (neni 63). Kjo do të thotë se Kuvendi është organi përfaqësues i qytetarëve dhe institucioni ligjvënës në vend. Është e rëndësishme të përmendet që ndër kompetencat e rëndësishme që i jepet Kuvendit, është kompetenca kushtetutbërëse. Po ashtu, vlen të përmendet në këtë rast se kompetencë e Kuvendit sipas nenit 65 të Kushtetutës është edhe zgjedhja e Presidentit të Republikës dhe mundësia e shkarkimit të tij në pajtim me Kushtetutën, si dhe zgjedhja e qeverisë dhe mundësia e shprehjes së mosbesimit ndaj saj.

Presidenti i RKS-sës – është një nga organet kushtetuese të Republikës i cili zgjidhet nga Kuvendi i Republikës. Kushtetuta e RKS-sës në nenin 83 përcakton që “Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës”. Në këtë drejtim “në

rolin e tij si kreu i shtetit, Presidenti i Republikës kryen funksione kryesisht formale, në të cilat parimisht vihet në rolin e konfirmuesit ceremonial të vendimeve të organeve tjera të shtetit dhe, në parim, nuk ndërhyt në çështje të natyrës partiake. Nën këtë supozim, Presidenti i Republikës, në rolin e kreut të shtetit, konfirmon vendime duke qëndruar mbi palët dhe thjesht për interesat e përgjithshme të shtetit” (Bajrami, et al., 2019, p. 63).

Qeveria e RKS-sës – është një nga organet kushtetuese të shtetit dhe ushtron pushtetin ekzekutiv në Republikën e Kosovës. Me Kushtetutë është përcaktuar se:

1. Qeverinë e përbëjnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat.
2. Qeveria e ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligj.
3. Qeveria zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe ushtron veprimtari tjera brenda përgjegjësive të përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.
4. Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo (neni 92, par. 1-4).

Nga këtu rrjedh se “sipas këtij neni, Qeveria është bartëse e pushtetit ekzekutiv, duke shtuar që ky është funksion origjinal i qeverisë. Megjithatë, i njëjti nen vendos kufijtë e ushtrimit të pushtetit ekzekutiv të qeverisë, duke përcaktuar që kushtetuta dhe ligjet e shtetit përcaktohet si limite të të njëjtit pushtet” (Bajrami, et al., 2019, p. 63).

Pushteti gjyqësor – nga ndarja e pushteteve, gjyqësori paraqet degën e tretë të pushtetit shtetërorë. Edhe Kushtetuta e Kosovës duke jetësuar parimin e ndarjes së pushteteve, pushtetin gjyqësor e rëndit në tri pushtetet e rëndësishme shtetërore, në neni 4 paragrafin 5 të Kushtetutës së Kosovës përcaktohet se “pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat”. Kapitulli i VII i Kushtetutës e rregullon sistemin e Drejtësisë në Republikën e Kosovës, ku janë përcaktuar parimet e përgjithshme, organizimi i sistemit gjyqësor.(rks-gov..net)

Gjykata Kushtetuese – gjykata kushtetuese paraqet një institucion gjyqësor më vete. Në këtë drejtim, me të drejtë theksohet se, “fizionomia e Gjykatës Kushtetuese dhe specifikat e saj themelore përcaktohen nga dy faktorë. I pari ka të bëjë me atë se ajo nuk paraqet pjesë të sistemit gjyqësor e as pjesë të sistemit të drejtësisë kosovare, por një pushtet i krijuar, *pouvoir constitué*, e ndarë nga pjesët e tjera të pushtetit. Në këtë kuptim, ajo paraqitet si një organ

shtetëror që kryen punë sipas autorizimit shprehimor kushtetues, me një dallim që bën kontrollin e kushtetutshmërisë së punës së tjerëve, dhe faktori i dytë që përcakton fizionominë e Gjykatës lidhet me juridiksionin e saj nga neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës. Ky juridiksion përcaktohet qartë me Kushtetutë dhe nuk duhet të caktohet nga askush tjetër, përfshirë këtu vetë Gjykatën Kushtetuese” (Bajrami, et al., 2019).

Institucionet e Pavarura – gjithashtu duhet përmendur se ndër institucionet që paraqesin rëndësi të theksuar janë edhe institucionet e pavarura, të cilat po ashtu kanë bazë kushtetuese dhe ligjore. E rëndësishme është të theksohet se “institucionet e pavarura janë një përbërës kryesor i një demokracie funksionale. Së bashku me legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin, ato ofrojnë një sistem të përpunuar të kontrollit dhe ekuilibrit” (OSCE, 2012). Në këtë rast, po ashtu vlen të dallojmë ekzistencën e dy llojeve të institucioneve të pavarura që veprojnë në Kosovë: (1) ato që kryejnë mbikëqyrje mbi pajtueshmërinë e qeverisë me qeverisjen e mirë dhe standardet e të drejtave të njeriut, të tilla si Institucioni i Avokatit të Popullit, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe (2) agjencitë dhe rregullatorët të cilët kryejnë një funksion rregullator, licencues ose kauza-gjyqësor siç janë Komisioni i Pavarur për Media dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë (OSCE, 2012).

Sa i përket institucioneve të pavarura në **RKS-ë**, po ashtu, duhet theksuar që “në teori, institucionet e pavarura tentojnë të respektojnë praktikën më të mirë ndërkombëtare në lidhje me themelimin dhe funksionimin. Krijimi i tyre ka baza të shëndosha ligjore, ndërsa mandatet individuale të institucioneve përcaktohen më tej nga ligjet specifike dhe legjislacioni sekondar” (OSCE, 2012). Veç tjerash, duhet përmendur edhe ajo që pavarësisht se ekzistojnë konturat ose një kornizë e qëndrueshme ligjore, risia relative e institucioneve të pavarura krijon një numër paqartësish operationale dhe ligjore. Ka mungesë të legjislacionit sekondar që është thelbësor në sqarimin e roleve dhe përgjegjësisë të institucioneve të prekura, dhe aktualisht, boshllëqet në kornizën ligjore pengojnë punën e rreth një të tretës së institucioneve të pavarura. Së këndejmi, në një numër rastesh, mangësitë ligjore paraqesin një sfidë serioze për zbatimin e mandatit të institucioneve (OSCE, 2012).

Përveç organizimit institucional qendror, ekziston edhe organizimi i vetëqeverisjes lokale e cila është e ndërtuar mbi bazë kushtetuese dhe ligjore. Sipas Kushtetutës organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale është i organizuar në njësi themelore, ku njësi themelore është Komuna. Sipas Kushtetutës “Komunat gëzojnë shkallë të lartë të

vetëqeverisjes lokale dhe njëherit inkurajojnë të sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale” (neni 124, par. 1). Bazë e funksionimit, statusit dhe kompetencave të Komunës është ligji për vetëqeverisjen lokale. Në bazë të këtij ligji është përcaktuar statusi ligjor i komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale. Organizimi dhe funksionimi i organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndër komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror (neni 2, par. 1).

Sa i përket vetëqeverisjes lokale, është e rëndësishme të përmendet edhe miratimi i Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në vitin 1985, e cila vetëqeverisjen lokale e definon si të drejtë dhe aftësi të autoriteteve lokale, brenda kufijve të ligjit, për të rregulluar dhe menaxhuar një pjesë të konsiderueshme të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interesat e popullatës lokale (neni 3, par. 1). Në këtë rast duhet përmendur po ashtu se “aktivitetet e vetëqeverisjes lokale bazohen në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, si dhe në respektimin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale” (Hasani & Čukalović, 2013, p. 54).

Gjithashtu, në këtë rast vlen të përmendet se, me qëllim të zbatimit të kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës u inkorporuan dispozitat e saj, në nivel të njëjtë të obligimeve me vendet që kanë nënshkruar dhe ratifikuar Kartën. Përveç kësaj, u miratuan ligjet bazike për vetëqeverisje lokale duke përfshirë: Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave, Ligjin për Zgjedhjet Lokale, si dhe Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal (SVL - MAPL, 2016, p. 14). Karta angazhon Palët të zbatojnë rregullat themelore që garantojnë pavarësinë politike, administrative dhe financiare të autoriteteve lokale. Me këtë dhe parashihet që parimi i vetëqeverisjes lokale do të njihet në legjislacionin e brendshëm dhe, kur është e mundur, në kushtetutë.

5. Administrata Shtetërore – publike në Republikën e Kosovës

Para së gjithash administrata shtetërore nënkupton edhe shërbim. E gjithë puna në administratën shtetërore kryhet vetëm për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe realizimin e politikave qeveritare për zhvillimin normal të jetës së qytetarëve. Vlen të thuhet se “administrata publike nuk duhet të shihet vetëm si strukturë ku zbatohen ligjet, por edhe si strukturë nga ku formulohen dhe propozohen politika për vendimmarrësit. Prandaj, një administratë publike profesionale dhe efektive mundëson një zbatim të mirë të politikave (policy execution), por edhe një mekanizëm ku formulohen propozime për politika dhe programe për vendimmarrësit (policy formulation)” (Instituti GAP, 2015, p. 4).

Në këtë kontekst me të drejtë thekson edhe Valdete Haliti, e cila shkruan që “secili shtet synon të praktikojë veprimtarinë e tij shtetërore (pushtetin ekzekutiv) në një mënyrë të tillë që qytetarëve të tij t'u ofrohet shërbimi publik në mënyrën më cilësore të mundshme. Si rezultat, një administratë publike cilësore, e qëndrueshme ndaj çdo ndikimi dhe transparente me qytetarët e saj, është një domosdoshmëri që secili shtet duhet ta realizojë” (Haliti, 2018, p. 1). Gjithashtu, është e vlefshme të theksohet se, “administrata publike është koncept më i gjerë se sa administrata shtetërore, dhe si e tillë përfshinë administratat e institucioneve përtej atyre me kompetenca ekzekutive. Korniza ligjore e administratës publike përbëhet nga një numër i madh i akteve juridike, duke filluar nga Kushtetuta, pastaj ligjet dhe aktet nënligjore” (Haliti, 2018, p. 1). Në këtë kuptim, shprehet sakte Elvis Zaimi i cili thekson se “modeli i shërbimit nënkupton një filozofi të re jo autoritare të shtetit, ku qytetari është “përdoruesi” i “shërbimit publik” (arsyeja e lëshimit të një certifikatë për qytetarin është e ndryshme nga ajo e caktimit të një takse të re), po ashtu, modeli i “përfaqësimit të interesave”, nënkupton ridimensionimin e marrëdhënies administrative klasike dypalëshe organ publik - subjekt privat, në të cilën i dyti u nënshtrohet rregullave të nxjerra nga i pari, në një marrëdhënie trepalëshe (institucion rregullator-subjekt privat-subjekte të tjera private), ku subjektet u binden rregullave të nxjerra nga institucioni jo në dobi të një interesi publik të pakufizuar, por në dobi të një pjese të subjektsh të tjera private, në përfitim të të cilëve janë nxjerrë rregullat” (Zaimi, 2015, p. 15).

Duhet theksuar se Kushtetuta nuk ka përcaktuar se cilat janë organet e administratës publike në Kosovë, dhe as nuk përmban ndonjë dispozitë me të cilën proklamohet organizata e administratës publike në Kosovë. Sidoqoftë, shpallja e shtetit të së drejtës me Kushtetutën si

një parim dhe vlerë e shoqërisë ka një rëndësi të madhe për funksionimin e administratës publike, sepse administrata publike përkatësisht shërbimet publike janë realizuar nga shteti përmes administratës publike, nuk nënkupton asgjë përveç funksioneve të pushtetit shtetëror, qëllimi i të cilave është krijimi dhe ofrimi i kushteve për fuqizimin e të drejtave të qytetarëve në raport me shtetin. Këto shërbime kryesisht kanë karakter administrativ dhe si të tilla janë pjesë e konceptit të shtetit ligjor (Haliti, 2018, p. 1). Gjithashtu me të drejtë konstaton edhe Renee Prunty, i cili thekson se “krijimi dhe roli i administratës publike nuk adresohen domosdoshmërisht në kushtetuta, por të gjitha qeveritë prodhojnë administratë publike si një funksion të domosdoshëm të funksionimit të tyre të përditshëm. Administrata publike konsiderohet përgjithësisht pjesë e degës ekzekutive, megjithëse shpesh funksionon në mënyrë të pavarur dhe më shpesh përfshin funksione të shumëfishta” (Prunty, 2016).

Administrata shtetërore e Republikës së Kosovës funksionon mbi bazë të ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura. Me ligjin për organizimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura janë përcaktuar rregullat për funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi . Sipas ligjit Administrata shtetërore, është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave. Gjithashtu ligji përcakton se, Administrata shtetërore përbëhet nga struktura hierarkike të organizuara, nën drejtimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e Qeverisë (neni 8, par. 1-2). Po ashtu, sipas ligjit Administrata shtetërore përbëhet nga Zyra e Kryeministrit, sistemet ministrore dhe agjencitë rregullatorë(neni 9, par. 1).

KREU I DYTË

SISTEMI KUSHTETUES DHE LEGJISLATIV I FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONEVE SHTETËRORE

Institucionet shtetërore dhe publike në të gjitha shtetet demokratike funksionojnë mbi bazë të Kushtetutës dhe ligjeve. Në këtë drejtim përjashtim bëjnë vetëm shtetet totalitare, ku autoriteti i sundimitarit është fjala e fundit për çdo gjë.

Kosova, gjatë njëzet viteve të paluftës (1999-2020), ka ndërtuar sistemin kushtetues dhe legjislativ konformë standardeve bashkohore demokratike. Historia e zhvillimit të sistemit kushtetues dhe demokratik nuk ka filluar me kushtetutën e vitit 2008, e cila është miratuar pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, po megjithatë mund të thuhet se “pas një përvoje të gjatë nën sisteme totalitare dhe jo demokratike, Kosova përfundimisht me Kushtetutën e vitit 2008 fillon vënien në jetë në mënyrë efektive të një organizimi institucional të pushtetit shtetëror të bazuar në ndarjen horizontale dhe vertikale të pushtetit” (Bajrami, et al., 2019, p. 59). Ndër aktet kushtetuese të Kosovës në aspektin historik vlen të përmenden: Ligji Kushtetues i Kosovës i vitit 1969, Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës e vitit 1974, si dhe Kushtetuta e RKS-ë e vitit 1990. Vlen të theksohet se, Kosova ka proklamuar pluralizmin politikë dhe ka organizuar zgjedhje edhe gjatë viteve të 90-ta nën represionin e regjimit të serbisë.

Pasi lufta ka shënuar fillimin e një zhvillimi të ri politikë dhe juridik për Kosovën, e posaçërisht periudha pas shpalljes së pavarësisë shënon ndërtimin normal të institucioneve shtetërore të Kosovës. Fillimin e ndërtimit të sistemit kushtetues pas përfundimit të luftës e paraqet Korniza Kushtetuese që ishte e implementuar si rregullore e UNMIK-ut 2001/9. “Ky akt është i natyrës konstitucionale dhe synon të përcaktojë bazat e rendit kushtetues të Kosovës në periudhën e administrimit ndërkombëtar. Miratimi i Kornizës Kushtetuese ka filluar procesin e ndërtimit të institucioneve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në Kosovë. Ndërsa, baza juridike për nxjerrjen e kësaj Kornize Kushtetuese është përcaktuar në Rezolutën 1244, që parasheh ushtrimin e një qeverisjeje të mirëfilltë (substanciale) për Kosovën gjatë periudhës kalimtare” (Bajrami, et al., 2019, pp. 22-23).

Korniza Kushtetuese paraqet bazën kryesore, apo aktin më të lartë ligjor gjatë periudhës tranzitore deri në zgjidhjen e statusit final. “Qëllimi kryesor i këtij akti kushtetues ishte krijimi i një baze kushtetuese të funksionimit të shtetit, e cila do të mundësonte edhe krijimin e një rendi kushtetues dhe institucional të vendit. Njëherësh gjatë kohës sa ka qenë në fuqi Korniza Kushtetuese ajo ka qenë burimin kryesor të së drejtës kushtetuese në tranzicion, e cila ka qenë e zbatueshme në Kosovë deri në vitin 2008, respektivisht deri në shpalljen e pavarësisë. Nuk mund të mohohet fakti që bazuar në Kornizën Kushtetuese Kosova ka pasur edhe një të drejtë kushtetuese (një tërsi të normave dhe institucioneve) të cilët e kanë pasur bazën dhe burimin kryesor në Kornizën Kushtetuese” (Bajrami, et al., 2019, p. 23).

1. Kushtetuta e RKS-ë si bazë për funksionimin e institucioneve shtetërore

Kushtetuta e RKS-sës paraqet aktin themelor, dhe aktin më të lartë ligjor të funksionimit të institucioneve shtetërore të **RKS-sës**. “Parë nga perspektiva e teorisë kushtetuese, Kushtetuta e një vendi pa dyshim duhet të sigurojë një kornizë legjitime ligjore për ushtrimin e pushtetit shtetëror. Gjatë hartimit të një kushtetute, duhet të bëhen disa ‘zgjedhje kushtetuese’ në lidhje me krijimin e institucioneve të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe mënyrën se si ato lidhen me njëri-tjetrin, si dhe marrëdhëniet e individëve ose grupeve ‘*vis a vis*’ autoriteteve shtetërore dhe midis tyre, i ashtuquajtur ‘efekt horizontal’ i rregullimeve të të drejtave të njeriut dhe të pakicave” (Marko, 2008, pp. 437-438). Në këtë drejtim, duke u dhënë një përparësi dhe vend të rëndësishëm lirive dhe të drejtave të njeriut, Kosova ka përshtatur aspektin multietnik. Andaj, “nuk është për t’u habitur që preambula e Kushtetutës së Kosovës fillon me frazën ‘Ne, populli i Kosovës [...]’ duke ndjekur shembullin e Kushtetutës së SH.B.A.-së pas Deklaratës Amerikane të Pavarësisë” (Marko, 2008, p. 438).

Meqenëse Kushtetuta është bazë e sistemit juridik të një vendi, nga ajo rrjedhë i tërë sistemi juridik i shtetit. Prandaj të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me Kushtetutën. “Kushtetuta përcakton parimet themelore politike, strukturën, procedurën, fuqinë dhe përgjegjësitë e institucioneve më të larta politike në vend” (Hasani & Čukalović, 2013, p. 6).

Rregullimi institucional si dhe ndarja e pushteteve paraqet pjesën më të vlefshme të Kushtetutës, andaj me të drejtë thuhet se, “çështja e institucioneve shtetërore dhe e ndarjes së pushtetit përbën një ndër segmentet më të rëndësishme kushtetuese. Kjo prek thelbin e

pushtetit shtetëror nisur nga fakti se nga mënyra e organizimit të tij varet shumë cilësia e qeverisjes në një vend” (Bajrami, et al., 2019, p. 59).

Funksionimi i tri pushteteve, pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe pushtetit gjyqësor, bazën themelore të funksionimit të tyre e kanë në Kushtetutë. Në kuptim të kësaj, kapitulli i IV i Kushtetutës ka përcaktuar parimet e funksionimit dhe strukturën organizative të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kapitulli i V ka paraparë statusin dhe kompetencat e presidentit të Republikës, si dhe Kapitulli i VI ka përcaktuar parimet dhe kompetencat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kapitulli i VII ka përcaktuar parimet bazë të sistemit të drejtësisë dhe mënyrën e organizimit të gjykatave, ndërsa kapitulli i VIII ka përcaktuar parimet e përgjithshme dhe organizimin e Gjykatës Kushtetuese si institucion i veçantë gjyqësor.

Gjithashtu, bazë kushtetuese të funksionimit gjejnë edhe shumë institucione të tjera publike, si institucionet e sigurisë të përcaktuara në kapitullin e XI të Kushtetutës, si dhe një grup mjaft i gjerë i institucioneve të pavarura siç janë përcaktuar në kapitullin XII të Kushtetutës.

2. Funksionimi i institucioneve shtetërore mbi bazën e parimeve kushtetuese

Të gjitha institucionet shtetërore funksionojnë mbi bazë të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi. Kushtetuta pa dyshim është baza themelore konform së cilës nxjerren të gjitha aktet e tjera normative. Institucionet shtetërore para së gjithash në punën e tyre duhet të zbatojnë normat dhe parimet kushtetuese.

Si çdo kushtetut tjetër demokratike edhe Kushtetuta e Kosovës përmbanë disa nga parimet juridike më të rëndësishme, prej të cilave vlen të përmenden:

Parimi i sundimit të ligjit—Ky parim nënkupton që institucionet shtetërore dhe publike duhet të punojnë konformë ligjeve pozitive të shtetit. Më saktësisht “sundimi i ligjit është një koncept që përshkruan autoritetin suprem të ligjit mbi veprimet qeveritare dhe sjelljen individuale. Ajo korrespondon me një situatë kur të dy, qeveria dhe individët, janë të detyruar nga ligji dhe janë në përputhje me të. Është, antiteza e sundimit tiranik ose arbitrar” (Valcke, 2012, p. 1). Në aspektin e zhvillimit historik të këtij parimi, “sundimi i ligjit ka evoluar me shekuj dhe është i lidhur pazgjidhshmërisht me zhvillimet historike që kanë çuar në shfaqjen graduale të demokracive liberale dhe mënyrat e tyre themelore të qeverisjes dhe

sistemeve ligjore” (Valcke, 2012, p. 2). E udhës të theksohet në këtë rast është se, ky parim i paraparë në Kushtetutën e Kosovës “përbën një detyrim ndërkombëtar dhe kushtetues të Kosovës. Si detyrim ndërkombëtar, ai është i mishëruar në Deklaratën e Pavarësisë, e cila në pikën nën dy flet për zotimin e Kosovës për të respektuar përbërësit kryesorë të konceptit të sundimit të ligjit, siç janë shpallja e Kosovës si shtet demokratik, laik dhe multietnik, mosdiskriminimi dhe barazia para ligjit, mbrojtja, respektimi dhe promovimi i lirive dhe të drejtave njerëzore dhe zotimi se shteti i Kosovës do të krijojë kushtet për pjesëmarrje efektive të bashkësive etnike në proceset politike dhe në proceset tjera shoqërore. Si detyrim kushtetues i Kosovës, ndërkaq, parimi i sundimit të ligjit paraqitet fuqishëm në nenin e tretë dhe të shtatë të kapitullit të parë të Kushtetutës: në nenin e tretë, ky parim shkrihet me parimin e barazisë para ligjit, kurse në të shtatin bëhet fjalë për grupin e vlerave themelore kushtetuese mbi të cilat qëndron rendi kushtetues kosovar” (Bajrami, et al., 2019, pp. 50-51).

Parimi i mosdiskriminimit dhe barazisë– vet emërtimi i këtij parimi na jep të kuptojmë se kemi të bëjmë me trajtimin e barabartë (jo-barabartë) midis njerëzve. Parimi i barazisë, pra mosdiskriminimit, është i paraparë në Konventat më të rëndësishme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe në të gjitha kushtetutat e vendeve demokratike. Po ashtu, “edhe parimi i mosdiskriminimit dhe i barazisë përbën një detyrim ndërkombëtar dhe kushtetues të Kosovës. Si i tillë, ky parim hyn në përbërësit kryesor të parimit të sundimit të ligjit: së bashku përbëjnë një shtyllë serioze kundër arbitraritetit shtetëror. Njëjtë si në rastin e parimit të sundimit të ligjit, parimi i mosdiskriminimit dhe i barazisë nuk mund të shërbejë si bazë e vetme, e ndarë nga një shkelje konkrete e një të drejte kushtetuese, për vënien në lëvizje të proceduareve ligjore dhe kushtetuese. Kjo do të thotë se çdoherë duhet të ketë shkelje të një të drejte kushtetuese për të ekzistuar diskriminimi apo cënimi i parimit të sundimit të ligjit në sferën e diskriminimit” (Bajrami, et al., 2019, pp. 51-52).

Parimi i laicitetit–Ndarja e fesë nga shteti është çështjet mjaft serioze dhe të rëndësishme, për vet faktin e ndarjes së çështjeve apo sferës publike me çështjet apo sferën private. Shumica e kushtetutave demokratike e parashohin eksplicit laicitetin, apo saktësisht ndarjen e punëve të shtetit dhe çështjet fetare. Kështu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka paraparë se, “RKS-ë është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare” (neni 8). Edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashih qe “në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare. Shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike” (neni 10, par. 1 dhe 2). Ngjashëm edhe Kushtetutat e Malit të Zi përcakton se “bashkësitë fetare janë të ndara nga shteti. Bashkësitë fetare janë të

barabarta dhe të lira në kryerjen e ceremonive dhe punëve fetare” (neni 14). Po ashtu edhe Kushtetuta e Sllovenisë ka përcaktuar në mënyrë të ngjashme se “shteti dhe bashkësitë fetare do të jenë të ndara. Komunitetet fetare do të gëzojnë të drejta të barabarta, dhe ata do të ndjekin aktivitetet e tyre lirish” (neni 7). Nga kjo rrjedh se liria e besimit është e garantuar por e ndarë nga punët shtetërore. Bashkësitë fetare kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre, por nuk u lejohet të cenojnë të drejtën shtetërore.

Parimi i multi-etnicitetit– duke pasur parasysh trendet bashkohore, dhe në mënyrë të posaçme shtetndërtimin e Kosovës, parimi i multietnicitetit paraqet një relevancë tejet të theksuar. Duhet kuptuar faktin që “dimensioni multi-etnik i shoqërisë globale, si dhe realitetet e vetme lokale hapin një seri problemesh rreth disa pyetjeve thelbësore për bashkëjetesën ndëretnike dhe integrimin” (Continia & Maturua, 2010, p. 1538). Prandaj në këtë kontekst “parimi i multietnicitetit përbën një ndër parimet bazë të rendit kushtetues të Kosovës. I futur në Kushtetutë si pjesë e detyrimit ndërkombëtar të marrë përsipër me Deklaratën e Pavarësisë, ky parim është shtylla kryesore e detyrimit kushtetues për të ndërtuar një shoqëri që akomodon interesat, liritë dhe të drejtat e të gjitha komuniteteve etnike, fetare, gjuhësore dhe të komuniteteve tjera në Kosovë” (Bajrami, et al., 2019, pp. 53-54).

Parimi i prezumimit të pafajësisë–Ky parim zënë vend të veçantë në drejtësinë penale, dhe është ndër parimet kryesore të procedurës penale, me të cilin nënkuptohet se personi i akuzuar nuk është fajtor deri në fund të procedurës penale kur vendimi gjyqësor të merr formën përfundimtare. Për më tepër ky parim zënë vend të rëndësishëm edhe në të drejtat e njeriut. Kështu që këtë parim e ka paraparë edhe Konventa Evropiane për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ku theksohet se “çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht” (neni 6, par. 2). Kjo do të thotë se pa marrë parasysh ekzistimin e dyshimit për kryerjen e veprës penale, personi nuk guxon të konsiderohet fajtorë përderisa kjo nuk vërtetohet nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Po ashtu, sa i përket këtij parimi vlen të theksohet se “prezumimi i pafajësisë manifestohet në dy drejtime në atë se barra e proves bie mbi organin e akuzës dhe i akuzuari nuk ka detyrim të vërtetoj pafajësinë e tij, por i njëjti ka të drejtë të prezantoj prova shfajësuese kurse drejtimi i dytë në realizimin e prezumimit të pafajësisë me parimin in dubio pro reo që të gjitha provat e dyshimta shkojnë në favor të akuzuarit” (Shkodra & Zekaj, 2019, p. 12).

Parimi Ne Bis in Idem –Ashtu si parimi i prezumimit të pafajsisë, edhe ky parim zënë vend të rëndësishëm në drejtësinë penale. Parimi ne bis in idem është një parim i përgjithshëm i drejtësisë penale në shumë vende juridike kombëtare, ndonjëherë edhe i kodifikuar si e drejtë kushtetuese. Gjithashtu është i vendosur si një e drejtë individuale në instrumentet ligjore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Parimi ne bis in idem është përpunuar historikisht si një parim që zbatohet vetëm në shkallë kombëtare dhe është i kufizuar në drejtësinë penale. Lidhur me përmbajtjen e parimit, tradicionalisht bëhet një dallim midis *nemo debet bis vexari pro una et eadem causa* (askush nuk duhet të përballet me më shumë se një ndjekje penale për të njëjtën vepër) dhe *nemo debet bis puniri pro uno delicto* (askush nuk duhet të të dënohet dy herë për të njëjtën vepër) (Vervaele, 2015, p. 100). Kushtetuta e Republikës së Kosovës këtë parim e ka paraparë në nenin 34 ku thuhet se “askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale”. Në pajtueshmëri me këtë nen të Kushtetutës, Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar që “askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës” (neni 4, par. 1).

3. Legjislacioni i brendshëm dhe raporti me të drejtën ndërkombëtare

Zhvillimet bashkohore dhe trendet e globalizmit dërgojnë domosdo drejtë supremacisë së të drejtës ndërkombëtare kundrejtë të drejtës së brendshme. Në ditët e sotme kur flasim për këtë çështje, duhet ta kemi parasysh se jemi në një temë mjaft komplekse, prandaj kjo problematik vazhdon të debatohet ende në qarqet akademike. Në këtë drejtim vlen të përmendet që “prej kohësh është pohuar se marrëdhënia midis së drejtës ndërkombëtare dhe ligjit kombëtar është një çështje shqetësuese aktive në shumë vende juridike. Shumica do të pajtoheshin që marrëdhënia nuk është sqaruar plotësisht dhe as nuk përcaktohet qartë. Diskutimi në lidhje me marrëdhënien vazhdon të tërheqë shumë pikëpamje të kundërta” (Morina, Korenica, & Doli, 2011, p. 275). Vlen të theksohet se “studimi dhe analizimi i marrëdhënies midis rregullave të së drejtës ndërkombëtare dhe rregullave të së drejtës së brendshme ka një rëndësi të veçantë, sepse përcaktimi i zgjidhjeve dhe dilemave në lidhje me këtë marrëdhënie të shumëfishtë dhe shumëdimensionale, ndër të tjera përcakton statusin e shtetit në arenën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ndikon drejtpërdrejt në

statusin e shtetit si anëtar i barabartë i bashkësisë ndërkombëtare” (Daci, 2015, p. 81). Gjithashtu, me të drejtë konstaton autori Daci se “në rastin e RKS, pranimi dhe zbatimi i të drejtës ndërkombëtare në mbizotërim përkundrejt të drejtës së brendshme, është një domosdoshmëri dhe parakusht ndër të tjera për ndërkombëtarizimin e shtetit të ri të lindur të Kosovës, i cili nuk mund të jetë anëtar i barabartë i bashkësisë ndërkombëtare nëse nuk pranon dhe zbaton të drejtën ndërkombëtare, falë së cilës ekziston dhe funksionon vetë bashkësia ndërkombëtare. Sot, më shumë se kurrë, një pjesë e rëndësishme e rregullave të së Drejtës Ndërkombëtare nënkupton efekte të drejtpërdrejta për shtetet dhe individët pa pasur nevojë për ndonjë ndërhyrje të rregullave të së drejtës së brendshme” (Daci, 2015, p. 85).

Në literaturën e së drejtës ndërkombëtare, zakonisht trajtohen dy teori apo pikëpamje në lidhje me raportin, midis të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së brendshme. “Teoria e parë e njohur si pikëpamja dualiste (ose pluraliste) supozon se e drejta ndërkombëtare dhe e drejta e brendshme janë dy sisteme juridike të ndara që ekzistojnë të pavarura nga njëra-tjetra. Pyetja qendrore atëherë është nëse një sistem është superior ndaj tjetrit. Doktrina e dytë, e njohur si pikëpamja moniste, ka një perceptim unitar të ‘ligjit’ dhe e kupton si të drejtën ndërkombëtare ashtu edhe atë të brendshme si pjesë e një rendi juridik të njëjtë” (Malanczuk, 1997, p. 63). Në këtë rast vlen të theksohet se një koncept teorik që jep një zgjidhje përfundimtare në lidhje me këtë çështje ende nuk ekziston. Mirëpo drejta ndërkombëtare, në disa çështje, mbetet superiore kundrejt të drejtës së brendshme. E veçmas kur kemi të bëjmë me të drejtën humanitare ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut. Në këtë kuptim vlen të përmendet se Kushtetuta e RKS-sës, duke përcaktuar aplikim direkt të disa konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veç tjerash ka përcaktuar se, në rast konflikti ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike, këto konventa ndërkombëtare kanë përparësi (neni 22), që do të thotë, janë mbi aktet ligjore të vendit.

4. Pushteti Ekzekutiv – administrativ si mekanizëm kushtetues dhe legjislativ

Në të gjitha kushtetutat demokratike që parashohin ndarjen e pushteteve, vend qendrorë pa dyshim ka pushteti ekzekutiv dhe shërbimet administrative ndaj qytetarëve. Aktet juridike, duke filluar nga Kushtetuta, aktet ligjore dhe nënligjore, gjejnë zbatim përmes pushtetit ekzekutiv dhe administratës së shtetit. Për më tepër, duhet theksuar që “doktrina oksidentale përdor shprehjen e "ekzekutivit" për të evokuar në mënyrë gjenerike dy krerët e "pushtetit ekzekutiv", ministrat dhe personalitete të tjera, e që roli kushtetues i këtyre autoriteteve publike nuk mund të reduktohet në funksionin klasik të ekzekutivit, vetëm në zbatimin e ligjit, sepse veprimtaria e administratës publike është një lloj i aktiviteteve publike” (Modiga, Pusca, & Turtureanu, 2011, p. 1).

Pushteti ekzekutiv –administrativ në punën e vet mbështetet në Kushtetutë dhe ligjet pozitive të vendit. Respektivisht, pushteti ekzekutiv-administrativ ushtron detyrat e veta duke zbatuar Kushtetutën dhe legjislationin në fuqi, në fakt, duke jetësuar atë që është e paraparë në Kushtetut dhe ligje. Janë po ato, Kushtetuta dhe ligjet që i përcaktojnë detyrat dhe kompetencat pushtetit ekzekutiv dhe administrativ, ashtu si edhe pushteteve të tjera, dhe njëkohësisht edhe raportet me pushtetet e tjera brenda shtetit. Duhet theksuar se ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, ka përcaktuar që “Administrata shtetërore, është aparati organizativ dhe profesional i Qeverisë, që i shërben interesit publik nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave” (neni 8, par. 1).

Sa i përketë ushtrimit të punëve të administratës “në Republikën e Kosovës ushtrohet nga institucionet e administratës së drejtpërdrejtë dhe të tërthortë shtetërore. Institucionet e administratës së drejtpërdrejtë shtetërore janë: 1. organet e larta të administratës shtetërore; 2. organet qendrore të administratës shtetërore; 3. organet lokale të administratës shtetërore; 4. komunitat, sa kanë të bëjnë me kompetencat e deleguara shtetërore” (Bajrami, et al., 2019, p. 354).

Parimet themelore të Administratës Publike –Shërbimet administrative funksionojnë mbi bazën e parimeve të përcaktuara gjerësisht në kushtetuta dhe ligje. Duhet theksuar se Ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, ka përcaktuar këto parime:

- *Parimin e ligjshmërisë* (neni 3),
- *Parimin e profesionalizimit dhe neutralitetit politik* (neni 4),

- *Parimin e transparencës* (neni 5),
- *Parimin e bashkëpunimit ndërinstitucional* (neni 6) dhe
- *Parimin e mundësive të barabarta* (neni 7).

Gjithashtu, vlen të theksohet se “Administrata publike në Kosovë është relativisht e re pasi që Kosova në kohën pas konfliktit në vitin 1999 filloi ndërtimin e një sistemi të ri dhe një rendi të ri shoqëror, prandaj sistemi i ri i administratës publike u njoh në Kosovë” (Batalli, 2012, p. 8). Në këtë aspekt duhet theksuar se, Administrata publike në Kosovë, ende është në reformim e sipër.

5. Vetëqeverisja lokale si sistem i veçantë i pushtetit shtetëror

Vetëqeverisja lokale ka kuptimin e pushtetit në një teritor më të vogël brenda një shteti. Në teori zakonisht përcaktohet se “vetëqeverisja lokale konsiderohet se ekziston kur një qeveri lokale është themeluar si një institucion ligjor, korporatë dhe politik me kompetenca vendimmarrëse. Duhet të ketë gjithashtu një organ përfaqësues - një këshill ose asamble që zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët vendas në një votim të fshehtë dhe që ka autonomi buxhetore dhe fuqinë për të miratuar legjislacionin në nivelin lokal. Në përgjithësi, kjo shtresë e qeverisjes është përgjegjëse për vendimmarrjen në ato fusha të politikave që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve lokalë, p.sh. rigjenerimi urban, strehimi, shkollat, punësimi dhe sigurimet shoqërore, shëndetësia, artet, kultura dhe sporti, transporti publik lokal, uji dhe energjia dhe planifikimi rajonal” (Pejanovic, 2013, p. 215).

Ashtu siç është theksuar edhe më lartë baza ligjore për vetëqeverisjen lokale është Kushtetuta. Bazuar në nenin 123 të Kushtetutës së RKS-sës, përcaktohet se vetëqeverisja lokale garantohet dhe rregullohet me ligj. Ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë. Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e RKS-sës dhe respekton Kartën Evropianepër Vetëqeverisjen Lokale, si dhe vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve jo shumicë dhe pjesëtarëve të tyre (neni 123, par. 1-4).

Veç të tjerash vlen të theksohet se “duke marrë në konsideratë trendin e uljes së numrit të njërive të vetëqeverisjes lokale në të gjitha vendet e BE-së dhe vendeve të rajonit;

duke marrë parasysh zhvillimin e teknologjisë informative dhe mundësinë për kryerjentë shumë shërbimeve, si dhe me qëllim të uljes së kostos financiare të shpenzimeve të administratës, edhe Kosova, në një proces eventual të reformës territoriale, në të ardhmen, d'omoshmërisht duhet t'i ketë në konsideratë të gjitha këto zhvillime. Në këtë aspekt, krahas ndryshimeve territoriale të njësisë të vetëqeverisjes lokale, duhet të reflektohen ndryshimet edhe me rastin e përcaktimit të kompetencave dhe financimit të komunave” (SVL - MAPL, 2016, p. 16). Gjithashtu vlen të theksohet se “trendi i zhvillimeve politike, ekonomike dhe shoqërore në botë, kohëve të fundit është duke rrjedhë në dy kahje të kundërta, në njërin anë drejt globalizimit dhe në anën tjetër drejt lokalizimit. Kjo lëvizje e gjithëmbarshme e shoqërisë njerëzore ka ndikuar në masë të madhe edhe në ndryshimet e sistemeve të qeverisjes, në veçanti të qeverisjes lokale” (MAPL, 2013).

Vetëqeverisja lokale në Kosovë ka kaluar përmes një procesi të gjerë të decentralizimit, në këtë drejtim duhet theksuar se “korniza aktuale ligjore i ka dhënë një autonomi të plotë organeve të Pushtetit Lokal. Decentralizimi i pushtetit, reforma e pushtetit lokal duke fituar një shkallë të lartë të autonomisë në qeverisjen e komunave, ka ndikuar në integrimin e komunitetit serb dhe krijimin e një politike stabile dhe të unifikuar në vend. Kështu sistemi i ka arritur tre objektiva kryesore: 1) krijimin e shtetit me një shoqëri të qëndrueshme multi-etnike; 2) integrimin e komuniteteve (në veçanti të komunitetit serb) në institucionet vetëqeverisëse të vendit dhe 3) ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët” (MAPL, 2013).

Struktura organizative në qeverisjen lokale ka pësuar ndryshime, duke u përshtatur me kërkesat e dalta nga Pakoja e Ahtisarit konform së cilës është shpallur pavarësia e Kosovës. Në këtë kontekst duhet theksuar se “përveç ndryshimeve strukturore dhe organizative, si dhe hyrjes në fuqi të legjisllacionit të ri për vetëqeverisje lokale, zbatimi i procesit të decentralizimit, gjithashtu, imponoi reformën sa i përket transferimit të kompetencave nga niveli qendror në nivelin lokal por edhe reformën territoriale. Nga 30 Komuna ekzistuese, me ligjin e ri për kufijtë administrativ të komunave parashihej që ky numër të rritej në 38 komuna (SVL - MAPL, 2016, p. 14).

Korniza ligjore dhe organizimi i vetëqeverisjes lokale – baza ligjore në të cilën janë përcaktuar kompetencat e pushtetit lokal, janë Kushtetuta dhe ligji për vetëqeverisje lokale. Po ashtu, duhet përmendur se Kushtetuta e Kosovës parasheh respektimin e Kartës Evropiane

për Vetëqeverisje Lokale. Veç tjerash Kushtetuta ka përcaktuar që “veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. RKS-ë merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues” (neni 123, par.3).Është me rëndësi të theksohet se Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale,është një dokumenti i rëndësishëm ndërkombëtar,që përcakton parimin e vetëqeverisjes lokale. Ajo ka ndikim të madhë në ligjet e shumicës së shteteve anëtare të Këshillit të Evropës në rregullimin e vetëqeverisjes . Koncepti i vetëqeverisjes lokale, siç parashihet në paragrafin 1 të nenit 2 të Kartës, përfshinë të drejtat dhe mundësitë e autoriteteve lokale që brenda kufizimeve të ligjit, të menaxhojnë një pjesë substanciale të punëve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës lokale (OSCE - Raport, 2008, p. 7).

Bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale në Kosovë, “Komunat i ushtrojnë kompetencat vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin” (nenin 16). Ndërë të tjera ligji ka përcaktuar statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, funksionimin dhe komponentin organizative të tyre, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror (neni 2, par.1). Vlen të theksohet se ligji për vetëqeverisjen lokale ka paraparë një gamë të gjerë të kompetencave vetanake për komunat (neni 17).

KREU I TRETË

DISKUTIMI TEORIK DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Kur flasim për të drejtat dhe liritë e njeriut, gjithmonë parasysh duhet patur atë se “të drejtat e njeriut janë standarde që i lejojnë të gjithë njerëzit të jetojnë me dinjitet, liri, barazi, drejtësi dhe paqe. Çdo person i ka këto të drejta thjesht sepse ato janë qenie njerëzore. Ato janë të garantuara për të gjithë pa asnjë dallim të çfarëdo lloji, të tilla si raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, prona, lindja ose status tjetër. Të drejtat e njeriut janë vendimtare për zhvillimin e individëve dhe komuniteteve respektivisht për plotësimin e tyre” (The Advocates for Human Rights, 2020).

U desh të ndodhin dy luftëra të mëdha botërore që njerëzimi të filloi seriozisht të trajtojë të drejtat e njeriut. Vetëm pas Luftës së dytë botërore, të drejtat e njeriut kaluan kufijtë shtetëror dhe filluan të trajtohen në kontekst global. Në këtë drejtim, “deri në Luftën e Dytë Botërore, e drejta ndërkombëtare e lirive dhe të drejtave të njeriut nuk ishte një temë e njohur në librat shkollorë për të drejtën ndërkombëtare” (Choëdhury & Bhuiyan, 2010, p. 2). Në aspektin konceptual të të drejtave të njeriut, vlen veçuar se “të drejtat e njeriut mund të përshkruhen si një tërësi marrëdhëniesh. E që përbëhet prej marrëdhëniesh mes individëve të cilët kanë për detyrë të veprojnë (ose të përmbahen nga veprimet) ndaj njëri tjetrit. Dhe marrëdhëniet e qenieve njerëzore me të mirat e caktuara (gjërat, rrethanat) duke siguruar mirëqenien e tij ose saj. Kjo tërësi marrëdhëniesh ekziston pavarësisht nga aktet ligjore dhe pavarësisht nga ajo se a është kuptuar nga dikush apo jo (Piechowiak M. , 1999, p. 12).

Përmasa të mëdha të zhvillimit kanë marrë të drejtat e njeriut, ku dhe deri më tani numërohen dhjeta akte ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Qindra e mijëra libra dhe publikime shkencore të shkruara, dhe qindra e mijëra konferenca dhe simpoziume shkencore të mbajtura. Por megjithatë, me të drejtë thekson James Darcy, se koncepti modern i të drejtave të njeriut mund të gjurmohet, që në revolucionet Amerikane dhe Franceze në fund të shekullit XVIII. ‘Të drejtat e njeriut’ u pohuan dhe justifikuan duke iu referuar parimeve të lirisë dhe barazisë. Megjithëse nganjëherë i shtrembëruar, koncepti mund të gjurmohet përmes historisë pasuese në lëvizjen e emancipimit dhe heqjes së tregtisë së skllëvërve deri në zhvillimet e këtij shekulli, duke përfshirë themelimin e Kombeve të Bashkuara dhe formulimin e standardeve ligjore ndërkombëtare bazuar në parimet e vendosura në

Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948 (Darcy, 1997, p. 7). Po ashtu, i njëjti autor me të drejtë konstaton se “zhvillimi i të drejtave universale të njeriut në shekullin e njëzetë është nxitur nga dy faktorë kryesorë: mizoritë e kryera kundër civilëve dhe jo-luftëtarëve në dy Luftërat Botërore, mbi të gjitha në Holokaustin; dhe persekutimi dhe shtypja e dhunshme e kundërshtarëve të regjimeve totalitare ose koloniale” (Darcy, 1997, p. 7). Për më tepër, Darcy thekson se “humbja ose mohimi i lirisë dhe shprehja demokratike ka qenë një tipar i përbashkët i të dyve, ashtu si edhe diskriminimi - një mohim i barazisë - në formën e marginalizimit politik, shoqëror dhe ekonomik. Parimi i mosdiskriminimit qëndron në zemër të të drejtave të njeriut; domethënë, parimi që ndryshimet e racës, gjinisë dhe karakteristikave të tjera njerëzore, ose ndryshimet e besimit ose kulturës, nuk mund të justifikojnë trajtimin e diferencuar. Gjenocidi mund të shihet si forma përfundimtare e diskriminimit, duke i trajtuar qeniet njerëzore si nënjerëzore” (Darcy, 1997, p. 7).

1. Zhvillimi historik i të drejtave të njeriut

Termi ‘të drejta të njeriut’, është e ditur se ka filluar të përdoret mjaft vonë. Por sa i përket idesë për të drejtat e njeriut, atë e gjejmë shumë herët në historinë e zhvillimit njerëzor. Prandaj me të drejtë e thotë Surinder Kaur se “termi 'Të Drejtat e Njeriut' është relativisht i ri me origjinë, por ideja e lirive dhe të drejtave të njeriut është po aq e vjetër sa historia e civilizimit njerëzor. Ai është zyrtarisht dhe universalisht, i njohur vetëm pas formimit të Kombeve të Bashkuara në 1945” (Kaur, 2014, p. 997).

Në realitet, pas luftës së dytë botërore, të drejtat e njeriut marrin karakterin ndërkombëtar, duke tejkaluar kufijtë shtetëror. Në këtë mënyrë kjo na jep të kuptojmë se edhe fraza ‘të drejtat e njeriut’ nuk është shumë e vjetër, dhe i takon saktësisht shekullit XX. Prandaj, edhe Surinder e thekson saktësisht këtë çështje ku konstaton se, “frazja e re 'Të Drejtat e Njeriut' u miratua vetëm në shekullin e tanishëm nga shprehjet e njohura më parë si 'Të Drejtat e Natyrave ose të Drejtat e Njerëzve'. Duke prezantuar konceptin e të ktyre të drejtave mund të thuhet se ky koncept është një emër i shekullit të njëzetë për atë që është njohur tradicionalisht si të drejta natyrore ose, me një frazë më ngazëllyese, të drejtat e burrave” (Kaur, 2014, p. 997). Vlerësohet me të drejtë se “aspirata për të mbrojtur dinjitetin njerëzor të të gjitha qenieve njerëzore, paraqet thelbin e konceptit për të drejtat e njeriut. Kjo aspiratë e vë qenien njerëzore në qendër të interesit dhe jo vetëm. Kjo kërkesë është e bazuar në sistemin e përbashkët universal të vlerave të të drejtës për jetë, si një e drejtë e absolute, dhe ofron një kornizë për ndërtimin e sistemit të të drejtave të njeriut, të mbrojtur nga normat

dhe standardet e pranuar ndërkombëtarisht. Gjatë shekullit XX, të drejtat e njeriut janë zhvilluar si formulime morale, politike dhe ligjore dhe udhërrëfyese për zhvillimin e një bote të lirë nga frika dhe skamja” (Benedek & Nikolova, 2003, p. 26).

Të drejtat e njeriut janë zhvilluar vazhdimisht nga kohërat antike e deri më sot. “Përgjatë shekujve, traditat politike në konflikt kanë përpunuar komponentë të ndryshëm të të drejtave të njeriut ose kanë ndryshuar mbi atë se cilat elemente kishin përparësi. Në ditët tona, kuptimet e shumëfishta të të drejtave të njeriut reflektojnë procesin e vazhdimësisë historike dhe ndryshimit që ndihmuan në formësimin e substancës së tyre aktuale dhe ndihmuan në formimin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 1948” (Ishay, 2008, p. 3).

Përmes pengesave dhe kundërshtive të mëdha, janë zhvilluar të drejtat e njeriut. Thuaj se çdo ide, dhe çdo përpjekje për të drejtat e njeriut, ka hasur në kundërshtime të rrepta, në forma nga më të rëndat. E thotë saktësisht edhe Micheline ku thekson që “në realitetin historik, çdo hap i madh përpara u pasua nga pengesa të mëdha. Universalizmi i të drejtave të njeriut i njohur gjatë Revolucionit Francez u zëvendësua ngadalë nga një reagim nationalist i inkubuar gjatë pushtimeve të Napoleonit, ashtu si shpresat internacionaliste të mbrojtësve socialistë të të drejtave të njeriut u mbytën në një valë baticash të nacionalizmit në afrimin e Luftës së Parë Botërore. Aspiratat për të drejtat e Revolucionit Bolshevik dhe të dy institucioneve si motra liberale, Lidhjes së Kombeve dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), u shtypën nga ngritja e Stalinizmit dhe fashizmit gjatë periudhës së mesluftës; krijimi i Kombeve të Bashkuara (KB) dhe miratimi i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut u eklipsuan duke intensifikuar nacionalizmin në Botën e Tretë dhe konkurrencën globale në zhvillim midis dy superfuqive të armatosura bërthamore. Më në fund, pretendimet triumfale të bëra pas vitit 1989 se të drejtat e njeriut do të lulëzonin në një ekonomi globale të tregut të papërmbajtur u mbytën shpejt nga nacionalizmi në rritje në ish Bashkimin Sovjetik, Afrikë, Ballkan dhe më gjerë” (Ishay, 2008, p. 4). Nga kjo del se, e gjatë ka qenë lufta për të drejtat e njeriut dhe gjithësi e mundimshme. Në këtë drejtim, tmerret e dy luftërave botërore janë arsyeja e ngritjes së zërit të ndërgjegjës njerëzore dhe intelektuale, të juristëve, historianëve, filozofëve, etj. të kohës së pasluftës.

Veç tjerash, në aspektin juridik vlen të theksohet se të drejtat e njeriut “si kategori juridike janë paraqitur me krijimin e shteteve dhe rregullave të para juridike, kurse shtytje më të madhe u kanë dhënë revolucionet borgjeze, të cilat kanë proklamuar si ideale të

përbashkëta 'lirinë, vllazërinë dhe barazinë'. Pikërisht revolucionet borgjeze kanë inspiruar Ligjin për të Drejtat (Bill of Rights) të vitit 1689, Deklaratën për Pavarësinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të vitit 1776, dhe Deklaratën për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit të vitit 1789, të cilat i kanë venë standardet më të përgjithshme për të drejtat e njeriut” (Gruda, 2007, p. 3).

Gjatë periudhës skllavopronare, me disa nuanca të vogla dalluese edhe gjatë periudhës feudale, as që mund të flitet për liritë dhe të drejtat e njeriut. Vlen të kujtojmë pozitën robëruese të skllavëve gjatë këtyre periudhave kohore, ku trajtoheshin si sende. Ku pronari, në këtë rast skllavopronari, kishte pushtet absolut ndaj skllavit të ngjashëm me pushtetin ndaj sendeve. Në këtë drejtim, “lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet për t’u njohur të drejtat e tij themelore (elementare): të drejtës për jetë dhe liri, të cilat kanë qenë të rëndësishme sidomos në periudhën e sistemit skllavopronar dhe feudal. Më vonë revolucionet borgjeze këtyre të drejtave elementare ua shtojnë edhe disa të drejta të tjera, të cilat u takonin të ashtuquajturave të drejta natyrore, siç janë e drejta e barazisë, e drejta për siguri dhe e drejta për t’i bërë rezistencë shtypësit” (Gruda, 2007, pp. 3-4).

Përkundër gjithë përpjekjeve, miratimit të shumë akteve ndërkombëtare dhe rezolutave të OKB-së për të drejtat e njeriut, edhe në ditët e sotme, shkeljet e të drejtave të njeriut janë evidente në shumë shtete të botës, duke veçuar në këtë rast regjimet jodemokratike. Në veçanti vlen të përmenden shkeljet brutale të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, duke përfshirë shtypjen e pakicave etnike, racore ose fetare, praktikimin e diskriminimit, madje edhe veprimet e gjenocidit, që dëshmojnë se me gjithë përparimin e arritur që ka bërë bota demokratike, lufta për sendërtimin e plotë në jetë e të drejtave nuk është fituar në të gjitha vendet e botës (Gruda, 2007, p. 4).

Në ngritjen dhe sendërtimin e të drejtave të njeriut, dhe në luftën në vazhdimësi për realizimin e tyre, pa dyshim, rol të veçantë kanë luajtur edhe veprat e autorëve të ndryshëm. Si atyre të filozofisë, juristëve, politikanëve, etj, të shekujve XVI, XVII dhe XVIII, periudhë kur edhe kanë filluar të zënë vend të drejtat e njeriut. Në këtë kontekst, duhet përmendur autorët të cilët njëkohësisht njihen edhe si pararendësit e të drejtave të njeriut, ndër të cilët më të njohur janë: Grotius, Locke, Spinoza, Puffendorf, Leibniz, Thomasius, Volf, Voltaire, Montesquie, Rousseau, Jefferson, Paine, etj (Gruda, 2007, p. 4).

2. Burimet ligjore për të Drejtat dhe lirit të njeriut

Të drejtat dhe lirit të njeriut kanë filluar të normohen pikërisht në periudhën kur edhe kanë filluar të trajtohen seriozisht dhe të zënë vend të rëndësishëm. Meqenëse të drejtat e njeriut kanë karakter ndërkombëtarë, kështu që edhe burimet ligjore të të drejtave të njeriut i gjejmë në drejtën ndërkombëtare. Prandaj, në këtë kontekst, edhe burimet ligjore të të drejtave të njeriut i gjejmë të përcaktuara në të drejtën ndërkombëtare. Duhet përmendur se, autorët e së drejtës ndërkombëtare në trajtimin e burimeve të kësaj të drejte, bazohen në statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND). Saktësisht në nenin 38 paragrafin 1 të statutit, ku precizohet se, “gjykata, mision i së cilës është që të rregulloj sipas së drejtës ndërkombëtare kontestet që i parashtrihen, zbaton:

- a. konventat ndërkombëtare, të përgjithshme dhe të veçanta, që vendosin rregulla të njohura posaçërisht nga shtetet kundërshtuese;
- b. zakonet ndërkombëtar si dëshmi e një praktike universale të njohur si rregull ligjor;
- c. parimet e përgjithshme të ligjit të njohura nga kombet e qytetëruara;
- d. Vendimet gjyqësore dhe doktrinat e specialistëve më të kualifikuar të së drejtës publike të kombeve të ndryshme si ndihmë për përcaktimin e normave juridike” (neni 38, par.1).

Siq shihet nga ajo që është përcaktuar në nenin 38 të statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, rrjedh se, “burimi kryesor i të drejtës së të drejtave të njeriut janë traktatet. Këto janë, marrëveshje formale me shkrim ndërmjet Shteteve. Pasi këto traktate janë miratuar, nënshkruar dhe ratifikuar ato janë të detyrueshme për Shtetet Palë në traktat” (Raport i SLYNN, 2016, p. 24).

Përveç traktateve burim tjetër i detyrueshëm sipas nenit 38 të statutit të GJND-së, parashihet edhe e Drejta Zakonore. Nga ajo që përcaktohet në këtë nen, rrjedh se statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë e rendit zakonet ndërkombëtar, si provë të një praktike të përgjithshme të pranuar si ligj. Në këtë mënyrë, “si e tillë, e drejta zakonore ndërkombëtare duhet:

- të rrjedhë nga një konsensus i qartë midis shteteve;
- që shfaqet nga një sjellje përhapur gjerësisht; dhe
- një ndjenjë të dukshme të detyrimit për t'a zbatuar” (Raport i SLYNN, 2016, p. 25).

E rëndësishme gjithashtu të theksohet është se “e drejta zakonore ndërkombëtare nuk mund të deklarohet apo njihet nga shumica e shteteve për qëllimet e tyre; ajo mund të dallohet vetëm përmes praktikës aktuale të përhapur e të pranuar. Për shembull, ligjet e luftës ishin prej kohësh një çështje e së drejtës zakonore para se ato të kodifikoheshin në konventat e Gjenevës apo traktate të tjera” (Raport i SLYNN, 2016, p. 25).

Po ashtu, në mënyrë të ngjashme, shumë krime sipas të drejtës ndërkombëtare përcaktohen kryesisht nga e drejta zakonore. Statutet e gjykatave të reja penale ndërkombëtare, të tilla si Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë, Gjykata Penale Ndërkombëtare për Ruandën dhe Gjykata Penale Ndërkombëtare, bëjnë referenca në të drejtën zakonore ndërkombëtare në përcaktimin e krimeve mbi të cilat gjykatat kanë juridiksion. Vendimet e këtyre gjykatave shpesh kanë përmendur të drejtën zakonore ndërkombëtare. GJND më tej ka konsideruar elemente të caktuara të ligjit të privilegjeve dhe imuniteteve diplomatike dhe mbrojtjes diplomatike si të drejta zakonore (Leopard, 2010, pp. 3-4).

Po ashtu, në këtë rast veç tjerash vlen të përmendet se përgjithësisht, pranohet që ka dy elemente thelbësore për një rregull/parim të së drejtës zakonore ndërkombëtare:

☐ ***Praktika e Përgjithshme*** - çdo herë, një zakon ekziston vetëm kur ekziston një shkallë e caktuar e bashkëveprimit apo marrëveshjes së sjelljes mes aktorëve pjesëmarrës në proces. Kjo është e vërtetë për zakonet ndërkombëtare, ashtu si për zakonet e shteteve. Sipas Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, së një rregull të bëhet pjesë e së drejtës ndërkombëtare zakonore, duhet të ketë dëshmi e 'përdorimit të vazhdueshëm dhe në mënyrë uniforme, e praktikuar nga shtetet'. Praktika e shtetit, në këtë aspekt, mund të përfshijë traktatet, vendimet e gjykatave kombëtare dhe ndërkombëtare, legjislacionin kombëtar, korrespondencën diplomatike, opinionet e këshilltarëve ligjorë kombëtarë si dhe praktikën e organizatave me karakter ndërkombëtare, dhe

☐ ***Opinio Juris*** - Rënia dakord për një praktikë të caktuar që të trajtohet si ligjërishit apo moralisht e detyrueshme, është qartësisht e pa-mjaftueshme në vetvete, (p.sh. praktika e 'shtrimit të tapetit të kuq' për personalitete të huaja). Përveç kësaj, duhet të ketë dëshmi të Shteteve në fjalë lidhur me faktin që kanë qenë të detyruar ligjërishit për të vepruar në atë mënyrë. Praktika duhet të shkojë përtej praktikave të përhershëm të motivuara nga mirësjellja, lehtësitë apo tradita. Rrjedhimisht, *Opinio*

Juris, është elementi 'subjektiv' ose 'mendtor' i zakonit, dhe është i rëndësishëm që një praktikë të tillë të konsiderohet ligjërish e detyrueshme.

Përveç traktateve dhe zakoneve ndërkombëtare, si burime të së drejtës neni 38 i statutit të GjND-së përcakton edhe parimet e përgjithshme të së drejtës të njohura nga kombet e qytetëruara. Si dhe vendimet gjyqësore dhe doktrinën e autorëve më të kualifikuar të së drejtës publike të kombeve të ndryshme, si ndihmë për përcaktimin e normave juridike. Parimet e përgjithshme janë rregulla që pasqyrojnë konceptet elementare të ligjit dhe drejtësisë, të cilat duhet të respektohen nga çdo sistem juridik. Ato lejojnë mbylljen e zbrazëtirave dhe zgjidhen e çështjeve të interpretimit të ligjit ekzistues, në mënyrën më të drejtë (Bochard, 2010, p. 86). Megjithatë vendimet gjyqësore, sipas nenit 38 të statutit të GjND-së, do të përdoren si një mjet ndihmës për përcaktimin e rregullave të së drejtës, se sa si një burim aktual i së drejtës, vendimet gjyqësore mund të jenë të një rëndësie të veçantë (Shaë, 2008, p. 109).

Gjithashtu, neni 38 i statutit të GjND-së, përfshin si një mjet ndihmës, për përcaktimin e rregullave të së drejtës si edhe 'mësimet e publicistëve më të kualifikuar të kombeve të ndryshme'. Historikisht, është shënuar ndikimi i akademikëve në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare. Në periudhën e lulëzimit të së Drejtës Natyrore ishin analizat dhe mendimet juridike që ishin thelbësore, ndërsa roli i praktikës shtetërore dhe vendimeve të gjykatës kishte më pak vlerë. Shkrimtarë të tillë si: Gentili, Grotius, Pufendorf, Bynkershoek dhe Vattel, ishin autoritetet supreme të shekujve XVI-XVIII të cilët përcaktuan fushën, formën dhe përmbajtjen e së drejtës ndërkombëtare (Shaw, 2008, p. 112).

3. Konsiderimi subjektiv dhe objektiv i të drejtave dhe lirive të njeriut

Të drejtat e njeriut janë mjaft komplekse për tu kuptuar nga njerëzit e rëndomtë. Por, shpeshherë janë komplekse edhe për tu zbatuar dhe trajtuar nga zyrtarët shtetërorë, por edhe nga vet studiuesit. Qytetarët shpeshherë nuk arrijnë të akceptojnë drejtë, se cilat janë të drejtat e tyre. Kështu dhe mbeten konfuz kundrejtë institucioneve të cilat me vetëdije apo pa vetëdije bëjnë shkeljen e të drejtave të njeriut. Të drejtat e njeriut mbeten komplekse për tu kuptuar për faktin se ato janë duke u zhvilluar dhe duke u trajtuar gjerësisht dhe nga këndvështrime të ndryshme. Se sa janë komplekse shihet edhe nga raportet e shumta të organizatave

ndërkombëtare anë e kënd globit. Në këtë kuptim, njerëzit që janë laik natyrisht që e kanë më të vështirë të kuptojnë të drejtat e tyre.

Një shpjegim insteresant dhe mjaft të vlefshëm në lidhje me këtë, e jep Paul Stenner. Ai thekson se marrëdhënia midis kuptimit 'ekspert' dhe 'laik' të të drejtave të njeriut, është një dinamikë e rëndësishme në këtë proces. Në këtë pikëpamje Stenner jep një shembull, ku tregon se pas prezantimit të Aktit të Mbretërisë së Bashkuar për të Drejtat e Njeriut më 1998, Lord Falconer, atëherë Sekretar i Shtetit për Çështjet Kushtetuese dhe Lord Chancellor, bëjnë një seri deklaratash thelbësore duke theksuar rëndësinë e një 'kulture të të drejtave të njeriut' në Mbretërinë e Bashkuar. Një kulturë e tillë ka për detyrë përgjegjësinë e rilidhjes së njerëzve të zakonshëm me politikën dhe ligjin, përmirësimin e shërbimeve publike, rivendosjen e respektit për dinjitetin themelor njerëzor dhe përgjithësisht promovimin e vlerave themelore të përbashkëta që mund ta lidhin kombin si një kolektiv koherent. Kur kaq shumë shpresë investohet në mënyrat në të cilat të drejtat e njeriut mund të ndikojnë te njerëzit e zakonshëm, kuptimi se si njerëzit i kuptojnë ato bëhet drejtpërdrejt i rëndësishëm. Është e rëndësishme të dihet, për shembull, nëse Lord Falconer dhe publiku britanik, kanë të njëjtën gjë në mendje kur shqiptojnë frazën të 'drejtat e njeriut' (Stenner, 2011, pp. 2-3).

Prandaj, në këtë kontekst, me të drejtë precizon Stenner se "gjëja e rëndësishme është t'i bësh njerëzit të mendojnë dhe të veprojnë në mënyrën e duhur, jo t'i bësh ata të debatojnë se cila është ajo 'mënyra e duhur' e treguar nga të drejtat e njeriut. Kjo, sepse të drejtat e njeriut, shërbejnë si themel për një shoqëri të drejtë dhe demokratike. Mbi përkufizimin dhe mbrojtjen e tyre objektive, mbështetën shpresat e drejtësisë dhe emancipimit në të ardhmen dhe të mirëmbajtjes dhe promovimit të mirëqenies njerëzore. Të drejtat e njeriut, në këtë kuptim, janë një parim thelbësor i bashkimit për drejtësi kundër dhunës dhe shfrytëzimit të paligjshëm" (Stenner, 2011, p. 3).

4. Funkcionet e të drejtave të njeriut

Para së gjithash duhet theksuar se brenda secilës qenie njerëzore është natyra që dëshiron të trajtohet me dinjitet, që do të thotë të bësh jetë dinjitoze si qenie njerëzore. Të drejtat e njeriut do të garantojnë këtë dinjitet pasi "të kesh një të drejtë në x" do të thotë që jeta e dikujt do të bëhet idealisht më e mirë në një formë apo tjetër. Në këtë mënyrë 'punojnë' dhe funksionojnë të drejtat e njeriut sepse ato janë një rezultat i natyrshëm i natyrës morale njerëzore dhe garantojnë këtë natyrë morale (<https://www.mtholyoke.edu>, 2020).

Ajo që në fakt është e rëndësishme dhe të dijmë në këtë rast, është se cilat janë arsytet që të drejtat e njeriut janë të rëndësishme? Në këtë drejtim mund të listohet një numër i madh i arsyeve se cila është rëndësia e të drejtave të njeriut. Këtu do të radhisim apo listojmë disa nga funksionet, apo arsytet që konsiderojmë se janë më me përparësi për të drejtat e njeriut.

Të drejtat e njeriut sigurojnë që njerëzit të përmbushin nevojat themelore - Të gjithë kanë nevojë për qasje në ilaçe, ushqim dhe ujë, rroba dhe strehim. Duke përfshirë këto në të drejtat themelore të një personi, të gjithë kanë një nivel bazë të dinjitetit. Mirëpo fatkeqësisht,ka ende miliona njerëz që këto nevojat nuk i kanë, por duke thënë se është çështje e të drejtave të njeriut lejohen aktivistët dhe të tjerët të punojnë drejt ofrimit të këtyre nevojave për të gjithë.

Të drejtat e njeriut mbrojnë grupet e prekshme nga abuzimi – Në këtë kontekst vlen të përmendet se, Deklarata e lirive dhe të Drejtave të Njeriut, u krijua kryesisht për shkak të Holokaustit dhe tmerreve të Luftës së Dytë Botërore. Gjatë asaj kohe në histori, më të prekshmit në shoqëri ishin në shënjestër së bashku me popullsinë hebreje, përfshirë ata me aftësi të kufizuara dhe LGBT. Organizatat që merren me të drejtat e njeriut,kryesisht përqendrohen tek anëtarët e shoqërisë që janë më të prekshëm ndaj abuzimeve nga mbajtësit e energjisë, në vend që t'i injorojnë ata.

Të drejtat e njeriut i lejojnë njerëzit të qëndrojnë përpara korrupsionit shoqëror - Koncepti i të drejtave të njeriut i lejon njerëzit të flasin kur përjetojnë abuzim ose korrupsion. Kjo është arsyeja pse të drejtat specifike si e drejta për tu mbledhur janë thelbësore sepse asnjë shoqëri nuk është e përsosur. Koncepti i të drejtave të njeriut i fuqizon njerëzit dhe u thotë atyre se ata meritojnë dinjitet nga shoqëria, qoftë qeveria apo mjedisi i tyre i punës.

Të drejtat e njeriut inkurajojnë lirinë e fjalës dhe shprehjes - Ndërsa është e ngjashme me atë që sapo lexuat më lart, të jesh në gjendje të flasësh lirshëm pa pasur frikë nga një hakmarrje brutale është më e shtrirë. Përfshin idetë dhe format e shprehjes, që jo të gjithë do t'i pëlqejnë ose bien në pajtim.Megjithatë,askush nuk duhet të ndihet kurrë, sikur do të rrezikohet nga qeveria e tyre, për shkak të asaj që ata mendojnë. Ajo shkon në të dy anët, gjithashtu, dhe mbron njerëzit që duan të debatojnë ose të argumentojnë me ide të caktuara të shprehura në shoqërinë e tyre.

Të drejtat e njeriut u japin njerëzve liri të praktikojnë fenë e tyre (ose të mos praktikojnë ndonjë) - Dhuna dhe shtypja fetare ndodhin pa pushim gjatë gjithë historisë, nga Kryqëzatat në Holokaust deri te terrorizmi modern në emër të fesë. Të drejtat e njeriut pranojnë rëndësinë e fesë dhe besimeve shpirtërore të një personi, dhe i lejojnë ata të praktikojnë në paqe. Liria për të mos iu përmbajtur një feje është gjithashtu një e drejtë njerëzore.

Të drejtat e njeriut i lejojnë njerëzit të duan atë që zgjedhin - Rëndësia e lirisë për të dashur nuk mund të nënvlerësohet. Të jesh në gjendje të zgjedhësh se si duket jeta romantike e një personi është një e drejtë thelbësore e njeriut. Pasojat e mos mbrojtjes së kësaj të drejte janë të qarta kur shikoni vendet ku personat LGBT shtypen dhe abuzohen, ose ku gratë detyrohen të bëjnë martesë që nuk duan.

Përveç këtyre funksioneve të lartpërmendura, ekzistojnë edhe shumë funksione të tjera si për shembull, të drejtat e njeriut inkurajojnë mundësi të barabarta pune, të drejtat e njeriut u japin njerëzve akses në arsim, të drejtat e njeriut mbrojnë mjedisin, të drejtat e njeriut ofrojnë një standard universal që i bën qeveritë të përgjegjshme.

(<https://www.humanrightscareers.com>, 2020), etj.

5. Efekti juridik i të drejtave të njeriut

Pa dyshim që efekti juridik i të drejtave të njeriut në ditët tona është duke shkuar drejtë rritjes. Ndikimi juridik i të drejtave të njeriut është evident në shumë fusha të jetës institucionale, por edhe të jetës së përditshme. Natyrshëm, “në dekadat e fundit, e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut ka pasur një ndikim gjithnjë në rritje në sistemet ligjore vendore në të gjithë botën, dhe kështu edhe në punën e përditshme të gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve vendorë. Kjo situatë ligjore në zhvillim, dimensionet e vërteta të së cilës vështirë se mund të ishin parashikuar gjysmë shekulli më parë, kërkon që secili shtet i interesuar, dhe gjithashtu profesionet përkatëse juridike, të marrin në konsideratë mënyrat në të cilat zbatimi efektiv i detyrimeve ligjore të shtetit për të drejtat e njeriut të mund të jenë më mirë të siguruar. Kjo në shumë raste mund të përbëjë një sfidë për praktikuesit e ligjit, për shkak të kërkesave kontradiktore të ligjeve të ndryshme, mungesës së qasjes në informacion dhe nevojës për trajnim të mëtejshëm” (Raport - Human Rights in the Administration of Justice, 1998, p. 2).

Efekti juridik i të drejtave të njeriut është i shënueshëm që nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, siç konstaton edhe teoricieni Siobhan Mcinerney Lankford, “në një nivel faktik ose thelbësor, mund të identifikohet një besueshmëri e të drejtave të njeriut dhe zhvillimit në gamën në zgjerim të funksioneve, aktiviteteve dhe politikave të agjencive të zhvillimit dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, që përputhen me dispozitat materiale të traktateve të të drejtave të njeriut, veçanërisht ato të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, por edhe ato të Kartës Sociale Evropiane (1961), Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut (1969), Protokollit të San Salvadorit (1988), Kartës Afrikane të Të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve (1981), dhe Karta e Bashkimit Evropian (BE) e të Drejtave Themelore (2001).Projektet dhe programet e zhvillimit tani mbulojnë gamën e zhvillimit shoqëror dhe njerëzor, shumica e të cilave kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me të drejtat thelbësore ekonomike dhe sociale dhe lidhen me një numër të drejtash civile dhe politike” (Lankford, 2009, p. 53).

Veç tjerash, vlen të theksohet se një efekt pozitiv të të drejtave të njeriut e shohim në vendet në tranzicion. Shikuar nga kjo dioptri, me të drejtë theksojnë Horoëitz dhe Schnabel se “përmirësimi i praktikave të të drejtave të njeriut në shoqëritë në tranzicion duhet të jetë një qëllim kryesor për reformatorët vendas dhe bashkësinë ndërkombëtare. Kjo ka kuptim, jo vetëm për shkak të vlerës së brendshme të mbrojtjes së përmirësuar të të drejtave të njeriut, por edhe për shkak të efekteve indirekte që këto përmirësime kanë në demokratizimin, zhvillimin ekonomik dhe zgjidhjen e konfliktit” (Horoëitz & Schnabel, 2004, p. 3).

Gjithnjë, duhet pasur parasysh se, të drejtat e njeriut janë të drejta universale dhe të pandashme.Kështu që dhe në këtë drejtim japin siguri për çdo person dhe në çdo vend. Në këtë rast vlen të përmendet edhe Piechoëiak i cili thekson se “univerzaliteti është i bazuar në dinjitetin immanent dhe në pandashmërinë e të drejtave. Edhe pse univerzaliteti dhe pandashmëria janë karakteristika themelore në definimin e të drejtave të njeriut, ato janë specifika të cilat më së shpeshti kontestohen nga filozofët dhe teoreticientët e të drejtës. Megjithatë, duhet theksuar se që të dyja, univerzaliteti dhe pandashmëria, njihen dhe theksohen në nivel të diskutimeve praktike” (Piechowiak M. , 1999, pp. 5-6).

6. Standardet ndërkombëtare

Të drejtat dhe lirit e njeriut janë të drejta universale, të cilat u takojnë të gjithë personave pa asnjë dallim. Në këtë kontekst, të drejtat e njeriut kërkojnë krijimin e standardeve të njëjta për të gjithë, ashtu siç parashihet me konventa ndërkombëtare dhe me ligje të shteteve. Vlen të theksohet se fjala standard është paraqitur që nga deklarata e përgjithshme për të drejtat e njeriut, në preambulën e të cilës theksohet se, të drejtat e njeriut janë standardi i përbashkët i arritjeve për të gjithë popujt dhe të gjitha kombet, deri në fund që çdo individ dhe çdo organ i shoqërisë, duke e pasur këtë deklaratë vazhdimisht në mendje, të përpiqet duke mësuar dhe edukuar të promovojë respektin për këto të drejtat dhe liritë dhe me masa progresive, kombëtare dhe ndërkombëtare, për të siguruar respektimin e tyre universal dhe efektiv, si midis vetë popujve të Shteteve Anëtare, ashtu edhe midis popujve të territoreve nën juridiksionin e tyre (pjesë nga preambula e DUPNJ). Në këtë rast është interesant dhe me rëndësi të përmendet konstatimi i Piechoëiak i cili thekson që “askush nuk mund t’ia çenoi askujt këto të drejta dhe askush nuk mund të heqë dorë nga këto të drejta (psh. të bëhet skllav). Në këtë qasje, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut nuk janë të lidhura me norma ligjore të miratuara sipas rregullit, por miratimi i normave të përshtatshme bëhet me qëllim që t’i mbrojtë të drejtat e njeriut dhe t’i përcaktojë mënyrat e realizimit të tyre” (Piechowiak M. , 1999, p. 6).

Veç tjerash vlen të përmendet se një shqetësim i veçantë kanë qenë situatat e konfliktit të armatosur ku një individ i pambrojtur kërkon ndihmë urgjente dhe mbrojtje nga efektet e një konflikti në të cilin nuk po luan asnjë rol të drejtpërdrejtë. Në këtë pikëpamje lëvizja e Kryqit të Kuq, e qeverisur nga parimet e neutralitetit dhe paanësisë, është shprehja më e qartë e kësaj tradite. Dhe zhvillimi i të drejtës ndërkombëtare humanitare, të cilën ajo sponsorizoi, ka bërë një farë mënyre për të vendosur veprime humanitare mbi një sërë të drejtash. Besimi i përhapur gjerësisht në ekzistencën e një imperativi humanitar nënkupton një detyrë për të vepruar përballë vuajtjeve njerëzore, pa caktuar të drejta dhe detyra më specifike. Cilado qoftë baza për aktivitetet e ndihmës - dhe sigurisht motivimi për to përshkruhet më lehtë në kuptimin e dhembshurisë dhe dëshirës për të lehtësuar vuajtjet e të qenit njeri - ato sot u delegohen në një masë të madhe agjencive të specializuara të ndihmës, qeveritare dhe të tjerëve (Darcy, 1997).

Një standard të njëjtë e ndjekin edhe shumë akte dhe dokumentet juridike ndërkombëtare të miratuara më vonë. Për më tepër, të gjitha shtetet demokratike në kushtetutat e veta dhe legjislacionin e vet parashohin zbatimin e këtyre standardeve të përcaktuara në Deklaratën e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut. Në Republikën e Kosovës janë të inkorporuara në Kushtetut dhe parashihet aplikimi direkt disa akteve më të rëndësishme ndërkombëtare, duke përfshirë këtu në rend të parë Deklaratën Universale.

Për më tepër, vlen të veçohet se gjatë 20 viteve të fundit, është rritur ndërgjegjësimi për nevojën e forcimit, në nivelin kombëtar, të veprimit të bashkërenduar, që synon zbatimin dhe sigurimin e përputhshmërisë me normat dhe standardet e të drejtave të njeriut. Një nga mjetet e përdorura për të bërë këtë ka qenë krijimi i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (NHRI - National Human Rights Institutions). Ndërsa termi përfshin një sërë organesh emri i të cilëve (komisioni kombëtar i të drejtave të njeriut, ombudsmani, mbrojtësi publik, etj.), statusi ligjor, përbërja, struktura, funksionet dhe mandatet ndryshojnë, të gjitha organet e tilla janë ngritur nga qeveritë ose parlamentet për të funksionuar në mënyrë të pavarur - si gjyqësori - me qëllim promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut (Inter-Parliamentary-Union, 2016, p. 112).

Parimet themelore të të drejtave të njeriut – Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, kanë vendosur njëkohësisht edhe parimet mbi të cilat funksionojnë këto të drejta. Nga parimet themelore duhet përmendur: Dinjiteti njerëzor, Universaliteti dhe ndërvarësia e të drejtave, Barazia dhe mosdiskriminimi dhe pjesëmarrja (International guidelines on human rights and drug policy, 2019, p. 6). Këto parime janë të përmbajtura direkt ose indirekt, gati në të gjitha aktet juridike ndërkombëtare dhe të brendshme të të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim, në rend të parë vendoset dinjiteti njerëzor. Për shembull, në nenin e parë të Deklaratës së Përgjithshme për të drejtat e njeriut theksohet, “të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta”.

7. Instrumentet kryesore ndërkombëtare

Sot në botë janë miratuar me dhjetra akte juridike ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në luftën e ftohtë, kur të drejtat e njeriut kaluan nga sfera e brendshme në sferën ndërkombëtare. E kjo si aspiratë që rrjedhi nga dy luftrat botërore, të drejtat e njeriut filluan të trajtohen seriozisht dhe me vemendje të veçantë. Nga ajo kohë, duke filluar nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, janë miratuar, përveç akteve ndërkombëtare edhe shumë akte me karakter regional për të drejtat e njeriut. Në këtë rast është relevante të përmendet ajo që thekson Piechoëiak se “normat ligjore (e drejta e të drejtave të njeriut) nuk i përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore, ato vetëm i garantojnë ato. Fakti se veprimet e caktuara apo heqja dorë nga ato i takojnë një njeriu e ka bazën e vet primare në veçantinë e të qenit njeri. Kjo veçanti është gjithashtu bazë për caktimin e dinjitetit të çdo qenieje njerëzore. Çdo qenie njerëzore konsiderohet si qëllim në vete. Në këtë drejtim, askush nuk duhet të trajtohet si një mjet i thjeshtë edhe në qoftë se një trajtim i tillë do të ishte shumë i dobishëm për grupin apo për vetë individin” (Piechowiak M. , 1999, pp. 6-7).

Megjithatë, akte të rëndësishme të të drejtave të njeriut njihen edhe shumë kohë para Deklaratës Universale për të Drejtat e njeriut. E për të cilat mund të thuhetse janë frymëzim për aktet e nxjerra pas luftës së dytë botërore, ku dhe të drejtat e njeriut morën karakterin ndërkombëtar. Nga aktet më të njohura për të drejtat e njeriut, dhe që dallohen për nga aspekti i vlerës historike, njihen: *Karta e Madhe e Lirive e vitit 1215 (Magna Carta Libertatum)*, *Peticion i së Drejtës (Petition of Right) 1628*, *Ligji për të Drejtat i vitit 1689 (Bill of Rights)*, *Deklarata për Pavarësinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës 1776 dhe Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit 1789*.

Këto akte në avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, kanë luajtur rol të jashtëzakonshëm. Në këtë drejtim me të drejtë thekson teoricieni Bozhinovskise “Magna Karta ose Karta e Madhe e të Drejtave, është dokumenti i parë modern i cili përshkruhet si themeli i lirisë së individit kundër autoritetit arbitrar të despotit. Në thelb kjo Kartë parashikonte mbrojtjen e të drejtave të kishës, burgosjet e paligjshme nga baronët, qasjen në drejtësi të shpejtë dhe kufizimin e pagesave feudale ndaj Kurorës. Magna Carta përcakton parimin e sundimit të ligjit si mbrojtje e të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë personat nga ndjekja arbitrare dhe burgosja” (Bozhinovski, 2015, p. 175). Gjithashtu, autori

Bozhinovski thekson se “garancitë e pakta të parashikuara në këtë dokument përfaqësojnë gurin kryesor të parimit të Sundimit të Ligjit edhe në botën moderne, sepse parashikon garanci, të tilla si gjykimi nga juria, qasja në drejtësi të shpejtë, mbrojtja nga burgimet arbitrare dhe liritë e tjera civile të cilat janë përfshirë në dokumentet moderne ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive civile. Magna Carta edhe sot formon një simbol për lirinë, dhe është dokumenti më i cituar nga politikanët dhe mbahet me shumë respekt në komunitetet ligjore amerikane dhe britanike” (Bozhinovski, 2015, p. 176).

Gjithashtu, edhe aktet e shekullit XVII dhe XVIII, një rol dhe ndikim të jashtëzakonshëm kanë pasur në avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Akt i rëndësishëm që duhet përmendur është Peticioni për të Drejtën (Petition of Right) i 7 qershorit të vitit 1628. Ky akt është një dokument kryesor kushtetues anglez që përcakton liritë specifike të temës që mbreti është i ndaluar të shkelë (Kamruzzaman & Das, 2016, p. 8). Refuzimi nga Parlamenti për të financuar politikën e jashtme jopopullore të mbretit kishte bërë që qeveria e tij të përcaktojë hua të detyruara dhe të çerektojë trupat në shtëpitë e subjekteve si një masë ekonomike. Arrestimi dhe burgosja arbitrare për kundërshtimin e këtyre politikave kishte prodhuar në Parlament një armiçësi të dhunshme ndaj Charles dhe George Villiers, Duka i Buckingham. Peticioni për të Drejtën, i iniciuar nga Sir Edëard Coke, u bazua në statutet dhe kartat e mëparshme dhe pohoi katër parime: (1) Asnjë taksë nuk mund të merret pa miratimin e Parlamentit, (2) Asnjë subjekt nuk mund të burgoset pa treguar ndonjë shkak (riafirmimi i e drejta e habeas corpus), (3) Asnjë ushtar nuk mund të ndahet mbi qytetarët dhe (4) Ligji ushtarak nuk mund të përdoret në kohë paqeje (<https://ëëë.humanrights.com>, 2020).

Në këtë rast vlen të përmendet Ligji për të drejtat i vitit 1689, i cili ka përcaktuar “kufijtë e kompetencave të sovranit, dhe po ashtu, ka përcaktuar të drejtat e Parlamentit dhe rregullat për lirinë e fjalës në Parlament, kërkesën për zgjedhje të rregullta në Parlament dhe të drejtën për të bërë kërkesë monarkut pa frikë nga ndëshkimi” (Kamruzzaman & Das, 2016, p. 6). Gjithashtu, ç’është e rëndësishme se Ligji për të drejtat përcaktonte disa të drejta themelore për të gjithë anglezët, dhe këto të drejta vazhdojnë të zbatohen edhe sot, jo vetëm në Angli dhe Uells, por edhe në secilin prej juridiksioneve të fushave të Komonuelthit gjithashtu (Kamruzzaman & Das, 2016, p. 8).

Një rol mjaftë të rëndësishëm në avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut ka luajtur edhe deklarata e pavarësisë së Shteteve të Bashkuara, vlen të theksohet se Deklarata e

Pavarësisë së SHBA-së, pati një ndikim të jashtëzakonshëm ndërkombëtar, duke qenë e para e këtij lloji në të gjithë historinë që lidhi sovranitetin me pavarësinë (Cursaru, 2015, p. 8). Veç tjerash, duhet theksuar sesot parimet thelbësore të këtij dokumenti janë të pranishme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në shumë kombe në të gjithë botën. Padashur, ky dokument çoi në liri të mëtejshme në SHBA, siç është emancipimi i skllëvërve të zinj. Ky ishte një hap i madh drejt barazisë njerëzore gjatë gjithë shekullit të parë që nga miratimi i saj, të cilin dokumenti nuk kishte vendosur kurrë ta përmbushte (Cursaru, 2015, p. 8).

Tjetër dokument që paraqet rëndësi të veçantë historike, është Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit e vitit 1789. Në këtë drejtim, saktësisht e përshkruan edhe Shuresh Moradi, e cila thekson se “një nga instrumentet më domethënës të transformimit shoqëror, si dhe rezultati më i rëndësishëm i periudhës revolucionare, ishte Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit, e miratuar nga Asambleja Kombëtare Franceze, më 26 Gusht 1789” (Moradi, 2019, p. 1144). Është me shumë rëndësi të theksohet se “Në nenin 3 thuhet se sovraniteti qëndron në komb dhe se vullneti i përgjithshëm i njerëzve është burimi i legjitimitetit në një shtet shtet sovran. Ushtrimi i pushtetit nga qeveria nuk duhet të ndodhë në interes të sundimitarit, por përkundrazi, në interes të të sunduarit, dhe për më tepër, që sundimtarët t’i nënshtrohen kontrollit dhe fuqisë së kombit” (Moradi, 2019, pp. 1145-1146).

Instrumentet kryesore të të drejtave të njeriut të cilat kanë rrjedhë më vonë, janë nxjerrë pas përfundimit të luftës së dytë botërore. Këtyre u ka prijë një qasje e re e bashkësisë ndërkombëtare, e krijuar si rezultat i tmerreve të dy luftrave botërore që kishte përjetuar njerëzimi.

Veç tjerash është e një rëndësie të veçantë të përmendet, se termi "Të drejtat e njeriut" u përmend shtatë herë në Kartën themeluesetë Kombeve të Bashkuara. Njëherit, duke e bërë promovimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave një qëllim kryesor dhe parim udhëzues i Organizatës. Në vitin 1948, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, i solli të drejtat e njeriut në fushën e së drejtës ndërkombëtare. Që atëherë, Organizata ka mbrojtur me zell të drejtat e njeriut përmes instrumenteve ligjore dhe aktiviteteve në terren (<https://ëëë.un.org>, 2020). Që në preambulën e saj, Karta e Kombeve të Bashkuara përcakton që të “riafirmojë besimin në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e personave njerëzor, në të drejtat e barabarta të burrave dhe grave dhe të kombeve të mëdha dhe të vogla, dhe të vendosë kushte nën të cilat drejtësia dhe respektimi i detyrimeve që rrjedhin nga traktatet dhe të tjera burimet të së drejtës ndërkombëtare mund të mirëmbahen dhe të promovojnë

progresin shoqëror dhe standardet më të mira të jetës në një liri më të madhe” (Pjesë nga Preambula e Kartës). Nga kjo del se “Karta e Kombeve të Bashkuara në tërësi është e frymëzuar me idenë e promovimit, mbrojtjes dhe përparimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” (Musliu, 2013, p. 2). Vlen të theksohet se “në konferencën themeluese në San Francisko, ishte e pamundur, për shkak të mungesës së kohës, plotësimi i Kartës me një katalog të shkruar për të drejtat e njeriut. Sidoqoftë, u mor vendimi për krijimin e një katalogu të tillë menjëherë pas hyrjes në fuqi të Kartës, përmes organit përkatës të specializuar, Komisionit për të Drejtat e Njeriut” (<https://www.un.org>, 2020).

Mund të saktësohet se “Karta e Kombeve të Bashkuara ka ndërkombëtarizuar konceptin e të drejtave të njeriut. Para miratimit të Kartës në 1945 të drejtat e njeriut u konsideruan si çështje të brendshme të shteteve. Bazuar në konceptin e ligjit dhe sovranitetit, secili shtet ka versionin e tij të të drejtave të njeriut në varësi të ideologjisë politike, fesë dhe kulturës së shtetit. Sipas këtij versioni të brendshëm të të drejtave të njeriut, asnjë shtet i huaj ose ndonjë organizatë ndërkombëtare nuk mund të ndërhyjë. Miratimi i Kartës shënoi marrëveshjen e anëtarëve të Kombeve të Bashkuara për të pranuar pikëpamjen e ndërkombëtarizuar për të drejtat e njeriut” (Zakariah, 2017, p. 189).

Nga aktet më të rëndësishme për të drejtat e njeriut, të miratuara që nga përfundimi i luftës së dytë botërore dhe nga themelimi i Kombeve të Bashkuara, e të cilat gjejnë aplikim të gjerë sot në të drejtën ndërkombëtare dhe atë shtetërore, dallohen:

Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut—Njëri nga dokumentet më të rëndësishëm për të Drejtat e njeriut, i miratuar nga Kombet e Bashkuara, pak vite pas themelimit të OKB-s, është pa dyshim Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut. Kjo Deklaratë “është instrument i parë gjithëpërfshirës për të drejtat e njeriut që është shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor të vitit 1948. Në Deklaratën Universale janë dalluar në veçanti të drejtat dhe liritë themelore të njeriut që janë shkelur brutalisht gjatë viteve të dyzeta të shekullit XX” (Musliu, 2013, p. 3). Prandaj, me të drejtë edhe theksohet se “Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut doli nga hiri i Luftës së Dytë Botërore” (Broën, 2016, p. 29). Gjithashtu, në këtë drejtim vlen të theksohet se, “me përfundimin e konfliktit dhe krijimin e Kombeve të Bashkuara, komuniteti ndërkombëtar u zotua që kurrë më të mos iu përmbahej mizorive të patregueshme që bota sapo kishte parë. Kështu që udhëheqësit e botës vendosën të amplifikojnë Kartën e KB-së duke futur dhe inkurajuar garanci për të drejtat e qenieve njerëzore kudo që ndodhen” (Brown, 2016, p. 29).

Veç tjerash, duhet theksuar se pavarësisht, se “Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut ishte vetëm një dokument deklarues dhe jo i detyrueshëm për shtetet, ai hapi rrugën për institucione të shumta ndërkombëtare të dizajnuara për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut” (DUTTON, 2012, p. 11).Për më tepër, vlen theksuar se deklarata ishte një udhërrëfyes i trajtimit të të drejtave të njeriut në nivel global.

Rëndësia e Deklaratës së Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) është tejet e madhe që nga miratimi i saj e deri më sot. Së këndejmi me të drejtë shkruan Elsa Stamatopoulou se “DUDNJ ishte një përparim dhe një revolucion në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe ka mbetur një burim i vazhdueshëm frymëzimi që nga viti 1948. Ajo është një dokument i gjallë në praktikën e Kombeve të Bashkuara, tashmë pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare. Kombet e Bashkuara, përmes historisë së tyre, i kanë mbajtur vendet përgjegjëse nën standardet e larta të DUDNJ, pavarësisht nëse ato ishin shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara apo jo. Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të hartuara më pas duhej të ishin në përputhje dhe gjithmonë të frymëzoheshin nga DUDNJ” (Stamatopoulou, 1999).

Po ashtu, deklarata ishte një burim kryesor referimi për hartuesit e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ, një dokument qendror i Këshillit të Evropës).Veç tjerash, KEDNJ disa herë i referohet Deklaratës në preambulën e saj, dhe shumë prej neneve të saj janë frymëzuar dhe rrjedhin nga Deklarata. Sidoqoftë, KEDNJ është e kufizuar në të drejtat civile dhe politike, pasi hartuesit e saj i konsideruan të drejtat ekonomike dhe sociale shumë të diskutueshme dhe të vështira për t'u zbatuar. Sot, Deklarata luan një rol të rëndësishëm në drejtimin e politikave të jashtme të BE dhe është një referencë e dobishme për mënyrën në të cilën BE koncepton të drejtat themelore (<https://www.europarl.europa.eu>, 2020).

Paktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut – Ndër akte të rëndësishme për të drejtat e njeriut me karakter ndërkombëtar dhe gjithpërfshirës, janë dy paktet për të drejtat e njeriut: *Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike*, dhe *Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*.

Duhet përmendur që, “edhe pse ka ekzistuar plani në të cilin si hap vijues për materien e të drejtat e njeriut të rregullohet përmes një konvente gjithëpërfshirëse ndërkombëtare, e cila do ta mbante titullin Karta për të Drejtat e Njeriut, por ndarja e atëhershme bipolare e blloqeve perëndimor dhe lindor ka sjellur deri te miratimi i dy dokumenteve veçmas, i dy pakteve ndërkombëtare për të drejta e njeriut: Paktit për të Drejta Civile dhe Politike, dhe Paktit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Miratimi i këtyre akteve ka bërë një hap të mëtejshëm në sistematizimin e standardeve për të drejtat e njeriut dhe përparimit të mëtejme të mekanizmit për mbikëqyrje në pikëpamje të zbatimit të tyre”(Musliu, 2013, p. 5).

Gjithashtu, *Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP)* “është një traktat ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, që ofron një sërë mbrojtjesh për të drejta civile dhe politike. Është i hapur për ratifikim për të gjitha shtetet, kështu që ka rëndësi universale. Pakti, dhe dy Protokollet e tij Opsionale, janë pjesë e Projektligjit Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut, së bashku me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK) dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ)”(Haxhiraj, 2013, p. 308).

Është me rëndësi të theksohet se, të drejtat civile dhe politike dhe të drejtat ekonomike dhe sociale kulturore, u ndanë artificialisht dhe iu dha hierarki në të drejtat ndërkombëtare të njeriut gjatë luftës së ftohtë. Mirëpo, kjo nuk qëndron gjithmonë edhe tek mekanizmat rajonalë të të drejtave të njeriut. Për tu përmendur është që në mekanizmin Afrikan për të Drejtat e Njeriut, statuti vendos të njëjtën bazë për të drejtat civile dhe politike, dhe të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore (PWESCR Report, 2015, p. 32).

Po ashtu, me rëndësi për tu theksuar është se “Pakti për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore, për dallim nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i cili kërkon pa kompromis zbatimin e çdo të drejte të njeriut, obligimet e shteteve i formulon në atë mënyrë që lë hapësirë të tu zbatuar në jetë aq sa mundëson situata ekonomike” (Musliu, 2013, p. 6). Gjithashtu, është me rëndësi të theksohet se “Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, përveç që përmban një katalog ekstensiv të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, i përshkruan në detaje, definon dhe cakton hapat që duhet ndërmerren për realizimin e tyre” (Musliu, 2013, p. 6).

8. Mekanizmat institucional ndërkombëtar

Në botë sot ekzistojnë institucione të shumta, që merren me proklamimin dhe mbikëqyrjen e të drejtave të njeriut. Mekanizmat ndërkombëtar vazhdimisht janë shtuar dhe janë përsosur, për të ofruar një mbrojtje sa më të mirë të të drejtave dhelirive të njeriut. Që nga përfundimi i luftës së dytë botërore dhe themelimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, përkushtimi ndaj të drejtave të njeriut paraqet një sferë të veçantë ndërkombëtare. Po ashtu njëherit konsiderohet edhe ndër çështjet më të rëndësishme në kontekst të ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, si dhe matësi më i mirë i zhvillimit të demokracisë.

Natyrisht, me fuqizimin e institucioneve ndërkombëtare, logjikshëm është ndikuar edhe në fuqizimin e mekanizmave dhe institucioneve shtetërore. Në këtë pikëpamje vlen të theksohet se, “që nga miratimi i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) më 1948, ka pasur një përmirësim progresiv në çështjet e të drejtave të njeriut në të gjithë botën” (SESRIC Kudus Cad. Report, 2019, p. 5). Duhet theksuar se “traktatet e detyrueshme ndërkombëtare përbëjnë themelin dhe substancën kryesore të regjimit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, ideja është që natyra detyruese e këtyre institucioneve ndërkombëtare mund t'i bëjë ato një instrument të fortë dhe efektiv për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat globale të njeriut. Traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut miratohen dhe hapen për nënshkrim nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe kërkojnë nënshkrime dhe ratifikime nga një numër i caktuar i vendeve për të hyrë në fuqi. Vetëm duke ratifikuar ose aderuar në traktat (i cili është procesi që shtetet përdorin kur nuk e kanë nënshkruar më parë traktatin) shtetet janë të lidhura ligjërisht nga kushtet e traktatit” (DUTTON, 2012, pp. 11-12).

Një mekanizëm i përgjithshëm i organeve për mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave të njeriut është i krijuar brenda Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Duhet theksuar që këto organe monitorojnë, duke siguruar që mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të kryhet në përputhje me dispozitat e të gjitha konventave ndërkombëtare dhe protokolleve në lidhje me to. Këto organe janë: (a) Komiteti për të Drejtat e Njeriut; (b) Grupi i Tresheve; (c) Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore; (d) Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor; (e) Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj

Grave; (f) Komiteti kundër Torturës; dhe (g) Komiteti për të Drejtën e Fëmijëve. Në këtë drejtim, gjithashtu duhet përmendur se, këto organe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut mbikëqyrin zbatimin e Konventës përkatëse Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut duke rishikuar informacionin e marrë nga të gjitha burimet e besueshme, përfshirë Raportet nga Shtetet Palë, Organizatat Ndërqeveritare dhe Jo-Qeveritare dhe komunikimet që pretendojnë shkeljen e të drejtave të njeriut të marra nga ose në emër të viktimave të shkeljeve të tilla (Dhupdale, 2010, p. 2).

E rëndësishme është të përmendet, se organet e traktatit për të drejtat e njeriut janë komitete të ekspertëve të pavarur, që monitorojnë zbatimin e traktateve thelbësore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Çdo shtet palënënshkrues në një traktat, ka një detyrim. Të ndërmarrë hapa për të siguruar që të gjithë shtetasit të mund të gëzojnë të drejtat e përcaktuara në traktat. Përveç kryerjes së rishikimeve periodike të pajtueshmërisë së Shtetit, disa prej organeve të traktatit, gjithashtu mund, në kushte të caktuara, të marrin ankesa individuale në lidhje me shkeljet (ose shkeljet e parashikuara) të të drejtave të njeriut. Në raste të tilla ata mund të kërkojnë masa të përkohshme (të tilla si ndalimi i dëbimit) derisa të mund të nxjerrin një vendim mbi meritën për çështjen. (<https://www.refworld.org/humanrights.html>, 2020).

Përveç mekanizmave të krijuar në kuadër të Kombeve të Bashkuara, janë krijuar edhe mekanizma dhe sisteme regjionale të të drejtave të njeriut. Ndër to si më progresive që vlen të dallohen në këtë rast janë: Sistemi regjional evropian mbi të drejtat e njeriut, sistemi inter-amerikan i të drejtave të njeriut dhe Sistemi afrikan i të drejtave të njeriut.

Detyrimet e dala nga traktatet ndërkombëtare, natyrisht kërkojnë edhe jetësimin e tyre në praktikë. Prandaj janë themeluar edhe mekanizma për monitorimin e zbatimit të traktateve. Andaj, duhet theksuar se “kur një vend pranon një nga këto traktate përmes ratifikimit, aderimit ose trashëgimisë, ai merr një detyrim ligjor për të zbatuar të drejtat e përcaktuara në atë traktat. Por ky është vetëm hapi i parë, sepse njohja e të drejtave në letër nuk është e mjaftueshme për të garantuar që ato të gëzohen në praktikë” (<https://www.ohchr.org>, 2020).

Me rëndësi është të përmendet se, zbatimi i shtatë traktateve kryesore të të drejtave të njeriut, monitorohet nga shtatë organet e monitorimit të traktateve për të drejtat e njeriut, e që janë:

1. *Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor* (KEDR), organi i parë i traktatit që u krijua, ka monitoruar zbatimin e Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor që nga 1969.
2. *Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore* (KDESK). u krijua në 1987 për të kryer mandatin e monitorimit të Këshillit Ekonomik dhe Social nën Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.
3. *Komiteti për të Drejtat e Njeriut* (KDNJ) që u krijua në 1976 për të monitoruar zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.
4. *Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave* (KEDG) .Ky komitet ka monitoruar zbatimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave,nga shtetet e tij palë, që nga viti 1982.
5. *Komiteti Kundër Torturës* (KKT), i krijuar në vitin 1987, mbikëqyr zbatimin e Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese.
6. *Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve* (KDF), që nga viti 1990, ka monitoruar zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve nga shtetet e tij palë, si dhe dy Protokolle
7. Opsionale të CRC për fëmijët ushtarë dhe shfrytëzimin e fëmijëve.
8. *Komiteti për Punëtorët emigrantë* (KPM) mbajti seancën e tij të parë në Mars 2004 dhe do të monitorojë zbatimin e Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Të gjithë Punëtorëve Emigrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre (<https://www.ohchr.org>, 2020).

KREU I KATËR

MBROJTJA DHE GARANTIMI I TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT NË SISTEMIN JURIDIK TË RKS-sës

Ashtu si të gjitha shtetet demokratike, edhe Kosova u kushton një vemendje jashtëzakonisht të madhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Meqenëse Kosova është pjesë e Evropës, dhe ka synim integrimin në Bashkimin Evropian, natyrisht, primare për të është zhvillimi shtetëror dhe institucional konformë legjislacionit evropian. Në këtë drejtim, duhet precizuar se Bashkimi Evropian vazhdimisht proklamon si vlerë themelore dinjitetin njerëzor, kështu në traktatin e fundit të Bashkimit Evropian, traktatin e Lisbonës, është përcaktuar se “Bashkimi ka në themel vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Këto vlera janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare në një shoqëri në të cilën mbisundon pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia midis grave dhe burrave” (neni 2).

Në këtë kontekst, konformë legjislacionit të Bashkimit Evropian, Kushtetuta e Republikës së Kosovës precizon se “rendi kushtetues i **RKS-sës** bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut” (neni 7, par.1). Vlen të theksohet se disa kushtetuta parashohin aplikimin direkt të traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ndërsa disa të tjera brenda shtetit, përmes nxjerrjes së ligjeveparashohin fuqizimin e tyre. Në këtë kontekst Kushtetuta e **RKS-sës** ka paraparë që “marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga RKS-ë, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji” (neni 19, par. 1). Sa i përket zbatimit të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Kushtetutat e **RKS-sës** ka paraparë që të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe

instrumentet ndërkombëtare, garantohen dhe zbatohen drejtpërdrejtë në **RKS-sës** dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike, dhe në nenin 22 në mënyrë taksative Kushtetuta i përmend këto akte ndërkombëtare për të drejtat e njeriut:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (neni 22, par. 1-8).

1. Sistemi Kosovar i të drejtave të njeriut

Siç kemi theksuar edhe më lartë, Kosovës në orientimin e saj drejtë integritimeve evropiane, pa dyshim që i është dashur të ndërtoj sistemin e saj kushtetues dhe ligjor konformë Bashkimit Evropian, andaj, në këtë kontekst “shumica e parimeve në lidhje me barazinë dhe të drejtat e njeriut të BE-së janë transferuar drejtpërsëdrejti edhe në legjislacionin e Kosovës.

Kosova i ka përvetësuar në kushtetutën e saj konventat e të drejtave të njeriut, duke i vendosur ato mbi legjislacionin e brendshëm dhe duke i bërë ato drejtpërdrejtë të zbatueshme nga gjykatat dhe administrata publike. Përveç kësaj janë hartuar dhe miratuar edhe një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore për të mbrojtur dhe promovuar standardet e të Drejtave të Njeriut, duke mbuluar rastet e diskriminimit dhe barazisë gjinore, si dhe forcimin e organeve të së Drejtave të Njeriut dhe mandatin e Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës” (Raport i KIPRED, GLPS dhe Artpolis, 2017, p. 4).

Ajo që ka një rëndësi të posaçme për tu përmendur këtu është se “në hierarkinë e akteve në Kosovë, marrëveshjet/traktatet ndërkombëtare qëndrojnë në një nivel më të lartë se ligjet kombëtare, por në një nivel më të ulët se Kushtetuta e **RKS-sës**. Megjithatë, kur kemi të bëjmë me inkorporimin e traktateve të të drejtave të njeriut, pra të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Kushtetuta e Republikës së Kosovës i ka dedikuar dispozita të veçanta” (Bajrami, et al., 2019, p. 153). Në këtë rast thekson me të drejtë edhe Kristina Marie Hon, se neni 22 i Kushtetutës së **RKS-sës**, është pa dyshim, dispozita më e re kushtetuese. Dhe potencialisht edhe më e re në historinë e artit të hartimit të kushtetutës. Me titull ‘Zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare’, neni rendit tetë traktate ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara në të janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës. Kështu dhe në rast konflikti, kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike (Hon, 2013, p. 17), siç e kemi përmendur edhe më lartë. Veç të tjerash, “për dallim nga marrëveshjet ndërkombëtare të tjera, ato të përmendura në nenin 22 të Kushtetutës, janë në të njejtin nivel të hierarkisë me Kushtetutën, madje kanë përparësi në rast konflikti me të” (Bajrami, et al., 2019, p. 154). Gjithashtu, duhet përmendur se “promovimi dhe zbatimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve të Kosovës është i rregulluar me akte të ndryshme legjislative civile dhe penale, duke përfshirë pakon e legjislacionit të të drejtave të njeriut (p.sh. ligji kundër diskriminimit, ligji për Avokatin e Popullit dhe ligji për barazi gjinore), që ka hyr në fuqi në korrik të vitit 2015” (Raport -ERAC, 2016). Duhet theksuar së në Republikën e Kosovës, përveç bazës kushtetuese, si dhe pakos legjislative për të drejtat e njeriut, legjislacioni ku parashihen të drejtat e njeriut është shumë më i gjerë.

2. Inkorporimi i standardeve ndërkombëtare

Republika e Kosovës mund të thuhet se, për më shumë se një dekadë nga shpallja e shtetësisë, ka arritur të kompletojë infrastrukturën ligjore gati në të gjitha fushat, përfshi këtu edhe të drejtat e njeriut. Konformë synimeve të veta integruese, Kosova ka inkorporuar dhe

përshtatur standardet ndërkombëtare në të gjitha fushat, e posaçërisht nga fusha e të drejtave të njeriut. Aktet më të rëndësishme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut janë inkorporuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Edhe para shpalljes së pavarësisë dhe miratimit të Kushtetutës, Korniza Kushtetuese që ishte në fuqi deri në atë kohë, ka rregulluar çështjen e të drejtave e njeriut .Kështu që dhe ka paraparë aplikimin e akteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në kreun e tretë të Kornizës Kushtetuese ishte paraparë aplikimi i disa akteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Pika 3.2 kishte parashikuar se “institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë kriteret e pranuar në arenën ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë ato të drejta dhe liri të parashtruara në:

- (a) Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut;
- (b) Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e Saj;
- (c) Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe Protokollet e Saj;
- (ç) Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial;
- (d) Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- (dh) Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
- (e) Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare dhe
- (ë) Konventën Kornize të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare” (kreu i 3, pika 3.2).

Kushtetuta e Kosovës e miratuar më 2008 pas shpalljes së pavarësisë, ka paraparë në nenin 22, po ashtu aplikimin e 8 akteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Njëjste si edhe Korniza Kushtetuese, por duke përjashtuar Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare. Por gjithsesi duke inkorporuar Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. Parimet themelore kushtetuese për të drejtat e njeriut i ka përcaktuar Neni 21 i Kushtetutës, ku theksohet se:

1. Të drejtat dhe liritë e njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të **RKS-sës**.
2. **RKS-ë** mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë e njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.
3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.
4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme (neni 21).

Nga kjo shihet qartë se, Kushtetuta e Kosovës inkorporon dhe parasheh parimet themelore për të drejtat dhe liritë e njeriut. Njëhërit duke precizuar standardet ndërkombëtare të rregulluara nga konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Parimet e precizuara në kushtetutë gjenden në të gjitha aktet e rëndësishme të të drejtave të njeriut, duke filluar nga Deklarata e përgjithshme e vitit 1948.

Duke pasur parasysh faktin e aspirimit të Kosovës në Bashkimin Evropian, si edhe në organizatat e tjera ndërkombëtare, është e udhës të theksohet në këtë rast, se legjislacioni i Kosovës në tërësi i është përshtatur standardeve ndërkombëtare. E konkretisht me vëmendje të posaçme në fushën e të drejtave të njeriut, të cilave sot në botë u jepet një vend meritore dhe i posaçëm.

Gjithashtu, vlen të theksohet se, trajtimi i të drejtave dhe lirive të njeriut është jashtëzakonisht në një nivel të avancuar në Kushtetutë, dokumente dhe akte ligjore. Por sfida për institucionet e shtetit të Kosovës ngelet zbatimi i legjislacionit. Në këtë kuptim, një numër i madh i organizatave ndërkombëtare dhe lokale, të cilat monitorojnë procesin e zbatimit të ligjeve të të drejtave të njeriut dhe të pakicave në **RKS-sës**, ka shqetësime për mos zbatimin e tyre në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha fushat. Për shembull, ligji kundër diskriminimit dhe ligji mbi mbrojtjen kundër dhunës familjare janë zbatuar pjesërisht, dhe janë ndërmar pak masa për zbatimin e ligjeve që rregullojnë të drejtën e gjuhës dhe të drejtat e pakicave (Task Forca për Integrim Evropian , 2020, p. 4).

3. Katalogu kushtetues: Kapitujt II dhe III

Kushtetuta e **RKS-sës** në (kapitujt II dhe III të Kushtetutës), vend qendrorë u jep të drejtave të njeriut. Sidomos një vend të veçantë në Kushtetutë zënë të drejtat e komuniteteve, ku janë të vendosura në një kapitull të veçantë të Kushtetutës. Natyrisht, për shkak të komunitetit serbë, dhe problemeve tashmë të njohura që Kosova ka pasur në vazhdimësi me Serbinë, ka qenë e detyruar të rregullojë posaçërisht çështjet që kishin të bëjnë me komunitetin serbë. Kështu që në këtë kontekst edhe me komunitetet e tjera. Pa dyshim që “normat kushtetuese të këtyre dy kapitujve kanë një status të privilegjuar. Ky status i privilegjuar i lirive dhe të drejtave njerëzore rrjedh nga dy burime: nga vetë Kushtetuta e Kosovës dhe nga zotimi i njëanshëm ndërkombëtar për të vënë në jetë në tërësi shkronjën, frymën dhe shpirtin e Paktit Ahtisari, zotim që ka efekt erga omnes. Cilësia e fundit ka të bëjë, në rend të parë dhe mbi të gjitha, me mbrojtjen e komuniteteve pakicë dhe qeverisjen e mirë, për çka Kosova po ashtu është zotuar ndërkombëtarisht në mënyrë të njëanshme” (Bajrami, et al., 2019, p. 43).

Ajo që vërehet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nuk janë të sistematizuara veç e veç të drejtat civile dhe politike, të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore dhe të drejtat kolektive, por të gjitha gjenden të përmbledhura në këta dy kapituj (Bajrami, et al., 2019, pp. 43-45). Në kapitullin e II, saktësisht në nenin 22, siç është trajtuar edhe më lartë, janë inkorporuar tetë akte më të rëndësishme juridike ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat gjejnë zbatim direkt në Republikën e Kosovës.

Kushtetuta në mënyrë të veçantë ka paraparë në kapitullin e II, dispozita specifike që mbrojnë të drejtat civile dhe politike (p.sh., të drejtat për proces të rregullt gjyqësor, e drejta e privatësisë dhe liria e shprehjes, liria e tubimit paqësor, liria e asociimit dhe liria e lëvizjes), si dhe disa të drejta ekonomike, shoqërore dhe kulturore (p.sh., e drejta për arsimin dhe liria e zgjedhjes së profesionit). Vlen të theksohet se neni 53 kërkon se interpretim i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës të bëhet në harmoni dhe sinkron me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Raport i UNMIK dhe OHCHR, 2020). Gjithashtu, duhet theksuar se “në lidhje me të drejtat individuale, Kapitulli II parashikon 35 nene kushtuar të drejtave themelore të individit, duke filluar nga të drejtat për jetën dhe integritetin e deri tek privatësia dhe familja. Sipas Kapitullit III, në lidhje me të drejtat kolektive, komunitetet kanë të drejtë për respekt të plotë ndaj

gjuhëve dhe zakoneve të tyre, si dhe për përfaqësim të tepërt në institucionet politike dhe administrative” (Group for Legal and Political Studies, 2017).

Kushtetuta përcakton parimet e përgjithshme të të drejtave dhe lirive të njeriut, ku dhe ka precizuar se “të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës” (neni 21, par. 1). Kushtetuta, po ashtu përcakton se, “dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” (neni 23). Gjithashtu, Kushtetuta përcakton parimin e barazisë para ligjit pa asnjë lloj diskriminimi, ku precizohet se, “të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal” (neni 24, par. 1-2). Vlen të theksohet se, barazia në ligj dhe para ligjit, si dhe ndalimi i diskriminimit janë parime të përgjithshme, çka dhe kushtëzojnë gëzimin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Barazia në ligj dhe përpara ligjit është trajtimi i barabartë i të gjithë shtetasve, si në procesin ligjvënës, ashtu edhe në zbatimin e tij. Për më tepër, barazia ka dy kuptime: është parim kushtetues dhe e drejtë themelore (e drejta për trajtim të barabartë) (Manual për Organizatat Jofitimprurëse, 2011, p. 11).

Krahas të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë në kapitullin II, komunitetet e caktuara gëzojnë edhe të drejta të veçanta të garantuara me Kushtetutë. Neni 57 i Kushtetutës ka përcaktuar që “banorët që i përkasin një grupi të njëjtë etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute” (neni 57, par. 1). Për më tepër kushtetuta e vesh me përgjegjësi shtetin e Kosovës që të “siguroj kushtet e duhura, të cilat u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre. Qeveria do të përkrahë veçanërisht nismat kulturore të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përfshirë këtu edhe nëpërmjet ndihmës financiare” (neni 58, par. 1).

Po ashtu, Kushtetuta e obligon Shtetin e Kosovës që të promovoj frymën e tolerancës, dialogut dhe të mbështesë pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe të respektoj standardet e

përcaktuara me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave (neni 58, par. 2).

Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre Kushtetuta ka precizuar në mënyrë taksative, ku dhe është paraparë që pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet:

- 1) të shprehin dhe avancojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë e mbrojnë elementet thelbësore të identitetit të tyre. Pra, fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre;
- 2) të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet, në njërën nga gjuhët zyrtare të **RKS-sës**, sipas zgjidhjes së tyre;
- 3) të marrin arsimim publik para fillor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre, deri në masën e përcaktuar me ligj. Ku dhe pragu për themelimin e paraleleve a shkollave të veçanta për këtë qëllim, do të jetë më i ulët sesa ai që përcaktohet rëndom për institucionet arsimore;
- 4) të themelojnë dhe të menaxhojnë institucionet private të arsimit dhe trajnimit, për të cilat mund të jepet ndihma financiare publike. Gjithnjë në pajtim me standardet ndërkombëtare;
- 5) të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre lirisht në jetën private dhe publike;
- 6) të përdorin gjuhën e tyre në marrëdhëniet e tyre me autoritetet komunale ose me zyrat lokale të autoriteteve qendrore, në fushat në të cilat ata përfaqësojnë një pjesë të mjaftueshme të popullatës, në pajtim me ligjin. Shpenzimet e bëra për interpretuesit ose përkthyesit, do të mbulohen nga autoritetet kompetente;
- 7) të përdorin simbolet e komunitetit, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
- 8) të regjistrojnë emrat personal në formën e tyre origjinale dhe në shkrimin e gjuhës së tyre, si dhe emrat e tyre t'i kthejnë në formën origjinale, nëse u janë ndryshuar me dhunë;
- 9) të kenë emërtime lokale, emërtime të rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë, që pasqyrojnë dhe janë të ndjeshëm ndaj karakterit shumetnik dhe shume gjuhësor të zonës përkatëse;
- 10) të kenë qasje të garantuar dhe përfaqësim të veçantë në mediat transmetuese publike si dhe programet në gjuhën e tyre, në pajtim me standardet ndërkombëtare;
- 11) të krijojnë mediat e tyre vetjake, përfshirë këtu ofrimin e informacioneve në gjuhën e tyre. Ndër të tjera, përmes gazetave ditore e shërbimeve kabllore, dhe përdorimin e një numri të rezervuar të frekuencave për mediat elektronike, në pajtim me ligjin

dhe standardet ndërkombëtare. RKS-ë do të marrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e një plani ndërkombëtar të frekuencave, për t'i mundësuar komunitetit Serb në Kosovë qasje në një kanal televiziv të pavarur, të licencuar në gjuhën Serbe, në mbarë **RKS-ën**;

- 12) të gëzojnë kontakte të papenguara ndërmjet tyre përbrenda **RKS-sës**, dhe të themelojnë e të mbajnë kontakte të lira dhe paqësore me personat në cilindo shtet. Sidomos me ata që kanë të përbashkët identitetin etnik, kulturor, gjuhësor a fetar, ose trashëgiminë e përbashkët kulturore, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
- 13) të gëzojnë kontakte të papenguara me dhe të marrin pjesë, pa diskriminim, në aktivitetet e organizatave joqeveritare lokale, rajonale dhe ndërkombëtare;
- 14) të themelojnë shoqata të kulturës, artit, shkencës dhe arsimit, si dhe shoqata të studiuesve e shoqata të tjera për shprehjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre (neni 59, par. 1-14).

Përveç këtyre të drejtave, është për tu përmendur që edhe në pozita të ndryshme në kuadër të pushtetit lokal janë paraparë rezervim të pozitave të caktuara për komunitetet. Në këtë rast mjafton të përmendet nenin 62 i Kushtetutës, në të cilin parashihet se “në komunat në të cilat së paku dhjetë për qind (10%) të banorëve u përkasin komuniteteve, të cilat në ato komuna nuk janë shumicë, posti i zëvendëskryetarit për komunitete të kuvendit të komunës do të rezervohet për një përfaqësues nga radhët e këtyre komuniteteve” (neni 62, par.1).

Të drejtat e komuniteteve kanë pasur vend të posaçëm në Kosovë edhe para shpalljes së pavarësisë dhe miratimit të Kushtetutës më 2008. Vlen të përmendet se edhe në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme, të drejtave të komuniteteve u është kushtuar rëndësi e veçantë. Kreu i katërt i Kornizës Kushtetuese flet ekskluzivisht për të drejtat e komuniteteve. Veç tjerash në Kornizën Kushtetuese kanë qenë të listuara një numër mjaft i madh i të drejtave të komuniteteve. Pika 4.4 e Kreut të katër të Kornizës Kushtetuese ka përcaktuar që komunitetet dhe anëtarët e tyre kanë të drejtë:

- 1) Të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre, duke përfshirë përdorimin e saj para gjykatave, organizmave dhe organeve të tjera publike të Kosovës;
- 2) Të arsimohen në gjuhën e tyre amëtare;
- 3) Të drejtën për informacion në gjuhën e tyre;

- 4) Të kenë të drejta të barabarta në lidhje me punësimin në organet publike të të gjitha niveleve dhe në shërbimet publike të të gjitha niveleve;
- 5) Të kenë kontakte të papenguara me njëri-tjetrin dhe me anëtarët e komuniteteve të tyre, brenda dhe jashtë Shtetit;
- 6) Të përdorin simbolet e komunitetit sipas ligjit;
- 7) Të krijojnë shoqata për interesat e komunitetit;
- 8) Të kenë kontakte të papenguara dhe të marrin pjesë në organizatat lokale, rajonale dhe ndërkombëtare joqeveritare në përputhje me procedurat e këtyre organizatave;
- 9) Të ofrojnë informacion në gjuhën dhe alfabetin e komunitetit të tyre, duke përfshirë krijimin e mediave të tyre;
- 10) Të ofrojnë arsim dhe të krijojnë institucione arsimore. Ne veçanti për shkollimin në gjuhën, alfabetin dhe kulturën e tyre .Po ashtu dhe në historinë e komunitetit të tyre, për të cilën ofrojnë ndihmë financiare, duke përfshirë fondet publike në përputhje me ligjin e zbatueshëm. Megjithatë, me kusht që plan programi të respektojë ligjin e zbatueshëm dhe të reflektojë frymën e tolerancës midis komuniteteve dhe respektin për të drejtat e njeriut dhe traditat kulturore të të gjitha komuniteteve;
- 11) Të nxisin respektin për traditat e komuniteteve;
- 12) Të ruajnë vendndodhjet me rëndësi fetare, historikë ose kulturore për komunitetin në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse;
- 13) Të marrin shërbime shëndetësore publike dhe shërbime shoqërore, mbi baza jo diskriminuese, në përputhje me standardet e aplikueshme;
- 14) Të venë në funksionim institucionet fetare;
- 15) T'u garantohet përfaqësim në mediat elektronike publike, si dhe të kenë programe në gjuhët e tyre dhe
- 16) Të financojnë veprimtaritë e tyre duke mbledhur kontribute vullnetare nga anëtarët e tyre ose nga organizata jashtë Kosovës, ose duke marrë financime të tilla të cilat mund të ofrohen nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes ose nga autoritetet publike lokale përderisa financimi i tillë të bëhet në një mënyrë plotësisht transparente (kreu i 4, pika 4.4).

4. Legjislacioni dhe zbatimi i tij

RKS-sës tashmë ka krijuar një gamë të gjerë të legjislacionit, dhe ka ndërtuar mjaftueshëm institucione për jetësimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij legjislacioni. Megjithatë, nevoja për krijimin e një efikasiteti më të madhe ekziston edhe tani. Në këtë drejtim, janë një varg dokumentesh, të prodhuara nga qeveria e **RKS-sës**.

Institucionet e BE-së, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të lokale dhe shkollarët individualë, që vënë në dukje se ekziston një kornizë solide ligjore përkitazi me të drejtat e njeriut dhe të pakicave në Kosovë. Prapëseprapë, institucionet e Kosovës kanë mungesë të stafit të trajnuar profesional, mungesë të efikasitetit në arritjen e qëllimeve dhe mungesë buxheti të kënaqshëm që të mundësonte zbatimin e veprimeve (<http://www.mei-ks.net>, 2020). Gjithashtu, është lehtë e konstatueshme se, “çështja e realizimit të të drejtave të njeriut lidhet dhe është e kushtëzuar me zbatimin efektiv të ligjeve. Në përgjithësi, mos zbatimi i ligjeve është pengesa madhore ndaj mbrojtjes, të të drejtave dhe lirive të njeriut. Megjithëse miratimi i ligjeve dhe harmonizimi i tyre me standardet e BE-së është një proces mjaft sfidues dhe tepër i rëndësishëm në rrugën dhe perspektivën e vendit drejtë integritit në BE, stadi aktual i zhvillimeve shoqërore, ekonomike e politike në të cilën po kalon Kosova ,duhet te ndërmarrë e hapa më konkretë dhe më të koordinuar për zbatimin me efektiv të tyre” (Strategjia dhe plani i veprimit për të DNJ, 2013).

Një rëndësi e veçantë në **RKS-sës** u është kushtuar të drejtave të komuniteteve. Por është e qartë se, të drejtat e njeriut janë universale dhe u takojnë të gjithë njerëzve. Prandaj, ajo që është e qartë, është se të drejtat e njeriut nuk janë brengë vetëm e minoriteteve. Ato janë brengë e secilit, pasi që kanë të bëjnë me mbrojtjen e secilit individ, dhe pasi që ato janë matës, se sa i civilizuar dhe demokratik është në të vërtetë një vend. Është e qartë gjithashtu se shoqëritë e pasluftës, siç është Kosova me historinë e saj të fundit tragjike, kanë nevojë të veçantë që të tregojnë se po kujdeset për të drejtat e njeriut të të gjithë qytetarëve të saj. Urrejtjet e vjetra dhe ato të reja mund të pengojnë tolerancën dhe trajtimin e drejtë. Barra e së shkuarës mund të bëjë që dallimet të pranohen me vështirësi (<http://www.eeas.europa.eu>, 2020).

Sa i përket zbatimit të legjislacionit, vlen të përmenden gjetjet në raportin e shoqërisë civile ku theksohet se “kapacitetet institucionale për të zbatuar ligjet mbeten të mangëta, rastet e diskriminimit në gjykata të rregullta dhe institucione publike mbeten të rralla. Një përjashtim ka qenë Gjykata Kushtetuese, duke zbatuar parimet ndërkombëtare të të Drejtave

të Njeriut të përfshira në Kushtetutë në një numër çështjesh. Sidoqoftë, gjykatat e rregullta rrallë përdorin Paketën e të Drejtave të Njeriut ose vendosin për çështje të bazuara në parimet ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut të renditura në Kushtetutë. Përdorimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, është gjithashtu shumë i rrallë. Individët rrallë paraqesin raste kundër diskriminimit në gjykata dhe kur raste të tilla merren parasysh, ligjet përkatëse nuk zbatohen si duhet” (Group for Legal and Political Studies, 2017). Kjo do të thotë se, pavarësisht legjislacionit të miratuar nga Republika e Kosovës, zbatimi i tij mbetet ende sfidë për institucionet e vendit.

5. Respektimi i standardeve ndërkombëtare dhe parimeve kushtetuese për të drejtat e njeriut nga institucionet publike në RKS-sës

Nëse analizohet legjislacioni i Kosovës, dhe nëse bëhet një krahasim me vendet e tjera, jo vetëm të rajonit por edhe më gjerë në nivel global, do të shohim se të drejtat e njeriut zënë një vend të rëndësishëm në Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Në fakt, Kosova në rrugën e saj të shtet ndërtimit deri te shpallja e pavarësisë, si dhe në rrugën e saj integruese, e ka pasur të domosdoshme të trajtojë seriozisht të drejtat e njeriut. E sidomos në mënyrë të veçantë të drejtat e komuniteteve jo shumicë.

Respektimi i standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, më së miri shihet dhe faktizohet në sistematizimin e këtyre të drejtave në Kushtetutë. Kushtetuta ka paraparë zbatim direkt në Kosovë të tetë (8) akteve ndërkombëtare (neni 22) nga më të rëndësishmet për të drejtat e njeriut.

Është me rëndësi të theksohet se “përtej këtyre dispozitave kushtetuese, Kosova ka gamë të gjerë të ligjeve dhe mekanizmave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të dhe lirve te njeriut. Në vitin 2015, Kosova bëri përparim në përafrimin e kornizës së saj ligjore me standardet ndërkombëtare, kur adoptoi pakon e ligjeve themelore për të drejtat e njeriut, gjegjësisht, Ligjin nr. 05/L-019 për A e P, Ligjin nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore dhe Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Zbatimi i plotë i tyre është thelbësor, për implementimin efektiv të kornizës së të drejtave të njeriut në Kosovë. Çka dhe kërkon alokimin e resurseve të nevojshme dhe përpjekje serioze për ndërtimin e kapaciteteve (Raport

i UNMIK dhe OHCHR, 2020). Vlen të përmendet që Kosova gjithashtu ka themeluar organe dhe mekanizma të veçantë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirve të njeriut. Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe mos diskriminim (ZQM) harton politika në fushat e qeverisjes së mirë, mundësive të barabarta dhe kundër diskriminimit dhe mbikëqyr dhe këshillon Ministrinë në fushat e përmendura (Raport i UNMIK dhe OHCHR, 2020).

Në orientimin e saj drejtë integritimeve evropiane, Republika e Kosovës ka pranuar të gjitha standardet e vendosura nga Bashkimi Evropian, dhe është duke implementuar të njëjtat. Në kuptim të kësaj, të drejtat e njeriut gjejnë hapësirë të gjerë konformë standardeve evropiane, pavarësisht, që Republika e Kosovës ende ndodhet e pa anëtarësuar në shumë mekanizma ndërkombëtar. Mirëpo, vlen të përmendet se përkundër kornizës ligjore, Kosovës ende i mungon strategjia gjithëpërfshirëse për të drejtat e njeriut që do të ndërthente politikat dhe ligjet ekzistuese për të drejtat e njeriut në një dokument (Raport i Shoqërisë Civile për të DNJ, 2020, p. 3). Veç tjerash, për shkak të problemeve të statusit të shtetësisë dhe problemeve me minoritetet, e posaçërisht me minoritetin serbë, “vëmendje e veçantë i është kushtuar të drejtave të komunitetit, përfshirë kthimin e pronës, të kthyerve dhe re integritit të tyre, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, qasja në shërbimet publike si dhe përdorimi i gjuhëve zyrtare” (Task Forca për Integrim Evropian, 2020, p. 7).

6. Gjykata Kushtetuese dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në RKS-së

Bazuar në Kushtetutën e Kosovës, Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën (neni 112, par.1). Kushtetuta ka paraparë se Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar (neni 113, par.1). Kushtetuta ka përcaktuar që si palë të autorizuara për ngritjen e çështjeve në lidhje me përputhshmërinë e ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën; si dhe përputhshmërinë e Statutit të Komunës me Kushtetutën, janë: Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit (neni 113, par.2). Gjithashtu, Kushtetuta ka përcaktuar se Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:

- (1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të **RKS-sës** dhe Qeverisë së Kosovës;

- (2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;
- (3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;
- (4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;
- (5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit (neni 113, par.3, pika 1-5).

Në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, vlen të theksohet që Kushtetuta ka paraparë se edhe individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj (neni 113, par.7). Kjo bënë pjesë në kërkesat individuale dhe mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike. Vlen të theksohet se janë disa vendime të mara nga Gjykata Kushtetuese, që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë drejtim vlen të përmendet aktgjykimi në rastin nr. KI97/16, me të cilin është konstatuar se ka pasur shkelje të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, aktgjykimi në rastin nr. KI93/16, me të cilin po ashtu është konstatuar se ka pasur shkelje të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, etj. Në këto raste është mbrojtur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si një e drejtë universale e garantuar më konventa ndërkombëtare.

RAST STUDIMI:

KO54/20, Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020

KO54/20, Aktgjykim i 31 marsit 2020, publikuar më 6 prill 2020

Fjalët kyç: Kërkesë institucionale, neni 113.2 (1) i Kushtetutës, liria e lëvizjes, liria e tubimit, e drejta e privatësisë, kufizim i pa “përcaktuar në ligj”, Qeveria, Kuvendi, Presidenti, dallimi në mes të nenit 55 dhe 56 të Kushtetutës, kufizim vs. shmangie,

Më 24 mars 2020, Presidenti parashtrroi kërkesën KO54/20 në Gjykatë. Përmes kësaj kërkesë, Presidenti kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 01/15 të 23 marsit

2020] të Qeverisë si dhe vendosjen e masës së përkohshme ndaj Vendimit të kontestuar të Qeverisë.

Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar të Qeverisë, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk është në pajtueshmëri me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 35 [Liria e Lëvizjes], 43 [Liria e Tubimit] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës; nenin 2 [Liria e lëvizjes] të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së; nenin 13 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; si dhe me nenin 12 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Në titullin **VII – PËRFUNDIME** – të këtij Aktgjykimi (shih paragrafët 310-325), Gjykata përmbledhi esencën e rastit dhe theksoi me sa vijon:

Si çështje paraprake, Gjykata në këtë Aktgjykim sqaroi se nuk është roli i saj që të vlerësoj se a janë adekuate dhe të duhura masat e ndërmarra nga Qeveria për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19. Për më tepër, Gjykata vë në pah se nevoja për të ndërmarrë masa dhe domosdoshmëria e tyre nuk është kontestuar nga asnjë palë në këtë rast. Përcaktimi i politikave rreth shëndetit publik nuk hyn në kompetencat dhe autorizimet e Gjykatës Kushtetuese. Për çështje të shëndetit publik, edhe vet Gjykata Kushtetuese u referohet dhe bindet institucioneve përkatëse shëndetësore dhe profesionale në nivel shtetëror dhe botëror.

Çështja kushtetuese që ngërthen ky Aktgjykim është përputhshmëria me Kushtetutën e Vendimit të kontestuar të Qeverisë, përkatësisht nëse me nxjerrjen e tij, Qeveria ka kufizuar të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në përputhje me ligjin apo përtej autorizimeve të përcaktuara me ligj. Në këtë kontekst, përkitazi me vlerësimin nëse kufizimet e bëra në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës përmes Vendimit të kontestuar të Qeverisë janë të përcaktuara me ligj, Gjykata është fokusuar në vlerësimin e autorizimeve të përcaktuara përmes neneve 41 dhe 44 të Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe neneve 12 (1.11) dhe 89 të Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi.

Në këtë drejtim, Gjykata shqyrtoi: (i) kërkesën e parashtruesit dhe pretendimet e paraqitura në këtë kërkesë; (ii) komentet e dorëzuara nga Qeveria dhe palët e tjera të interesuara; (iii) praktikën gjyqësore të GJEDNJ-s dhe posaçërisht, parimeve të përgjithshme rreth aplikueshme risë së kriterit “e përcaktuar me ligj” për sa i takon aspektit të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore; dhe (iv) praktikën gjyqësore të vet Gjykatës Kushtetuese.

Bazuar në shqyrtimet dhe vlerësimet e sipërshënuara, Gjykata, njëzëri, vendosi ta shpallë kërkesën KO54/20 të pranueshme për shqyrtim në merita meqë, në rrethanat e rastit konkret, ishin plotësuar të gjitha kushtet e provueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.

Gjykata vendosi njëzëri se Vendimi [nr. 01/15] i 23 marsit 2020 i Qeverisë nuk është në përputhshmëri me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenet 35 [Liria e Lëvizjes], 36 [E drejta për privatësi], 43 [Liria e Tubimit] të Kushtetutës dhe me nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4, nenin 8 (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare) dhe nenin 11 (Liria e tubimit dhe e organizimit) të KEDNJ-së.

Gjykata konstatoi se kufizimet që përmban Vendimi i kontestuar i Qeverisë përkitazi me të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese të lartcekura, nuk janë të “përcaktuara me ligj”, andaj bien në kundërshtim me garancitë që përmbajnë nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës në lidhje me nenet respektive të KEDNJ-së, dhe me nenin 55 të Kushtetutës, i cili në paragrafin e tij të parë përcakton qartë që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.

Gjykata theksoi faktin që Vendimi i kontestuar i Qeverisë, i referohet zbatimit të dy ligjeve të lartcekura, të cilat e autorizojnë Ministrinë e Shëndetësisë që të ndërmarrë masa të caktuara në ato ligje me qëllim të parandalimit dhe luftimit të sëmundjeve ngjitëse. Megjithatë, Gjykata konstatoi se ligjet e lartcekura, nuk e autorizojnë Qeverinë që të kufizojë të drejtat dhe liritë kushtetuese të përcaktuara me nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa përjashtim.

Në këtë aspekt, Gjykata konstatoi se kufizimet e shqiptuara përmes Vendimit të kontestuar: (i) lidhur me lirinë e lëvizjes dhe të tubimit të përcaktuara përmes neneve 35 dhe 43 të Kushtetutës, tejkalojnë kufizimet e lejuara përmes ligjit të lartcekur të miratuar nga Kuvendi; dhe (ii) lidhur me “tubimet në të gjitha mjediset – private dhe publike, të hapura ose të mbyllura” e që ngërthejnë aspekte të të drejtave të garantuara përmes nenit 36 të Kushtetutës, nuk janë të bazuara në asnjë autorizim të përcaktuar me ligjin e lartcekur apo edhe ndonjë ligj tjetër të Kuvendit.

Gjykata sqaroi se Qeveria nuk mund të kufizojë asnjë të drejtë dhe liri themelore përmes vendimeve, nëse një kufizim i të drejtës përkatëse nuk është paraparë me ligj të Kuvendit.

Qeveria vetëm mund të zbatojë një ligj të Kuvendit që kufizon një të drejtë dhe liri themelore dhe atë vetëm deri në masën specifike që e ka autorizuar Kuvendi përmes ligjit përkatës.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës, Gjykata konstatoi se ky nen nuk është i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret, ngase i njëjti është i aplikueshëm vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme.

Gjithsesi, lidhur me mos-pajtimin e palëve në kontest, Presidentit dhe Qeverisë, rreth kuptimit të termeve kushtetuese “kufizim” dhe “shmangie” që figurojnë në nenet 55 dhe 56 të Kushtetutës, Gjykata qartësoi se “kufizimi” i të drejtave dhe lirive të njeriut mund të bëhet “vetëm me ligj” të Kuvendit, por kjo nuk do të thotë që “kufizimi” i të drejtave, mund të bëhet vetëm përmes dhe pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme. Gjykata sqaroi se termi “kufizim” i përdorur në nenin 55 të Kushtetutës nënkupton faktin që Kuvendi ka të drejtë të kufizojë të drejta dhe liri themelore, përmes ligjit, por vetëm për aq sa dhe deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi. Thënë ndryshe, “kufizimi” nënkupton një shkallë më të lehtë të ndërhyrjes dhe kjo mund të bëhet edhe pa shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme; ndërkaq “shmangia” nënkupton një shkallë më të rëndë të ndërhyrjes ngase nuk mund të bëhet kurrësi pa u shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme.

Për sa i takon kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata konstatoi se pas vendimit unanim të gjyqtarëve që të vendosin në tërësi për meritat e rastit dhe të nxjerrin këtë Aktgjykim, e njëjta ngeli e pa objekt shqyrtimi.

Duke u bazuar në nenet 116.3 të Kushtetutës, 20.5 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 60 (5) të Rregullores së punës, Gjykata përcaktoi datën 13 prill 2020, si datë të hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, respektivisht shfuqizimit të Vendimit të kontestuar të Qeverisë.

Gjykata ka përcaktuar një datë tjetër të hyrjes në fuqi të Aktgjykimit të saj, respektivisht datën 13 prill 2020, përjashtimisht dhe duke marrë parasysh: (i) rrethanat e krijuara me shpalljen e pandemisë COVID-19 në nivel botëror; (ii) rekomandimet përkatëse të institucioneve shëndetësore në nivel shtetëror dhe botëror; (iii) pasojat potencialisht të dëmshme për shëndetin publik si rezultat i shfuqizimit të menjëhershëm të kufizimeve të përcaktuara përmes Vendimit të Qeverisë; dhe (iv) mbrojtjen e shëndetit dhe interesit publik deri në zbatimin e këtij Aktgjykimi nga institucionet relevante të Republikës së Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe kohore dhe në kuptim të nenit 55 të Kushtetutës përkitazi me “kufizimin” e të drejtave dhe lirive themelore, institucionet relevante të Republikës së Kosovës, dhe në radhë të parë Kuvendi, duhet të ndërmarrin masat e duhura për tu siguruar që kufizimet e nevojshme të të drejtave dhe lirive themelore më qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, janë bërë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim.

Në fund, Gjykata po ashtu thekson se Ministria e Shëndetësisë, respektivisht Qeveria, vazhdon të jetë e autorizuar që të nxjerr vendime me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pandemisë, për aq sa është e autorizuar përmes të Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjytëse dhe Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi.

7. Të drejtat dhe liritë sipas sistemit të rregullt gjyqësor

Është e drejtë universale e çdo personi, që në rast të ndonjë procesi gjyqësor ndaj tij, që ai proces të zhvillohet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Gjykatat janë të obliguara të respektojnë personin e akuzuar dhe çdo person tjetër, që në një formë ose në një tjetër, merr pjesë në procesin gjyqësor. Kështu që dhe mos të cenojnë të drejtat e tyre në asnjë formë, përveç nëse diçka e tillë është parashikuar me ligj.

Kushtetuta e Kosovës ka paraparë aplikimin e të gjitha standardeve ndërkombëtare dhe ka garantuar jetësimin e tyre, veç tjerash, Kushtetuta ka paraparë që “lirit themelore dhe të drejtat e njeriut të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (neni 53). Gjithashtu, me kushtetutë është garantuar edhe mbrojtja gjyqësore e të drejtave për çdo person në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte e cila është e garantuar me kushtetutë dhe me ligje (neni 54).

Veç kësaj, vlen të theksohet se “dy prej konventave ndërkombëtare drejtpërdrejtë të zbatueshme në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, kanë përcaktuar standardin për të drejtën e gjyqimit nga një gjykatë e pavarur e paanshme dhe e themeluar me ligj. Objekti i kësaj kërkesë për gjykatë të themeluar me ligj është për të krijuar siguri dhe pavarësi të sistemit gjyqësor. Kërkesa për këtë standard gjithashtu, obligon për ligje mbi themelimin e sistemit gjyqësor ose të gjykatave, të aprovuar nga parlamenti dhe jo nga degët tjera të pushtetit, veqënisht kërkon evitimin e ndërhyrjes së pushtetit ekzekutiv” (Civil Rights Defenders – CRD dhe Open Society Foundation – OSF, 2013).

Sistemi i drejtësisë është ndërtuar mbi bazën e parimit të paanshmërisë dhe pavarësisë së sistemit gjyqësor, gjë që nënkupton edhe esencën për gjykime të drejta. Konventa evropiane për të drejtat e njeriut në nenin 6 ka përcaktuar të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, me të cilin nën është përcaktuar se “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë” (neni 6, par.1).

8. Pamundësia e ngritjes së çështjes në Gjykatën e Strasburgut

Që nga përfundimi i luftës dhe vendosja e Kosovës nën administrimin e Kombeve të Bashkuara, Kosova ka qenë në qasje drektë me vendet evropiane. Në këtë kontekst edhe korniza ligjore në ndërtim kishte pjesëmarrje direkte të faktorit ndërkombëtar. Andaj, me të drejtë theksohet se “që nga fundi i luftës së vitit 1999, Kosova ishte dëshmitare e një zhvillimi të rëndësishëm në lidhje me kornizën e saj politike dhe ligjore. Pas të ashtuquajturit Plani Ahtisaari, në vitin 2008 Kosova shpalli pavarësinë e saj. Ajo krijoi kornizën themelore ligjore që fillon me prezantimin e Kushtetutës së re të Kosovës disa muaj pas vete deklarimit të pavarësisë. Gjykata Kushtetuese e bëri të detyrueshëm zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në të gjithë sistemin juridik të Kosovës (Shala & Bajraktari, 2015, p. 42). Prandaj në këtë drejtim me të drejtë konstatohet se “në kuadër të UE-së, por edhe të shteteve anëtarë të KE por edhe atyre që aspirojnë sikur është rasti i Kosovës marrëdhënia në mes të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutat kombëtare në njërën anë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në anën tjetër, është shumë sfidues, por edhe vlerësohet në nivel Evropian. Në këtë aspekt vendi ynë sa i përket legjislacionit, qëndron plotësisht i harmonizuar. Në kuptimin konkret, pranimi i Konventës së UE-së, do të thotë që personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë t'i paraqesin Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, ankesat kundër vendimeve të UE-së dhe institucioneve të

saj. Pranimi do të forcojë edhe kredibilitetin e UE-së, pasi qytetarët do të mbrohen në lidhje me aktet e UE-së, të ngjashme me mbrojtjen që aktualisht gëzojnë të gjitha Shtetet anëtare” (Bajrami, et al., 2019, p. 89).

Gjithashtu, vlen të theksohet se, “duke marrë parasysh që Kosova nuk është shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara, Unionit Evropian dhe Këshillit të Evropës, instrumente ndërkombëtare të inkuorporuar në Kushtetutën e vendit, nuk janë gjithmonë të zbatueshme dhe qytetarët tanë nuk mund të parashtrojnë ankesa në organet përkatëse” (Bajrami, et al., 2019, p. 93). Në këtë drejtim, po ashtu vlen të përmendet se “përderisa neni 22 i Kushtetues krijon një sistem të jashtëm të të drejtave, duke përfshirë edhe të drejtat përkatëse. Njëkohësisht duke i dhënë efekt të detyrueshëm me prioritet, një game të gjerë të të drejtave të përfshira në sferën ndërkombëtare. Kjo del në pah dhe është disi e dobësuar nga fakti se këto të drejta do të zbatohen, mbrohen dhe interpretohen vetëm nga gjykatësit vendor. Kjo do të thotë, që justifikimi vendimtar për traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut - përgjegjësia e jashtme e shtetit - nuk është përmbushur (Bajrami, et al., 2019, p. 93).

Është më shumë se e domosdoshme të theksohet edhe fakti se Kushtetuta e Kosovës i detyron institucionet e Kosovës, duke përfshirë gjykatat e saj, të përdorin praktikën gjyqësore të GjEDNj-s, si bazë për interpretimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese të njeriut (neni 53). Megjithatë, praktika gjyqësore nuk është drejtpërdrejt efektive brenda sistemit ligjor të Kosovës. Qytetarët kosovarë gjithashtu nuk mund të dërgojnë/adresojnë një rast para Gjykatës së Strasburgut, në rastin kur ata mendojnë se të drejtat e tyre janë shkelur nga shteti. Gjithsesi, një person mund të pretendojë se interpretimi i një gjykate vendase mbi një të drejtë ose liri ka shkelur Kushtetutën, nëse vendimi nuk ka përfshirë një rishikim të përmbajtjes eksplicite të praktikës gjyqësore të GjEDNj-s. Për realizim të këtij qëllimi Gjykata Kushtetuese ka zgjeruar aktivitetin në kuptim të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut (Bajrami, et al., 2019, pp. 96-97).

Nga kjo që u trajtua del se Kosova ka pasur dhe vazhdon ende të ketë raport specifik me Bashkimin Evropian, por edhe me shumë organizata të tjera ndërkombëtare. Në fakt, kjo gjendje është rrjedhojë e mos njohjes së shtetësisë së Kosovës nga një pjesë e shteteve dhe mos anëtarësimi në mekanizmat ndërkombëtar të vendit.

9. Roli i Avokatit të Popullit

Një nga institucionet kushtetuese dhe jo me pak relevancë është edhe Avokati i Popullit. Vlen për tu theksuar se në secilin rast, Avokati i Popullit si institucion është një zyrë publike e hapur dhe e pavarur me kompetenca të gjera të hetimit. Emri i tij spanjoll, Defensor del Pueblo - "mbrojtës i popullit" - është një përshkrim i përshtatshëm i natyrës së punës së tij. Sepse është detyra e ombudsmanit të veprojë si një mbrojtës midis qytetarit individual dhe shtetit, të ngrihet për të drejtën e publikut për qeverisje të mirë (Oosting, 1999, p. 2).

Në Republikën e Kosovës organizimi dhe funksionimi i Institucionit të Avokatit të Popullit, përgjegjësitë dhe mënyra e punës së tij, si dhe procedurat për parashtrimin e ankesave dhe hetimin e tyre, janë të rregulluara me Kushtetutë (Kapitulli XII, nenet 132, 133, 134 dhe 135) dhe me ligjin për Avokatin e Popullit (Ligji Nr. 05/L -019). Sipas këtij ligji “Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për barazi gjinore dhe Ligji për mbrojtje nga diskriminimi” (neni 1, par.2). Nga kjo rrjedh se “roli i Avokatit të Popullit në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ndërlidhet ngushtë me përgjegjësitë që bartë ky institucion kundrejt avancimit të barazisë gjinore, përgjegjësi këto të përcaktuara në Ligjin për Barazi Gjinore, si dhe në ligjin Kundër Diskriminimit, ku bartës kryesor i ankesave për diskriminim konsiderohet Avokati i Popullit” (Bajrami, et al., 2019, p. 401). Veç tjerash vlen të theksohet se me qëllim të identifikimit të problemeve dhe me qëllim të sigurimit të të dhënave për shkeljet e supozuara, Kushtetuta dhe Ligji për Avokatin e Popullit obligon çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, t’i përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’ia paraqes atij të gjitha dokumentet dhe të dhënat e kërkuara (Bajrami, et al., 2019, p. 401). Nga kjo del se me të drejtë thekson edhe teoricieni Marten Oosting se “në formën e tij moderne, Avokati i Popullit është një element në sistemin demokratik të kontrolleve dhe ekuilibrave, një koncept që buron nga tradita kushtetuese amerikane. Ai bazohet në konceptin e shtetit të së drejtës, në të cilin qeveria jo vetëm që krijon ligjin, por edhe vetë i nënshtrohet këtij ligji. Me pak fjalë, Avokati i Popullit luan një rol thelbësor në parandalimin e shtetit nga marrja e pushtetit absolut pa kufizime, përgjegjësi ose kontrolle. Sepse, nëse publiku do të ketë besim në qeverinë e tij, duhet të vendosen kufizime për pushtetin që ai ushtron” (Oosting, 1999, p. 2).

Kompetencat e Avokatit të Popullit kanë të bëjnë me hetimin e ankesave të pranuar nga çdo person fizik a juridike që përkojnë lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të

njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera. Natyrish si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit. Në këtë drejtim, në ushtrimin e funksioneve të tij, Avokati i Popullit mund t'u ofrojë shërbime të mira të gjithë banorëve të Republikës së Kosovës, si dhe personave të tjerë që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor, mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, mbledh të dhëna statistikore në lidhje me çështjet e diskriminimit dhe barazisë të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe i publikon ato, po ashtu, publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë, si dhe bashkëpunon me partnerët social dhe organizatat jo-qeveritare që merren me çështje të barazisë dhe jo-diskriminimit, si dhe me trupa të ngjashëm ndërkombëtare me Avokatin e Popullit (neni 16, par. 1,3,8,10,14,15 dhe 16).

Sa i përket sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës, në raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2019, theksohet se, “një sfidë e vazhdueshme e sistemit gjyqësor mbetet moszbatimi i standardeve për të drejtat dhe për liritë e njeriut, siç parashihet me nenin 53 të Kushtetutës, sipas të cilit interpretimi i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore duhet të bëhet në pajtim me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj). Referimet në praktikën e GjEDNj-së janë të pakta dhe, në rastet kur kjo ndodh, ato bëhen në mënyrë të përgjithësuar, por pa përcaktuar në mënyrë konkrete vlerësimet e GjEDNj-së dhe lidhshmërinë e rrethanave të rastit në praktikë” (Raport i IAP, 2020, p. 25).

Në lidhje me pushtetin ekzekutiv, Institucioni i Avokatit të Popullit në raportin vjetor për vitin 2019 ven në dukje se, një numër i konsiderueshëm i ankesave ndaj pushtetit ekzekutiv kanë të bëjë me kufizimin e qasjes në dokumentet publike. Në këtë drejtim, Avokati i Populli ka hapur për hetim 29 raste ex officio, prej të cilave një numër i konsiderueshëm i çështjeve kanë të bëjë me punën e ekzekutivit në të dyja nivelet qeverisëse, lidhur me të cilat Avokati i Popullit ka nxjerrë rekomandime apo ka shprehur qëndrimet e tij (Raport i IAP, 2020, pp. 29-30). Gjithashtu, sa i përket Avokatit të Popullit, “edhe pse Ligji mbi Avokatin e Popullit përcakton një detyrim për të raportuar në lidhje me veprimet e ndërmarra për të trajtuar komentet de rekomandimet e dhëna nga ana e Avokatit të Popullit, shumë institucione nuk arrijnë ta bëjnë këtë në kohën e duhur. Institucioni ka adresuar çështjen duke kërkuar në mënyrë aktive këso veprime, duke e sensibilizuar çështjen në nivel

qendror dhe duke i turpëruar njësitë dhe organet jo-bashkëpunuese. Kjo është një strategji e zakonshme që përdoret nga institucione të ngjashme përgjatë tërë Evropës, ku ka rezultuar me sukses të pabarabartë, kryesisht në varësi të kontaktit publik të Avokatit të Popullit përkatës” (Martinez & Cucchi, 2017).

Veç tjerash vlen të theksohet se qeverisja e mirë dhe demokracia e konsoliduar janë të lidhura domosdo me realizimin e të drejtave të qytetarëve. Në këtë qasje, pa dyshim që “Institucioni i Avokatit të Popullit, si mekanizëm i kontrollit të administratës shtetërore, ka rol të rëndësishëm në forcimin e përgjegjshmërisë së administratës shtetërore, gjithashtu mund të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së administrimit nga zbulimi i rasteve të ‘keqadministrimit’ dhe ngritjen e vetëdijes së nëpunësve civilë në pritjet e publikut në lidhje me qeverisjen e mirë dhe miradministrimin, duke ndikuar që sistemi administrativ të jetë më transparent dhe më i qasshëm për të gjithë qytetarët” (Raport i IAP, 2020, p. 29).

9-1 Kompetencat dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit

Institucionet publike dhe kushtetuese kanë kompetenca dhe përgjegjësi. Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës kompetencat ja përcakton ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit. Në kuadër të kompetencave, ligji përcakton se, “Avokati i Popullit ka kompetenca për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me standarde ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe konventave ndërkombëtare, veçanërisht me konventën evropiane për të drejtat e njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.”, ndërsa lidhur me shtrirjen e kompetencave për ta bërë më funksional dhe autoritativ Avokatin e Popullit, përcaktohet se, “Kompetencat e Avokatit të Popullit shtrihen në mbarë territorin e Republikës së Kosovës. Një Ombusmen mund të hetoj çështje mbrenda juridiksionit me; a) me iniciativën e tij, b) me pranimin e ndonjë ankese nga ndonjë person, dhe c) me kërkesë të ligjvënësit. Lehtësimi me anë të ndonjë shkrese apo vendim nga ndonjë organ superior nuk e pengon apo ndalon hetimin e ombusmenit. Ombusmeni ka pushtet diskrecional të hetojë apo të mos hetojë çështje. Në ushtrimin e funksioneve të tij lidhur me rastet që paraqiten brenda territorit të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit mund t’u ofrojë shërbime të mira edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës që përkohësisht ndodhen jashtë territorit të Republikës së Kosovës.” ((Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, n.d.)Nga kjo del, se në aspekt të funksioneve dhe

kompetencave të përcaktuara Avokati i Popullit në funksion dhe shërbim të shtetasve të Kosovës, si brenda territorit ashtu edhe jasht territorit të Republikës.

Në kuadër të kompetencave të tij Avokati i Popullit ka kompetenca të bëjë edhe hetime lidhur me përgjigjen e ankesës, apo edhe nga pozita e tij zyrtare. Kjo kompetencë me ligj është përcaktuar shprehimisht, si “Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut.” (Ligji nr. 03/L-195, n.d.) Ndërsa në rastet kur Avokati i Popullit fillon zyrtarisht procedurën, nevojitet një pëlqim nga pala e dëmtuar ndaj së cilës janë shkelë të drejtat. Kjo kompetencë shprehimisht me ligj përcaktohet se, “Nëse Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të vetë ose ndonjë person tjetër në emër të të dëmtuarit i drejtohet me parashtrësë Avokatit të Popullit për ngritjen e procedurës, është i nevojshëm pëlqimi nga personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut.” ((Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, n.d.)

Një situatë krejt tjetër lidhur me pëlqimin nga palët për të filluar veprimin Avokati i Popullit është në rastet, kur ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të fëmijëve, personave me aftësi të humbura dhe një numri më të madh të qytetarëve, ligji ka përcaktuar se, “Kur me iniciativën e tij Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të tij lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të një numri më të madh të qytetarëve, të fëmijëve apo personave me aftësi të humbura veprimi, nuk është i nevojshëm pëlqimi nga paragrafi 4. i këtij neni”, nga kjo del se nuk ka nevojë të merret pëlqimi fare për të vepruar Avokati i Popullit.

Në rastet kur janë duke u zhvilluar procese gjyqësore, Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë, kjo është përcaktuar shprehimisht se, “Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç në raste të zvarritjeve të paarsyeshme apo keqpërdorimit të dukshëm të pushtetit.” ((Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, n.d.) Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje edhe në Gjykatën Kushtetuese, e cila competence shprehimisht është e përcaktuar me ligj se, “Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me kushtetutën dhe ligjin për Gjykatë Kushtetuese.” Avokati i Popullit ushtron edhe kompetenca tjera të përcaktuara me ligj, si pajtimi dhe ndërmjetësimi, ndërsa të gjitha shërbimet që ofrohen nga Avokati i Popullit janë falas.

Në kuadër të fushëveprimtarisë së tij, Institucioni i Avokatit të Popullit, konkretisht Avokati i Popullit përpos kompetencave ka edhe përgjegjësi të cilat janë të përcaktuara me ligj.

Ligji për Avokatin e Popullit shprehimisht e përcakton këto përgjegjësi:

- të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut
- të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut;
- të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit,
- të njoftojë Qeverinë dhe Kuvendin për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut;
- t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta;
- të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend,
- të përgatitë raporte vjetore, dhe periodike

- të rekomandojë harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv;
- të bashkëpunojë, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, organizatat dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare që proklamoin mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut;

Avokati i Popullit, zëvendësit dhe personeli i tij duhet ruajtur fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të të dhënave që i merr, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurisë së ankuesve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave;

obligimi për ruajtjen e fshehtësisë zyrtare vlen edhe pas përfundimit të mandatit ose marrëdhënies së punës.(Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit n. 1., n.d.)

9-2 Fillimi i procedurës pranë Institucionit të Avokatit të Popullit

Ankesa lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut mund të paraqiten Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit. Me ligj është përcaktuar shprehimisht se, “Çdo person i cili pretendon se të drejtat apo liritë e tij janë shkelur me ndonjë ligj, veprim apo mosveprim, keqadministrim të organeve të autoriteteve publike, organeve tjera dhe organizatave që ushtrojnë autoritete publike për llogari të tyre, mund të kërkojë nga Institucioni i Avokatit të Popullit fillimin e procedurës.” Ndërsa me ligj është përcaktuar edhe

forma e ankesës e cila i parashtrahet Avokatit të Popullit, duke e përcaktuar se, “Çdo ankesë që i parashtrahet Avokatit të Popullit duhet të jetë e nënshkruar dhe t’i ketë shënimet personale të paraqitësit të ankesës si dhe të përmbajë të gjitha rrethanat, faktet dhe dëshmitë në të cilat kjo ankesë bazohet. (Fejzulla & Petrit, 2019)

Paraqitësi i ankesës mund të deklarojë nëse mjetet juridike janë ushtruar apo jo, dhe nëse po cilat prej këtyre mjeteve janë zbatuar. Çdo ankesë për fillimin e procedurës, si rregull paraqitet me shkrim. Kërkesa për fillimin e procedurës mund të paraqitet edhe gojarisht, në rast se nuk mund të bëhet me shkrim.” (p. 17)

Me të paraqitë pala ankesën pranë Institucionit të Avokatit të Popullit fillon të zhvillohet një procedurë pas pranimit të ankesës. Avokati i Popullit pas pranimit të ankesës në afat prej 30 ditësh vendos për pranueshmërinë e çështjes në këto raste:

- të shqyrtojë në procedurë të përshpejtuar rastin;
- të fillojë hetimin e plotë.

Ndërsa mund të hedhë poshtë ankesën për këto raste:

- sipas këtij ligji nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit;
- ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë me këtë ligj;
- ankesa është anonime;
- ankesa paraqet keqpërdorim të së drejtës për paraqitjen e ankesës;
- ankuesi ka dështuar të sigurojë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit.
- të refuzojë ankesën si të pabazuar. ((Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, n.d.)

Në çfarëdo rrethana qoftë për ta pranuar apo refuzuar ankesën, vendimi i Avokatit të Popullit është i formës së prerë.

Ligji ka përcaktuar shprehimisht edhe rastet e refuzimit të ankesës duke caktuar se, Avokati I Popullit refuzon ankesën për këto raste:

kur nga shënimet e paraqitura dhe nga rrethanat e rastit del se të drejtat dhe liritë e njeriut nuk janë shkelur apo nuk është kryer kurrfarë keqadministrimi;

kur kërkesa është jo e plotë dhe nuk është kompletuar edhe pas kërkesave të Avokatit të Popullit:

- kur procedurat për një lëndë janë duke u zhvilluar në organet gjyqësore ose në organet tjera kompetente, përveç në rastet e specifikuar me këtë ligj;
- kur të gjitha mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme nuk janë shterur, përpos nëse ai vlerëson se do të jetë e padobishme për paraqitësin e ankesës për të

filluar apo vazhduar procedurën, apo nëse vlerëson se individët kanë pësuar dëm të madh apo mund të pësojnë dëm të madh dhe të pa kompenzueshëm në ndërkohë.(Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit n. 2., n.d.)

Në Institucionin e Avokatit të Popullit vlenë edhe parimi i parashkrimit (vjetërsimit) dhe përjashtimit. Me ligjë është përcaktuar shprehimisht se, “Avokati i Popullit nuk inicion procedurë për të hetuar shkeljen e të drejtave të njeriut nëse prej datës që pala e ka marrë vendimin e formës së prerë ose është njoftuar lidhur me të dhe deri në dorëzimin e ankesës në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë kaluar më shumë se gjashtë (6) muaj,” ndërsa lidhur me përjashtimin shprehimisht e përcakton se,. “Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Avokati i Popullit mund të iniciojë procedurë edhe pas kalimit të afatit prej gjashtë (6) muaj në rast se vlerëson se paraqitësi i ankesës ka qenë i penguar apo në rast se vlerëson se çështja është e rëndësishme së veçantë.”(Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit n. 1., n.d.)

Institucioni i Avokatit të Popullit zhvillon edhe një procedurë pas fillimit të hetimit e cila është përcaktuar shprehimisht me ligj dhe ndërlidhet me rastet kur Avokati i Popullit vendos ti fillojë hetimet, si “Kur Avokati i Popullit vendos t’i fillojë hetimet në pajtim me nenin 19 të këtij ligji, vendimin e vet do t’ua komunikojë paraqitësit të ankesës dhe organit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Avokati i Popullit mund të kërkojë informata shtesë lidhur me rastin.” Ndërsa lidhur me afatet që përcakton Avokati i Popullit se kur duhet organi të dërgojë të gjitha informatat është përcaktuar shprehimisht se, “Avokati i Popullit cakton afatin brenda të cilit duhet tja dorëzojë të gjitha informatat e kërkuara në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni. Afati nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë (8) ditë dhe as më i gjatë se tridhjetë (30) ditë. Kur organi nuk arrin t’i dorëzojë në afatin e paraparë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit, ai pa vonesë duhet t’i paraqesë me shkrim arsyet e vonesës në ofrimin e informatës së kërkuar.” Avokati i Popullit në rastet me pamjaftueshmëri të informative, ligji e përcakton se, “Në rast se Avokati i Popullit i vlerëson të pamjaftueshme përgjigjet ose masat e ndërmarra nga organi, ai ka të drejtë ta procedojë çështjen tek organi më i lartë kompetent, ose t’i paraqesë raport të veçantë Kuvendit, duke i propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur.” Ndërsa në rastet kur ka refuzim apo tentim refuzimi për të mos ju përgjigjur Avokatit të Popullit, ligji ka përcaktuar se, “Refuzimi apo dështimi për t’iu përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit konsiderohet pengim i punës së Avokatit të Popullit. Kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit për të nxjerrë konkludimet dhe rekomandimet e tij.” (Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit n. 2., n.d.)

9-3 Parashtrimi i ankesave pranë Institucionit të Avokatit të Popullit

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit parqiten edhe ankesa. Paraqitja e ankesave është e rregulluar me Rregulloren e Punës për Institucionin e Avokatit të Popullit të viti 2011.

Rregullorja ka përcaktuar shprehimisht edhe pranimin e ankesave duke rregulluar se, “Ankesat pranohen në të gjitha zyrat e Avokatit të Popullit dhe regjistrohen në zyrën qendrore në Prishtinë.” Ndërsa ankesa mund të paraqitet edhe gojarisht nga parashtruesi ku rregullorja e ka përcaktuar se, “Me kërkesë të parashtruesit ankesa mund të paraqitet gojarisht dhe regjistrohet me shkrim nga zyrtari i IAP si dhe nënshkruhet nga parashtruesi.” (Rregullorja e punës për Institucionin e Avokatit të Popullit 2. n., neni 24, n.d.)

Për dërgimin e ankesës pranë Institucionit të Avokatit të Popullit rregullorja ka përcaktuar shprehimisht disa karakteristika të plotësimit të formularit të ankesës duke përfshirë disa fake dhe informata, si:

- Të dhënat personale të ankuesit së bashku me nënshkrimin e tij/saj, të dhënat mbi vendbanimin dhe kontaktet e tij/saj;
- Organin shtetëror, organin e pushtetit lokal, apo organin e besuar të autoritetit publik të cilit i referohet ankesa;
- Përshkrimin e të drejtave të njeriut apo lirive themelore të cilat janë shkelur apo keqadministrimin e kryer nga organi përkatës;
- Faktet dhe dëshmitë në të cilat bazohet ankesa;
- Përshkrimi i mjeteve juridike të cilat janë zbatuar më parë në rastin konkret;
- Çdo lloj dokumenti zyrtar, origjinal ose fotokopje, në të cilët mbështetet ankesa;
- Në rast se ankesa parashtrohet nga dikush tjetër në emër të personit të dëmtuar, pëlqimi i personit të dëmtuar duhet t'i bashkëngjitet kërkesës. (Rregullorja e punës për Institucionin e Avokatit të Popullit 2. n., po aty nen 25, n.d.)

Po ashtu pala ka të drejtën edhe të plotësimit të ankesës të cilën mundësi e përcakton shprehimisht rregullorja e punës për Institucionin e Avokatit të Popullit, duke rregulluar se, “Nëse gjatë pranimin të ankesës parashtruesi nuk i ka siguruar të gjitha dokumentet dhe informatat e duhura, zyrtari përgjegjës ka si obligim të kontaktojë ankuesin për informata shtesë. Parashtruesit të ankesës i jepet 30 ditë afat të plotësojë dhe të korrigjojë ankesën.” Ankuesi në raste se nuk arrinë të sigurojë informata e duhura në bazë të rregullores e cila

përcakton se “Në rast se ankuesi nuk i siguron informatat e kërkuara apo nuk mund të kontaktohet, këshilltari informon Avokatit e Popullit për këtë. Në këtë rast, Avokatit i Popullit mund të vendosë të mos e vazhdojë më shqyrtimin e ankesës.” (Rregullorja e punës për Institucionin e Avokatit të Popullit 2. n., nen 26, n.d.)

Në bazë të rregullores, ankuesi ka të drejtën e këshillimit ligjor nga zyrtari i Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili në bazë të rregullores mundet që “Në rastet kur kërkesa e paraqitur nga ankuesi është e papranueshme, zyrtari i IAP e këshillon ankuesin që të heq dorë nga paraqitja e ankesës dhe të drejtohet në organin apo institucionin që ka kompetencë çështjen e ankuesit. Zyrtari bën regjistrimin e ankesës në rast se ankuesi përkundër këshillimit, insiston që kërkesa e tij të regjistrohet në IAP.” (Rregullorja e punës për Institucionin e Avokatit të Popullit 2. n., n.d.)

Me rëndësi për palën ankuese është edhe regjistrimi e sidomos njoftimi për pranimin e ankesës (Rregullorja e punës për Institucionin e Avokatit të Popullit 2. n., po aty nen 29, n.d.)

Institucioni i Avokatit të Popullit merr vendim për pranueshmërinë e ankesës së pales ankuese. Rregullorja ka përcaktuar shprehimisht se, “Pas pranimit të ankesës në IAP Brenda 24 orëve nga mbërritja e ankesës në IAP, Zyra e Pranimit bën shpërndarjen e ankesave tek Zëvendësi/it dhe njësitë përkatëse. Në rastin e mungesës së këshilltarit të Zyrës së Pranimit shpërndarja kryhet nga vetë Avokati i Popullit ose njëri nga Zëvendësi/et e caktuar prej tij.” Ndërsa kur është në pyetje përcaktimi i kompetencës se cilës njësi të Institucionit të Avokatit të Popullit i takon shqyrtimi i ankesës, rregullorja ka përcaktuar shprehimisht se, “Në rastin kur objekti i një ankese është nën kompetencën e dy njësive, Avokati i Popullit vendos se cila njësi është përgjegjëse për çështjen, si dhe përcakton detyrimin e njësisë tjetër për të bashkëpunuar.” Duke respektuar afatin, këshilltari raportues vepron brenda afatit që përcakton rregullorja, se “Pas pranimit të ankesës, këshilltari përgjegjës raporton çështjen tek zëvendësi përkatës dhe brenda afatit 30 ditor e në pajtim me nenin 19 të Ligjit të Avokatit të Popullit, vendoset për pranueshmërinë e ankesës.” Në rastet kur ankesa shpallet e pa pranueshme, Avokati i Popullit vepron ashtu siç e ka përcaktuar rregullorja se, “Në rast se ankesa shpallet e pranueshme brenda afatit të lartpërmendur, Avokati i Popullit ia përcjell vendimin ankuesit dhe organit kundër të cilit është paraqitur ankesa.” (Rregullorja e punës për Institucionin e Avokatit të Popullit 2. , n.d.)

Rregullorja ka përcaktuar se pala ankuese mund të tërheqë ankesën. Rregullorja shprehimisht ka përcaktuar se, “Parashtruesi mund ta tërheqë ankesën në çfarëdo kohe të

procedimit deri në nxjerrjen e vendimit të Avokatit të Popullit.” Ndërsa Avokati i Popullit sipas rregullores e njopfton autoritetin përgjegjës për tërheqjen e ankesës. Avokati i Popullit lidhur me tërheqjen e ankesës nga ana e parashtruesit, rregullorja ia përcakton se, “Megjithë tërheqjen e ankesës nga vetë parashtruesi, nëse e sheh të arsyeshme, Avokati I Popullit mund të vendosë për procedimin e çështjes ex officio.”(Rregullorja e punës për Institucionin e Avokatit të Popullit 2. n., Po aty nen 31, n.d.)

Institucioni i Avokatit të Popullit sipas rregullores mund edhe të jetë vet pale ankuese për raste të caktuara dhe atë në Gjykatën Kushtetuese të RKS-sës.

Sipas dispozitave ligjore në fuqi, Avokati i Popullit mund të parashtojë ankesë në Gjykatën Kushtetuese të **RKS-sës** lidhur em çështjet të cilat i trajton.

Avokati i Popullit, ankesën e parashtron në Gjykatën Kushtetuese në këto raste:

- është marrë pëlqimi paraprak i ankuesit;
- është kryer një hetim paraprak, rezultati i të cilit është rekomandimi për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. (Rregullorja e punës për Institucionin e Avokatit të Popullit 2. , n.d.)

Nga kjo del se Institucioni i Avokatit të Popullit mund të bëjë ankesën në Gjykatën Kushtetuese në emër të palës ankuese dhe atë pasi të marri pëlqimin e saj për një veprim të tillë.

Po ashtu, sa i përket institucioneve të pavarura në Republikën e Kosovës duhet theksuar që “në teori, institucionet e pavarura tentojnë të respektojnë praktikat më të mira ndërkombëtare në lidhje me themelimin dhe funksionimin. Krijimi i tyre ka baza të shëndosha ligjore, ndërsa mandatet individuale të institucioneve përcaktohen më tej nga ligjet specifike dhe legjislacioni sekondar” (OSCE, 2012). Veç tjerash, duhet përmendur edhe ajo që pavarësisht se ekzistojnë konturat ose një kornizë e qëndrueshme ligjore, risia relative e institucioneve të pavarura krijon një numër paqartësish operationale dhe ligjore. Ka mungesë të legjislacionit sekondar që është thelbësor në sqarimin e roleve dhe përgjegjësive të institucioneve të prekura, dhe aktualisht, boshllëqet në kornizën ligjore pengojnë punën e rreth një të tretës së institucioneve të pavarura. Së këndejmi, në një numër rastesh, mangësitë ligjore paraqesin një sfidë serioze për zbatimin e mandatit të institucioneve (OSCE, 2012).

Përveç organizimit institucional qendror, ekziston edhe organizimi i vetëqeverisjes lokale e cila është e ndërtuar mbi bazë kushtetuese dhe ligjore. Sipas Kushtetutës organizimi


dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale është i organizuar në njësi themelore, ku njësi themelore është Komuna. Sipas Kushtetutës “Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale” (neni 124, par. 1). Bazë e funksionimit, statusit dhe kompetencave të Komunës është ligji për vetëqeverisjen lokale. Në bazë të këtij ligji është përcaktuar statusi ligjor i komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale organizimi dhe funksionimi i organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndër komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror (neni 2, par. 1).

Sa i përket vetëqeverisjes lokale, është e rëndësishme të përmendet edhe miratimi i Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në vitin 1985, e cila vetëqeverisjen lokale e definon si të drejtë dhe aftësi të autoriteteve lokale, brenda kufijve të ligjit, për të rregulluar dhe menaxhuar një pjesë të konsiderueshme të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interesat e popullatës lokale (neni 3, par. 1). Në këtë rast duhet përmendur po ashtu se “aktivitetet e vetëqeverisjes lokale bazohen në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, si dhe në respektimin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale” (Hasani & Čukalović, 2013, p. 54).


Gjithashtu, në këtë rast vlen të përmendet se “në këtë kuadër, me qëllim të zbatimit të kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës u inkorporuan dispozitat e saj, në nivel të njëjtë të obligimeve me vendet që kanë nënshkruar dhe ratifikuar Kartën. Përveç kësaj, u miratuan ligjet bazike për vetëqeverisje lokale duke përfshirë: Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave, Ligjin për Zgjedhjet Lokale, si dhe Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal (SVL - MAPL, 2016, p. 14). Karta angazhon Palët të zbatojnë rregullat themelore që garantojnë pavarësinë politike, administrative dhe financiare të autoriteteve lokale. Ajo parashikon që parimi i vetëqeverisjes lokale do të njihet në legjislacionin e brendshëm dhe, kur është e mundur, në kushtetutë.

Në vazhdim paraqesim disa të dhëna statistikore në formë diagrami për lëndët të cilat janë adresuar tek Institucioni i Avokatit të Popullit për periudhën :Janar-Dhjetor 2020.


Paraqitja grafike e statistikave 1 janar 2020-31 dhjetor 2020



Shqyrtimi i ankesave të paraqitura në IAP



Pjesëmarrja e gjinive




Pra siqe shifet ne grafikon pjesëmarrës ne ankesa pran institucioni, te cilët kan ushtruar te drejtën e ankesës ishin :


Gjinija Mashkullore -----72%

Gjinija Femrore-----28%


Institucionet shtetërorë pjesëmarrëse




Përkatësia etnike:




Lëndae rastevetëhetuara,bazuar nëtëdrejtategarantuarameKushtetutë



Rastet e trajtuara



Zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit



10. Roli i mekanizmave parlamentar: Komisioni i të drejtave të njeriut dhe për të drejtat dhe interesat e komunitetit

Gjithashtu jo pak të rëndësishëm në realizimin e të drejtave të njeriut, luan një rol Kuvendi i Kosovës me mekanizmat e veta. Nga trupat punues të Kuvendit janë edhe komisionet Parlamentare, përmes të cilëve ushtrohet funksioni legjislativ dhe mbikëqyrës. Bazuar në nenin 77 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “Kuvendi i Kosovës emëron komisione të përhershme, komisione funksionale dhe komisione ad hoc, që pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit”. Në kuadër të këtyre komisioneve bënë pjesë edhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe është komision i përhershëm i Kuvendit. Është paraparë themelimi i këtij komisioni me Kushtetutë për shkak të rëndësisë së veçantë që ky komision e ka me kushtetutë është përcaktuar që ky komision përbëhet nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb, nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, dhe një e treta (1/3) e anëtarëve nga komuniteti shumicë, të përfaqësuar në Kuvend (neni 78, par.1). Natyrisht se “detyra më e rëndësishme e këtij Komisioni është që të respektojë të drejtat e komuniteteve dhe ruajtjen e multietnicitetit, kështu që roli i tij është shumë i rëndësishëm në ruajtjen dhe garantimin e të drejtave dhe interesave të pjesëtarëve të komuniteteve në territorin e Republikës së Kosovës” (Hasani & Čukalović, 2013, pp. 352-353).

Kreu i pestë

TË DREJTAT E NJERIUT: ASPEKTE KRAHASUESE

Republika e Kosovës, siç kemi theksuar edhe më lartë, ka krijuar një legjislacion që i përgjigjet standardeve ndërkombëtare. Ajo që ngelet sfidë, është zbatimi i këtij legjislacioni, ku Republika e Kosovës ka hasur më tepër në vështirësi. Në rrugëtimin e saj që nga përfundimi i luftës, Kosova ka pasur fatin që të ketë prezencën ndërkombëtare dhe angazhimet e saj në ndërtimin e infrastrukturës ligjore kanë qenë të monitoruara dhe të asistuara drejtpërdrejtë nga shtetet evropiane.

Në këtë pjesë të punimit do të paraqiten esencialisht aspekte krahasuese me vendet fqinje dhe shtetet e tjera të shkëputura nga ish-Jugosllavia. Vlen të theksohet krahasuar me shtetet e tjera të ish-Jugosllavisë, së Republika e Kosovës, përkundër arritjes së pavarësisë tepër vonesa i përket të drejtave të njeriut, por edhe aspekteve të tjera të avancimit të shtetësisë dhe demokracisë nuk ndodhet largë tyre.

1. Republika e Kroacisë

Duke pasur parasysh se Republika e Kroacisë është pjesë e Bashkimit Evropian, pa dyshim që edhe organizimi i saj kushtetues dhe ligjor i përgjigjet nivelit të Bashkimit Evropian. Në këtë drejtim, në kapitullin e tretë të Kushtetutës së saj, Kroacia ka paraparë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Duke proklamuar parimin e barazisë në nenin 14 të Kushtetutës së saj është paraparë që “të gjithë personat në Republikën e Kroacisë do të gëzojnë të drejtat dhe liritë, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, bindja politike ose tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, prona, lindja, arsimi, statusi shoqëror ose karakteristikat e tjera” (neni 14, par. 1).

Si në shumë vende demokratike edhe në Republikën e Kroacisë janë ngritur institucione kushtetuese dhe ligjore, që merren me të drejtat e njeriut. Ndër institucionet kryesore dhe qendrore që merret ekskluzivisht me të drejtat e njeriut është Ombudspersoni (tek ne emërtohet si Avokati i Popullit). Ky institucion është i paraparë në nenin 93 të kushtetutës së Kroacisë ku thuhet se, “Ombudspersoni do të jetë një komisioner i Parlamentit

Kroat përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të parashikuara në Kushtetutë, ligjet dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut të ratifikuara nga Republika e Kroacisë” (neni 93, par.1).

Ngjashëm si në Republikën e Kosovës, edhe në Republikën e Kroacisë Ombudspersoni (Avokati i Popullit) është përcaktuar nga Kushtetuta. Si institucion i pavarur, ku të gjithë personat mund të paraqesin ankesë tek Ombudspersoni, nëse ai/ajo gjykon se të drejtat e tij/saj kushtetuese ose ligjore janë kërcënuar ose shkelur, si rezultat i ndonjë veprimi të paligjshëm ose të parregullt nga organet qeveritare dhe shërbimi civil, organet dhe organet e vetëqeverisjes lokale dhe rajonale veshur me autoritetin publik (neni 93, par. 2-3).

Sipas raportit të Ombudspersonit të Republikës së Kroacisë për vitin 2018, shoqëria kroate karakterizohet vazhdimisht nga mosbesimi i fortë i qytetarëve ndaj institucioneve, siç konfirmohet nga hulumtimi, i cili, së bashku me një shtet të dobët të organizuar, është ndër arsyet kryesore të emigrimit, sipas qytetarëve. Shumë qytetarë kroatë, veçanërisht të moshuarit, ende përballen me varfërinë që nuk i lejon ata të ushtrojnë shumë të drejta të tjera. Mungesa e shërbimeve sociale, shëndetësore, komunale dhe shërbime të tjera, varfëria energjetike dhe izolimi nga transporti publik mbeten pjesë e jetës së përditshme të shumë qytetarëve kroatë, veçanërisht atyre në zonat rurale dhe në ishujt (Annual Report of the Ombudsman of Croatia, 2018, p. 321). Ndërsa raporti i Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për Kroacinë, për vitin 2019, vrenë se “çështje specifike të të drejtave të njeriut përfshinin: kërcënime dhe raste të izoluara të censurës së gazetarëve; raporte të veprimeve të dhunës së pajustificuar policore që synojnë migrantë të parregullt, disa prej të cilëve mund të kenë qenë azilkërkues; korrupsioni; dhe diskriminimi dhe dhuna ndaj anëtarëve të grupeve të pakicave etnike, përfshirë romët dhe serbët” (Raport i DASH për Kroacinë, 2019, p. 1).

Nga kjo rrjedh se, pavarësisht që shteti ndodhet brenda kufijve të Bashkimit Evropian, qytetarët kroat ndjejnë mosbesim ndaj institucioneve, dhe për më tepër ikjen nga vendi e shohin si alternativë për sigurimin e një jete më të mirë.

2. Republika e Sllovenisë

Edhe Republika e Sllovenisë u benë trajtim të rëndësishëm të drejtave dhe lirive të njeriut. Në kushtetutën Sllovene, të drejtat e njeriut zënë vend në kapitullin e dytë. Në mënyrë të ngjashme, si në Kushtetutën tonë, si dhe atë të Republikës së Kroacisë, është paraparë se të gjithë qytetarëve u garantohen të drejtat e barabarta të njeriut dhe liritë themelore, pavarësisht nga origjina kombëtare, raca, gjinia, gjuha, feja, bindja politike, ose bindje tjetër, statusi material, lindja, arsimit, statusi shoqëror, paaftësia ose ndonjë rrethanë tjetër personale (neni 14, par.1).

Krahasuar me Kroacinë vlen të përmendet se në raportin e Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të vitit 2019, për Slloveninë theksohet se “çështje specifike të të drejtave të njeriut përfshinin dhunën shoqërore që targeton personat lezbike, homoseksuale, biseksuale, trans gjinorë ose ndër-seksuale” (Raport i DASH për Slloveninë, 2019, p. 1). Kjo tregon se avancimi i këtyre të drejtave është në një nivel të ngjashëm në këto dy vende. Mirëpo, krahasuar me Republikën e Kosovës del të keni avancim shumë më të lartë. Në këtë rast vlen të përmendet se raporti i Departamentit të Shtetit për Kosovën vrenë që “çështje specifike rreth lirive dhe të drejtave të njeriut përfshinin: kufizime të padrejta në shtyp, përfshirë dhunën ose kërcënimet ndaj gazetarëve; korrupsioni dhe mosndëshkimi i qeverisë; dhe njëherit edhe sulmet kundër anëtarëve të pakicave etnike ose bashkësive të tjera të marginalizuara, përfshirë këtu edhe Policinë e Kosovës” (Raport i DASH për Kosovën, 2019, p. 1). Për më tepër, në raport theksohet që “shumë në qeveri, opozitë, shoqëri civile dhe media raportuan raste të zyrtarëve të lartë të përfshirë në korrupsion dhe duke vepruar pa u ndëshkuar” (Raport i DASH për Kosovën, 2019, p. 1).

Gjithashtu edhe Republika e Sllovenisë e ka të themeluar me ligj Ombudsman –in (Avokatin e Popullit), konformë nenit 159 të Kushtetutës së saj. Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Sllovenisë Avokati i Popullit është themeluar “me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në lidhje me autoritetet shtetërore, autoritetet e vetëqeverisjes lokale dhe bartësit e autoritetit publik” (neni 159, par.1).

Vlen të theksohet se probleme të theksuara thuaj se në të gjitha shtetet e ish federatës Jugosllave, në këtë rast edhe në shtetin e Sllovenisë, mbeten të drejtat e minoriteteve. Në këtë drejtim “Amnesty International përcakton shqetësime specifike në lidhje me diskriminimin e vazhdueshëm ndaj minoritetit Romë dhe, në veçanti, sfidat e vazhdueshme në aftësinë e tyre për të hyrë në arsim, strehim dhe shërbime të tjera thelbësore. Një shqetësim tjetër i madh

është trajtimi i paligjshëm i Sllovenisë ndaj azilkërkuesve dhe emigrantëve” (SLOVENIA: PERSISTING CHALLENGES IN ROMA INTEGRATION, 2019, p. 6).

3. Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës

Kur flasim për shtetet e krijuara me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, natyrisht, me së shumti probleme sa i përket të drejtave të njeriut, si edhe probleme tjera, janë prezentë në vendet ku luftërat kanë qenë me më shumë pasoja, siç është rasti i Bosnjë e Hercegovinës dhe rasti i Kosovës. Në këtë drejtim, veçohen sidomos problemet ndër etnike. Duke pasur parasysh të kaluarën historike të këtij shteti, është e natyrshme që tu kushtohet një rëndësi e theksuar të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst, Kushtetuta e Bosnjës dhe Hercegovinës të drejtat e njeriut i ka të precizuara në kapitullin e dytë të saj.

Vlen të theksohet se organizimi shtetërorë, si rrjedhojë e luftës dhe problemeve ndër-etnike, dallon nga vendet e tjera të ndara nga ish-Jugosllavia, si për shembull, Kushtetuta përcakton që Presidenca e Bosnje dhe Hercegovinës të përbëhet nga tre Anëtarë: një Boshnjak dhe një Kroat, secili i zgjedhur drejtpërdrejt nga territori i Federatës dhe një Serb i zgjedhur drejtpërdrejt nga territori i Republika Srpskas (neni 5). Në këtë drejtim edhe parlamenti boshnjak është përcaktuar me Kushtetut që të përbëhet nga dy dhoma dhe atë: Dhoma e Qytetarëve dhe Dhoma e Përfaqësuesve (neni 4).

Duhet theksuar se Kushtetuta Boshnjake ka paraparë zbatim direkt në Bosnjë dhe Hercegovinë, të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe Protokolleve të saj, dhe po ashtu, Kushtetuta përcakton se këto akte do të kenë përparësi mbi të gjitha ligjet e tjera (neni 2, pika 2). Është me rëndësi të përmendet raporti i Departamentit të SHBA-së, në të cilin theksohet se, “çështje e rëndësishme rreth të të drejtave të njeriut përfshinin: probleme të rëndësishme me pavarësinë e gjyqësorit; kufizimet e shprehjes së lirë, shtypi dhe interneti, përfshirë dhunën dhe kërcënimet e dhunës ndaj gazetarëve; korrupsion i rëndësishëm qeveritar; trafikimi i personave; dhe krime që përfshijnë dhunë ose kërcënime të dhunës ndaj anëtarëve të pakicave kombëtare / etnike / racore dhe personave lezbike, homoseksuale, biseksuale, trans gjinore dhe ndër-seksuale (LGBTI)” (Raporti i DASH për BeH, 2019, p. 2).

Në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë është i kyçur Avokati i Popullit, ku “bazat për punën dhe funksionimin e Avokatit të Popullit të Bosnjë dhe Hercegovinës janë të përfshira në Aneksat IV dhe VI të Marrëveshjes Kuadër të Përgjithshme për Paqen për Bosnjën dhe Hercegovinën të përfunduara në 14 dhjetor 1995 dhe, bazuar në dokumentet e përmendura, institucioni ka filluar të funksionojë në vitin 1996 (<https://www.ombudsmen.gov.>, 2020).

4. Republika e Maqedonisë së Veriut

Ashtu si edhe republikat e tjera të ish-Jugosllavisë, edhe Republika e Maqedonisë së Veriut ka trajtuar posaçërisht të drejtat e njeriut. Një nga vlerat kryesore Kushtetuta e saj përcakton liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit, të njohura me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë (neni 8, par1).

Që në kapitullin e dytë, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka përcaktuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Problemet ndëretnike, problemet politike në vazhdimësi, si dhe problemet socio ekonomike, kanë reflektuar edhe në avancimin dhe realizimin e të drejtave të njeriut në vend. Vlen të përmendet konstatimi i Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara për vitin 2016, ku theksohet se “problemet më të rëndësishme për të drejtat e njeriut kanë qenë rezultat i korrupsionit të vazhdueshëm dhe dështimit të qeverisë për të respektuar plotësisht sundimin e ligjit, përfshirë përpjekjet e vazhdueshme për të kufizuar lirinë e medias, ndërhyrjet në gjyqësi, dhe pengimin e punës së Zyrës së Prokurorisë Speciale e ngarkuar me hetimin dhe përndjekjen e krimeve lidhur me dhe që kanë rezultuar nga përgjimet e paligjshme si dhe administrimi selektiv i drejtësisë. Ndërhyrja politike, jo efikasiteti, favorizimi i personave në pozita të mira, proceset e zvarritura, shkeljet e së drejtës për gjykim publik dhe korrupsioni e karakterizuan sistemin gjyqësor” (Raport i DASH për Maqedoninë, 2016, p. 1). Natyrisht, kjo tregon brishtësinë e demokracisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut ka paraparë edhe institucionin e Avokatit të Popullit, në mbrojtje të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve,. Në nenin 77 të kushtetutës së saj, është përcaktuar që “Avokati i Popullit i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të cilat u janë cenuar nga organet e administratës shtetërore dhe nga

organet e organizatat e tjera të cilat kanë autorizime publike” (neni 77, par. 1). Në këtë drejtim vlen të përmendet konstatimi i raportit të Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019, ku theksohet se “nga gjithsej 3.454 lëndë sipas të cilave Avokati i Popullit ka hapur procedurë, në 1.219 ose 35,29% raste janë konstatuar cenime të të drejtave dhe lirive të qytetarëve” (Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit, 2019, p. 165).

Ndër problemet më të theksuara në Maqedoninë e Veriut, posaçërisht në dy dekadat e fundit, kanë qenë problemet ndër-etnike. Këto probleme kanë sjellë më së shumti pasiguri ndër qytetarët që jetojnë në këtë shtet. Natyrisht, është e dukshme edhe qasja e keqe e pushtetit ndaj shumicës shqiptare, gjë që ka sjellë edhe konflikt të armatosur në vitin 2001. Në këtë kuptim, me të drejtë shprehet edhe Rade Rajkovçevski se “dinamika e ngjarjeve të sigurisë në Republikën e Maqedonisë, veçanërisht në periudhën pas pavarësisë, rezulton nga marrëdhëniet ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike dhe faktorëve politikë – në planin e brendshëm dhe ndikimi i vendeve fqinje, SHBA-ve, vendeve të fuqishme në BE dhe BE si tërësi – në planin e jashtëm” (Rajkovçevski, 2014).

5. Republika e Malit të Zi

Ngjashëm si edhe shtetet e tjera të krijuara nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë, edhe Republika e Malit të Zi, ka synuar krijimin e standardeve të avancuara për të drejtat e njeriut në harmoni dhe përshtatje standardeve të përcaktuara nga konventat ndërkombëtare. Ngjashëm me vendet e tjera fqinje të ish-Jugosllavisë edhe kushtetuta e Malit të Zi u kushton vëmendje të theksuar të drejtave të njeriut. Pjesa e dytë e kushtetutës së saj përcakton të drejtat dhe liritë e njeriut, ndërsa të drejtat e veçanta të pakicave përcaktohen në pikën e pestë të kësaj pjese.

Zhvillimi i të drejtave të njeriut edhe në Republikën e Malit të Zi nuk dallon nga vendet e tjera fqinje. Vlen të përmendet konstatimi i Departamentit të Shtetit të SHBA-së, në të cilin theksohet se “çështje kyçe të të drejtave të njeriut përfshinin: sulme të pazgjdhura ndaj gazetarëve dhe presion mbi shtypin përfshirë dhunën ose kërcënimet e ndryshme; korrupsioni; trafikimi i personave; dhe krime që përfshijnë dhunë ndaj personave lezbike, homoseksuale, biseksuale, trans gjinore dhe ndër-seksuale (LGBTI). Mosndëshkimi mbeti një problem, pasi qeveria nuk hetoi ose ndëshkoi zyrtarë që kryen abuzime të të drejtave të njeriut” (Raport i DASH për Malin e Zi, 2019, p. 1).

Edhe në Malin e Zi funksionin Institucioni i Avokatit të Popullit, i cili është i njohur me emërtimin Institucioni i Mbrojtësit të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Malit të Zi (Ombudsmani). Ky institucion u krijua me anë të një Ligji që u miratua nga Kuvendi i Malit të Zi më 10 korrik 2003. Avokati i Popullit kryen detyrat e tij në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve dhe aderon në parimet e drejtësisë dhe drejtësisë gjatë punës së tij. Sipas Ligjit për Mbrojtësin e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Malit të Zi (hyr në fuqi më 23 gusht 2011) Ombudsmani ka dy kompetenca të reja dhe ai u bë mekanizmi institucional për mbrojtje nga të gjitha format e diskriminimit dhe Mekanizmi Kombëtar Parandalues për mbrojtjen dhe parandalimi i personave të privuar nga liria kundër torturave dhe formave të tjera të trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose degradues (<https://equineteurope.org>, 2020). Po ashtu edhe kushtetuta e Malit të Zi e vitit 2007, parasheh institucionin e Avokatit të Popullit të njohur si Mbrojtësi i të Drejtave dhe i Lirive të Njeriut. re i Kushtetutës përcakton se “Mbrojtësi i të Drejtave dhe i Lirive të Njeriut në Malin e Zi është organ sovran dhe i pavarur që ndërmerr masat për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Mbrojtësi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut e kryen funksionin në bazë të Kushtetutës, ligjit dhe kontratave ndërkombëtare të ratifikuara, duke u përmbajtur parimit të drejtësisë dhe të paanësisë” (neni 81, par. 1 dhe 2).

KREU I GJASHTË:

Pyetësi dhe Intervistat

Pyetësor anketues i hulumtimit

Autor: **LLM. Petrit Hajdari, PhD kandidat**

Prishtinë, 2020

1. Pyetje demografike:

a.) Gjinia

- 1.) Mashkullore
 - 2.) Femërore
-

b.) Moshë:

- 1.) 18-25 vjet
 - 2.) 26-35 vjet
 - 3.) 36-45 vjet
 - 4.) 46-65 vjet
 - 5.) Mbi 65 vjet
-

c.) Shkalla e arsimimit:

- 1.) Arsimit mesëm;
- 2.) Baçellor;
- 3.) Master;
- 4.) Doktoratë

2. Pyetje profesionale

Rrumbullakoseni njërën nga alternativat:


Nr.	Pyetje	Përgjigje	
1.	Si e vlerësoni nivelin e respektimit të të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës?	1. Nivel i lartë; 2. Nivel i mesëm; 3. Nivel i ulët.	
2.	A ofron mbrojtje adekuate të të drejtave të njeriut, sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës?	1. Shumë; 2. Mesatarisht; 3. Pak; 4. Aspak	
3.	A respekton standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut Kushtetuta e Republikës së Kosovës?	1. Shumë; 2. Mesatarisht; 3. Pak; 4. Aspak.	
4.	A ofron përfaqësim të drejtë të komuniteteve jo shumicë, Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës?	1. Shumë; 2. Mesatarisht; 3. Pak; 4. Aspak.	
5.	A ndikohet niveli i mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga konfliktet politike të brendshme në Republikën e Kosovës?	1. Nuk ndikohet fare; 2. Ndikohet pak; 3. Ndikohet mesatarisht; 4. Ndikohet shumë.	
6.	A ofron mbrojtje adekuate të të drejtave të njeriut Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës?	1. Shumë; 2. Mesatarisht; 3. Pak; 4. Aspak	
7.	A janë të penalizuar qytetarët e Republikës së Kosovës me pamundësinë e ngritjes së çështjes së shkeljes së të drejtave të njeriut në Gjykatën e Strasburgut?	1. Shumë; 2. Mesatarisht; 3. Pak; 4. Aspak.	
8. Sipas Jush, cili nga faktorët e cekur ka ndikim		Ndikon	Nuk ndikon

mbi situatën e zbatimit në praktikë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore në Republikën e Kosovës?		
1. Mos-anëtarësimi i Kosovës në OKB	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
2. Mos-anëtarësimi në Këshillin e Evropës	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
3. Marrëdhëniet e tensionuara të komunitetit shumicë – shqiptarëve dhe komunitetit pakicë – serbëve	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
4. Procesi i ngadaltë i anëtarësimit në BE	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
5. Brishtësia e sistemit gjyqësor	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
6. Kapacitet e ultë profesionale të institucioneve të rendit dhe sigurisë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
7. Korrupsioni dhe nepotizmi	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
8. Shkalla e papunësisë dhe varfërisë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
9. Mos toleranca fetare	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
10. Mos toleranca ndëretnike	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

Përgjigjet e 300 të anketuarve të rastit përmes Platformef “Google Forms”

1.Në pyetjen e parë në lidhje me gjinin e të anketuarve janë përgjigjur si në vijim:

1.Gjinia juaj:
298 responses



Në këtë pyetje sa i përket gjinisë të anketuarit janë përgjigjur si në vijim:

57% Gjinisë Mashkullore


43% Gjinia Femërore

Është jashtëzakonisht e rëndësishme se në këtë pyetësorë kanë marrë pjesë të dy gjinitë dhe secili ka dhënë mendimet e tyre në mënyrë të pavarur, sipas bindjeve të tyre.

2.Në pyetjen e dytë në lidhje me moshën e të anketuarve janë përgjigjur si në vijim:

2. Moshë juaj:

298 responses




- 18-25 vjeç me 31.2 %, :26-35 vjeç me 22.8%, :36-45 vjeç me 27.2%, :46-55 vjeç me 6.1%:56-65 vjeç me 2.1%:mbi 50 vjeç me 0.6%.

Siç po e shohim përmes grafikorit, në anketë kanë marrë pjesë grupe moshë të ndryshme, ku dhe grup moshë e cila dominon në këtë anketë është ajo në mes moshës 18 e 25 vjeç. E karakteristikë e hulumtimit është se në këtë anketë janë përfshirë edhe moshat mbi 65 vjeç. Mendoj se kam bërë një gjithë përfshirje të të gjitha moshave dhe të të dy gjinive. Kjo e fuqizon edhe më tepër hulumtimin.

3. Në lidhje me nivelin arsimor të anketuarit janë përgjigjur si në vijim:

3. Niveli juaj arsimorë:

297 responses



59.3% e tyre janë me shkollim universitar në nivelin Bachelor,

31.3% në nivelin Master,

5.4% në nivelin e Doktoratës.


3.0% Vetëm shkollë e mesme

Niveli arsimor I të anketuarve është I përfshirë nga të gjitha nivelet, e sipas përqindjes, dominojnë respondentë të cilët kanë të përfunduar studimet bachelor. Por gjithashtu mund të s' hohim se një pjesëmarrje të madhe kemi edhe me nivelin Master, të cilët kanë kontribuar jashtë zakonisht shumë në rezultatet e hulumtimit. Kur them se kanë ndikuar në rezultate më të mira, e kam fjalën përpërgjigjet dhe komentet e tyre në këtë anketë. Një përqindje e konsiderueshme e respondentëve të cilët janë të nivelit PHD dhe kjo mendoj se është ajo që hulumtimin e bënë më të kompletuar dhe më përmbajtësor. Mendoj se përfshirja e respondentëve me nivele të ndryshme të kualifikimeve na ka dhënë rezultate dhe një pasqyrë më të kurtë në këtë hulumtim.

4. Në lidhje me përkatësinë etnike të anketuarit janë përgjigjur si në vijim:

4. Përkatësija juaj etnike:

297 responses



96.6% Shqiptarë

1.3%Boshnjakë

0.7%Turq

0.3% Ashkali

0.3%Romë


0.3% Serbë

Përfshirja e pakicave kombëtare në hulumtim është një nga komponentët e këtij hulumtimi. Nëse marrim për bazë përbërjen e popullsisë në Kosovë, atëherë mund të themi se në kuadër të hulumtimit janë përfshirë shumica e pakicave kombëtare. Por padyshim se pjesa dominuese e të anketuarve kanë qenë shqiptarë, gjë që është normale edhe në përputhje me atë se shqiptarët përbëjnë mbi 90% të popullsisë në Kosovë. Në kuadër të hulumtimit i kam përfshirë edhe pakicat kombëtare në mënyrë që me nxjerrë rezultatet sa më të sakta, rezultate të cilat e paraqesin gjendjen reale në Kosovë. Kjo është e rëndësishme, rezultatet të përputhen me gjendjen faktike në terren.

5. Në lidhje me përkatësinë etnike dhe Fetare janë përgjigjur si në vijim:

5. Përkatësia juaj fetare:

292 responses



Katolikë 4.1%

Ortodoksë 0.3%

Të tjerë 2.4%


Islame 93.2%

Komponentë shumë e rëndësishme dhe shumë e nevojshme është pjesëmarrja dhe deklarimi I përkatësisë religjioze. Pse e them këtë. Këtë e them sepse ne nga jeta e përditshme e shohim dhe e vërejmë, se disa nga të drejtat e njeriut interpretohen dhe nga përkatësia religjioze apo të drejta që burim të vetin e kanë fenë apo librat e shenjtë. Pra, një pjesë e mirë e shoqërisë të drejtat e tyre I kuptojnë sipas përkatësisë fetare. Pra ata veprimet dhe përgjegjësitë I kuptojnë sipas rregullave fetare.

6. Në lidhje me statusin e punës janë përgjigjur si në vijim

6. Statusi juaj i punës:

298 responses




- 52.7% janë të punësuar në sektorin Publik,
- 32.2%, janë të papunë:
- 14.1%. dhe janë të punësuar në sektorin Privat:
- 1.0% ishin të punësuar në OJQ

Pjesëmarrësit në këtë hulumtim janë kategori shoqërore, të cilët shumica prej tyre janë të punësuar dhe pjesa më e madhe e këtyre të punësuarve janë të punësuar në sektorin publik. Pa dyshim se përzgjedhja e reposdentëve nuk ka qenë e planifikuar të jenë nga sektori publik apo ai privat.

Kryesisht hulumtimi ka qenë i fokusuar tek liritë dhe të drejtat e njeriut, e që në esencë pa dallim profesioni, feje apo gjinie, të gjithë mund të jenë të atakuar dhe të privuar nga të drejtat e tyre. Në kuadër të hulumtimit kam përfshirë edhe persona që vijnë nga sektori privat, shoqëria civile si dhe një përqindje e madhe e atyre që ende nuk kanë një vend pune. Këto elemente të përfshira në këtë hulumtim janë një gërshetim i përgjigjeve dhe një pasqyrë reale e shoqërisë kosovare.

7. Pyetja në lidhje me profesionin e të anketuarve janë përgjigjur si në vijim:




Profesionet	Nr. I pjesëmarrësve	Perqindja %
Jurist	40	13.9
Ekonomist	28	9.8
Student	20	7.0
Polic	16	5.6
Doganier	25	8.7
Mjek	18	6.3
Profesor	26	9.1
Inxhinier	13	4.5
Mësues	16	5.6
Pa punë	48	16.7
Nënpunës civil	14	4.9
Sportist	15	5.2
Gazetar	8	2.8

Të anketuarit janë nga fusha të ndryshme dhe me profesione të ndryshme. Shihet sipas përqindjes se dominojnë respondentët që janë jurist me profesion, por gjithashtu një përqindje e mirë janë edhe nga fushat dhe profesionet tjera. Secili nga ta ka dhënë mendime të mira dhe kanë paraqitur përvojat e tyre, me të cilat ballafaqohen në përditshmëri apo edhe ju ka rënë të ballafaqohen nëpër faza të ndryshme.

8. Pyetja në lidhje me njohurinë me sistemin juridike në RKS janë përgjigjur si në vijim:

8. Sa e njihni systemin juridik në Republikën e Kosovës:
298 responses



- a) Kam njohuri të thelluara mbi funksionimin e sistemit juridik në Republikën e Kosovës
- b) Kam njohuri të gjera mbi funksionimin e sistemit juridik në Republikën e Kosovës
- c) Kam njohuri elementare mbi funksionimin e sistemit juridik në Repu...
- d) Nuk kam njohuri mbi funksionimin e sistemit juridik në Republikën e Kosovës

Në këtë pyetje janë përgjigjur qe :

46.6% kanë njohuri elementare

29.2% kanë njohuri të gjëra

16.4% kanë njohuri të thella


7.7% nuk kanë njohuri fare

Kuptohet se jo të gjithë e njohin mirë sistemin juridik të vendit. Kur e them këtë e bazoj në atë se respondentët vijnë nga fusha të ndryshme dhe kanë profesione të ndryshme. Këtu mendoj se respondentët të cilët kanë të përfunduar nivelin e mesëm të shkollimit, janë të prirur që të kenë më pak informacione për sistemin Juridik. Por është edhe ana tjetër e medaljes, se një pjesë e madhe e respondentëve janë jurist me profesion dhe janë njohës të mirë të sistemit juridik. Pa dashur me i favorizuar juristët, mendoj se njohuri të thelluara kanë edhe respondentët me profesione të tjera. Mendoj se pozicioni i tyre apo puna të cilën e bëjnë, ju jep përparësi më tepër që të jenë njohës të mirë të sistemit juridik në vend.

9. Pyetja e të anketuarve se a kanë lexuar ndonjë here Kushtetutën e RKS, janë përgjigjur si në vijim...

9. A e keni lexuar ndonjëherë Kushtetutën e Republikës së Kosovës:

294 responses



Janë përgjigjur si në vijim:

- **69.4% kanë thënë se kanë lexuar**
- **30.6% kanë deklaruar se asnjëherë**

Është evidente por edhe e dukshme sipas rezultateve që, pjesa më e madhe e respondentëve e kanë lexuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Disa prej tyre e kanë edhe p unë të përditshme konsultimin me ligje dhe kushtetutë, si p.sh. Juristët. Por sipas rezultateve mund të shohim se një pjesë e madhe e të anketuarve e kanë lexuar Kushtetutën, qoftë nga kureshtja apo nga nevoja në realizimin e të drejtave të tyre.

10. Pyetja e të anketuarve se a kanë njohuri mbi të drejtat dhe liritë bazë të qytetarit në RKS, janë përgjigjur si në vijim:

39.5% kanë njohuri elementare

37.5% kanë njohuri të gjera


22.6% kanë njohuri të thelluar

Edhe në pyetjen : A kanë njohuri mbi të drejtat dhe liritë bazë të qytetarit në RKS? Shumica e të anketuarve kanë njohuri elementare, por një pjesë jo e vogël e të anketuarve kanë njohuri të gjëra. Kuptohet se njohuri të thelluara kanë një përqindje më e vogël porë dhe respondentët kanë profesione të ndryshme .Dhe kuptohet se juristët janë më të prirur të kenë njohuri më të thelluara të Kushtetutës. Juristët pra, përveç që e kanë punë dhe profesion kanë edhe fushë mbi masën e secilës janë të kualifikuar, për të qenë më kompetentë në këtë fushë. Pa dashtë që t'i jep kaheje apo konotacion përgjigjeve të respondentëve, njohja dhe bazimi I të drejtave të qytetarëve në Kushtetutë, është njohje dhe e drejtë elementare, në mënyrë që të drejtat e tyre t'i realizojnë sipas aktit më të lartë juridik e politik të vendit.

11. Pyetja e të anketuarve, se a kanë njohuri mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive bazë të qytetarit në Kushtetutën e RKS, janë përgjigjur si në vijim:

11. A keni njohuri mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive bazë të njeriut dhe qytetarit me Kushtetutën e Republikës së Kosovës

296 responses



Edhe në këtë pyetje e shohim se qytetarët kanë njohuri për të drejtat e tyre, pavarësisht se dikush më tepër I kupton apo dikush më pak. E rëndësishme është se qytetarët janë të njoftuar me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre që derivojnë nga Kushtetuta. Qytetarët në Kosovë kanë njohuri mbi të drejtat e tyre, qoftë nëse kanë qenë subjekt I mohimit të këtyre të drejtave qoftë nga kureshtja për t'i njohur ato. Qytetarët janë mirë të informuar sipas rezultateve për liritë dhe të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë.

12.Në pyetjen e radhës janë të inkorporuar edhe 22 nënpyetje ku të anketuarit janë përgjigjur si në vijim:

. Te pohimet në vijim etiketoni opsionin që më së miri përshkruan qëndrimin tuaj:

	Pajtohem plotësishtë	Pajtohem pjesërishtë	Nuk pajtohem	Nuk kam mendim
Të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit	293	3		3
Askush nuk guxon të diskriminohet në bazë të racës	291	4	2	2
Askush nuk guxon të diskriminohet në bazë të gjinisë	288	7	1	3
Askush nuk guxon të diskriminohet në bazë të përkatësisë etnike	285	11		2
Askush nuk guxon të diskriminohet në bazë të përkatësisë fetare	289	7	1	2
Askush nuk guxon të diskriminohet në bazë të gjendjes ekonomike	290	5		4
Askush nuk guxon të diskriminohet në bazë të gjendjes sociale	287	7	1	4
Askush nuk guxon të diskriminohet në bazë të orientimit seksual	224	49	10	6
Duhet respektuar integriteti fizik i gjithsecilit	281	12	1	5
Duhet respektuar integriteti psikik i gjithsecilit	268	20	1	1
Askush nuk guxon të torturohet	278	10	1	10
Askush nuk guxon të trajtohet në mënyrë që cenon dinjitetin e tij	281	10	7	1
Askush nuk guxon të privohet nga liria në mënyrë të jashtëligjshme	283	9	1	3

Gjithsecili duhet të lejohet të zgjedh vendbanimin e tij dhe ta ndryshojë atë	272	19	8	
Duhet respektuar jeta private dhe familjare e gjithsecilit	289	5	1	7
Duhet respektuar privatësia e të gjitha formave të komunikimit	275	19		1
Gjithsecili duhet të gëzojë të drejtën e shprehjes	274	20		1
Duhet garantuar liria e tubimeve paqësore	269	22	5	1
E drejta e pronës duhet të jetë e garantuar	283	9	1	1
Askujt nuk duhet cenuar e drejta e shkollimit	287	7	5	
Liria artistike duhet të jetë e garantuar	265	26	6	2
Liria akademike duhet të jetë e respektuar	281	10	2	

13. Në pyetjen e radhës janë të inkorporuar edhe 22 nënpyetje ku të anketuarit janë përgjigjur si në vijim:

13. Te pohimet në vijim etiketoni opsionin që më së miri përshkruan qëndrimin tuaj:

	Pajtohem plotësishtë	Pajtohem pjesërishtë	Nuk pajtohem	Nuk kam mendim
Jam i mendimit se në Republikën e Kosovës jo të gjithë trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit	164	118	16	1
Jam i (e) mendimit se në Kosovë qytetarët janë të diskriminuar në bazë gjinore	126	118	53	2
Jam i (e) mendimit se në Kosovë qytetarët janë të diskriminuar në bazë të përkatësisë etnike	115	101	81	2
Jam i (e) mendimit se në Kosovë qytetarët janë të diskriminuar në bazë të përkatësisë fetare	116	96	73	8
Jam i (e) mendimit se në Kosovë qytetarët janë të diskriminuar në bazë të gjendjes ekonomike	136	113	47	3
Jam i (e) mendimit se në Kosovë qytetarët janë të diskriminuar në bazë të gjendjes sociale	127	121	46	5
Jam i (e) mendimit se në Kosovë qytetarët janë të diskriminuar në bazë të orientimit seksual	119	108	59	13
Mendoj se në Kosovë është i cënuar integriteti fizik dhe psiqik i qytetarëve	125	104	57	13
Kam informata se dikush ka qenë i torturuar dhe trajtuar në mënyrë çnjerëzore	83	89	63	64

Kam informata se dikush ka qenë i provuar nga liria në mënyrë të jashtëligjshëm	96	86	65	52
Jam i mendimit se në Kosovë nuk respektohet e drejta e privatësisë së jetës familjare dhe private	119	116	55	9
Jam i mendimit se në Kosovë nuk respektohet e drejta e privatësisë së komunikimit personal	119	118	19	13
Mendoj se në Kosovë është e cenuar e drejta e shprehjes së lirë	109	90	85	15
Kam informata se personave tjerë u është cenuar e drejta e pronësisë	100	91	61	44
Kam informata se të tjerëve u është cenuar e drejta e shkollimit	94	83	83	39
Jam i mendimit se në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në mënyrë adekuate janë të mbrojtura të gjitha liritë e qytetarit	174	98	19	8
Jam i mendimit se Kushtetuta e Republikës së Kosovës është në përputhje me të gjitha rregullativat ndërkombëtare në lëminë e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të qytetarit	188	89	12	10
Në rast të cënimit të drejtave të miya si qytetar e di se mundem për mbrojtje t'i drejtohem përfundimishtë edhe Gjykatës Kushtetuese	182	89	19	9
Jam i mendimit se po të ngris çështje për mbrojtjen e të drejtave të mia pranë Gjykatës Kushtetuese, e njëjta do të gjykojë në mënyrë të drejtë dhe të paanëshme	136	121	29	13
Kam besim në drejtëshmërinë e veprimit të Gjykatës Kushtetuese	130	128	27	14
Kam besim se Gjykata Kushtetuese nuk toleron shkeljen e të drejtave të qytetarit në	135	121	29	14

Republikën e Kosovës				
Jam i mendimit se institucionet e Republikës së Kosovës kanë kapacitet për të mbrojtur të drejtat e mia qytetare	149	110	28	12
Jam i mendimit se organet e rendit të Republikës së Kosovës kanë kapacitet për të mbrojtur të drejtat e mia qytetare	152	113	22	12
Jam i mendimit se sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës ka kapacitet për të mbrojtur të drejtat e mia qytetare	149	110	30	10
Jam i mendimit se pakicat në Kosovë i kanë të garantuara të gjitha të drejtat kolektive	184	82	19	14
Jam i mendimit se pakicat në Kosovë kanë të garantuara më shumë të drejta në krahasim me pakicat në vendet e rajonit	200	68	17	14

Intervistat e planifikuara dhe të realizuara;

1. Prof.Dr-Arsim Bajrami: Profesor Universitar, bashkëhartues i Kushtetutës së Kosovës.

2.Bekim Sejdiu-Ish gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, njëherit Profesor ne Universitetit Publik: “Hasan Prishtina” Prishtinë

3.Engelbert Krasniqi-Ministër i Administratës Publike dhe përfaqësues i minoritetit Egjiptian –Ashkali

4.Duda Bala-Deputete e Parlamentit të Kosovës njëherit përfaqësuese e minoriteti Boshnjak si dhe kryetare e komisionit për të Drejtat dhe liritë e njeriut.

5.Bojan Stamenkovic; Nënkyetar i Komunës së Kamenicës-përfaqësues i minoritetit Serb në Kosovë

6.Prof Dr.Ass.Gjylbehare Murati- Profesoreshë e rregullt në Universitetin “Haxhi Zeka”, në lëmin e të drejtës ndërkombëtare.

7.Avokati i Popullit –“Omduspersoni”

8.Përfaqësuesi KMDLNJ-së.

Intervista me Profesor Arsim Bajrami, koi profesori është përgjigjur si në vijim;

1. Meqë keni qenë një nga draftuesit e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, a mendoni se Kushtetuta është një dokument *modern* dhe i avancuar në fushën e mbrojtjeve dhe lirive të njeriut në raport me vendet e BE-s.

- *Sa i përket segmentit të mbrojtjes të lirive dhe të drejtave të njeriut, Kushtetuta e Republikës së Kosovës padyshim që është liderë rajonale. Pra është ndër Kushtetutat më të avancuara, do të thuaja edhe në Evropë jo vetëm në Ballkanin Perëndimor. Për faktin se ajo ka akceptu standardet me të larta sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut, duke akceptu gjitha konventat Evropiane për të drejtat e njeriut.*

2. Në mungesë të anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, a konsideroni se Gjykata Kushtetuese përben një mekanizëm i cili në mënyrë efektive i mbrojt të drejtat dhe liritë e njeriut, pasi këto vendime nuk mund të sfidohen në Gjykatën evropiane.

Fatkeqësisht, në mënyrë të pa drejtë Kosova nuk është shtete anëtare e Këshillit të Evropës, nuk është dhe anëtare e Bashkimit Evropian për shkak divergjencave të 5 shteteve.

3. Cilat veprime i konsideroni të nevojshme të ndërmerren nga institucionet përkatëse që secili organ gjyqësor dhe administrativ të jetë në zbatim të dispozitave kushtetuese në fushën e mbrojtjes së drejtave dhe lirive të njeriut?

Po, në fakt institucionet e Kosovës mund të bëjnë shumë në avancimin e standardeve, të afirmimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Por mes monitorimit që bëhet në nivel të Qeverisë, domethënë mes monitorimit që bën parlamenti përmes komisioneve parlamentare, mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve për lirinë e të drejtave të njeriut.

- *Sipas parimit të ndarjes së pushteteve shtetërore, pushteti gjyqësor është i pavarur nga dy pushtetet e tjera. Por qytetarët në shtetin tonë mendojnë se ai kontrollohet nga pushtetet e tjera qoftë ai legjislativ apo edhe ekzekutiv.*
- *Megjithatë, rreth 72.2% e qytetarëve kanë theksuar se publikimi i aktakuzave dhe i vendimeve nga gjykatat e ngrit besimin në sistemin e drejtësisë.*

Prandaj në këtë drejtim me Ligji nr. 06/L-091 për plotësimin ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës por që nga viti 2018 akoma nuk është

miratuar. Është paprapare publikimi i vendimeve gjyqësore nga gjykatat e secilit nivel të sistemeve gjyqësore.

4.A mendoni që Kosova përveç Avokatit të Popullit dhe OJQ-ve, duhet të ketë mekanizma tjerë institucional për mbrojtjen dhe lirinë e drejtave të njeriut?

- *Mendoj se spektri i institucioneve që duhet kujdesur për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë është mjaft i gjerë. Është avokati i popullit, shoqëria civile, mediat do të thoja dhe partitë politike nganjëherë kanë një rol pozitiv. Ne nuk kemi një ministri te veçantë sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut, por në një mënyrë kjo është një standard që vlen për gjitha institucionet tjera.*

5.Kuvendi i Kosovës a duhet të jetë më aktiv në identifikimin e shkeljeve eventuale te drejtave të njeriut dhe raportimin e tyre?

Kuvendi i Kosovës është organi kryesor që duhet t'i ngritë në Kosovë standardet. Pra, duhet të jetë institucioni kryesor që promovon dhe mbron standardet e lirive dhe të drejtave të njeriut, sepse e ka detyrim kushtetues. Për shkak se kuvendi i Kosovës është organ kushtetutës dhënës dhe organ që zbaton kushtetutën. Fatkeqësisht, nuk është në nivelin e duhur të trajtimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, sepse koncentrimi i Kuvendit është tek politikat tjera.

6.Çfarë rekomandoni të ndryshohet me qëllim të avancimit të zbatimit të Kushtetutës në raport me të drejtat e njeriut?

Po, mendojmë që ndoshta duhet në rastin e ndryshimeve kushtetuese kurdo që bëhet , sepse bëhen amendamente , me përcaktua përgjegjësinë politike të gjitha institucioneve që bëjnë shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Por në anën tjetër duhet me procesin e Vetingut i cili na pret me kërkua prej gjykatave që të tregojnë një performancë më të mirë. Veçmas sa i përket konteksteve që kanë të bëjnë me lirinë dhe të drejtat e njeriut, dhe t'i trajtojnë ato me prioritet .

Intervistën e plotë shihe në shtojcë

Intervistën e realizuar me Bekim Sejdiu-Ishgjiqtar i Gjykatës Kushtetuese, njëherit Profesor në Universiteti Publik: “Hasan Prishtina” Prishtinë. Është përgjigjur si në vijim:

1. Kosova ka inkorporuar standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Kushtetutë dhe legjislacion, cilat janë sfidat kryesore të implementimit të këtyre standardeve nga institucionet e Republikës së Kosovës?

Mbrojtja ligjore e të drejtave të njeriut ka tri dimensione. Së pari, duhet të ketë një kornizë ligjore adekuate, duke përfshirë Kushtetutën, ligjet përkatëse dhe për rëndësimin në rendin juridik kombëtar të instrumenteve përkatëse ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Pastaj duhet të ketë mekanizma efikas për zbatimin e kësaj kornize ligjore, duke përfshirë gjykata, institucionet e administratës dhe institucionet tjera ligj zbatuese. Institucionet efikase nënkupton në radhë të parë profesionist që kuptojnë konceptin e të drejtave të njeriut. Së treti, mbrojtja e të drejtave të njeriut m varet edhe nga niveli i emancipimit shoqëror. Në këtë kuptimin e fundit, të drejtat e njeriut janë barometër civilizues. Pra, tregojnë nivelin e qytetërimit të një shoqërie.

2. Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, janë inkorporuar drejtpërdrejtë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me çka përbën një rast të veçantë. A mendoni se Kosova e meriton të pranohet si anëtar i barabartë në Këshillin e Evropës?

Një prej padrejtësive të mëdha që i bëhet Kosovës dhe qytetarëve të saj është mos pranimi ende në Këshillin e Evropës. Kur jemi këtu, duhet potencuar se Kosova është rast unik në këtë aspekt, sepse në mënyrë të njëanshme ka përfshirë dhe zbaton Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, së bashku edhe me instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 22 i Kushtetutës). Kushtetuta e Republikës së Kosovës po ashtu në nenin 53 përcakton detyrimin që të drejtat e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë të interpretohen në përputhje me praktikën e GJEDNJ. Në këtë kuadër, e themi më bindje se Republika e Kosovës është para shumë vendeve anëtare të Këshillit të Evropës për sa i përket aplikimit të standardeve të të drejtave të njeriut të përcaktuara nga KEDNJ.

3. Pranimi i Kosovës në Këshillin e Evropës do të mundësonte që rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut, qytetarët e Kosovës t'i referonin në Gjykatën Evropiane të të drejtave të njeriut në Strasburg. Si do të mund të përballej shteti i Kosovës me këto raste?

Kjo, në shumicën e rasteve, do ketë implikime financiare sepse në praktikën e GJENDJ zhdëmtimi në masë të madhe është në formë të kompensimit monetar. Por, kjo do i disiplinonte, në kuptimin metaforik të fjalës, institucionet e Kosovës – sidomos gjykatat. Ato do detyroheshin që të jenë me efikase dhe profesionale. Kjo do të avanconte sistemin e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve. Sidomos një aspekt i punës së sistemit gjyqësor ku Kosova çalon është tej zgjatja e procedurave gjyqësore.

4. Cili është roli i Gjykatës Kushtetuese në zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut në Kosovë?

Sa i përket kësaj pyetje ish gjyqtari është përgjigjur si se: Në këtë drejtim, edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka rol të pazëvendësueshëm në garantimin se gjykatat e rregullta, sikundër edhe të gjitha institucionet tjera publike në Republikës së Kosovës zbatojnë me konsistencë gradacionet kushtetuese të të drejtave të njeriut. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese ka rolin e një transmetuesi të standardeve të GJEDNJ, në jurisprudencën e Kosovës.

5. Të drejtat e njeriut janë kategori universale. A mendoni se institucionet e Republikës së Kosovës kanë bërë mjaftueshëm në respektimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut?

Gjithmonë ka vend për përmirësime dhe avancime të të drejtave të njeriut nga autoritetet shtetërore. Mund të bëhen hapa legjislativ, siç është, ta zëmë, zgjerimi i mandatit të Avokatit të Popullit, apo krijimi i mekanizmave të veçantë për luftimin e diskriminimit etj. Po ashtu, institucionet shtetërore mund të bëjnë më shumë në promovimin e të drejtave të njeriut- aspektin preventive të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, unë mendoj se Republika e Kosovës ka bërë hapa gjigand drejt mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

6. Çfarë rekomandoni të ndryshohet apo të plotësohet?

Mendoj se duhet të fokusohemi më tepër në ngritjen e kapaciteteve profesionale përkitazi me konceptin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e tyre gjyqësore. Nuk duhet harruar se

koncepti i të drejtave është dinamik dhe, si tillë, kërkon avancim të vazhdueshëm të njohurive profesionale.... .Intervista e plotë ne shtojcë.

Intervistë e realizuar me zonjën Duda Bala-Deputete e Kuvendit - komuniteti Boshnjak. Përndryshe dhe Kryetare e Komisionit për të Drejta të Njeriut, e cila na është përgjigjur si në vijim:

1. Republika e Kosovës ka shpallur Pavarësinë më 17 shkurt 2008 në përputhje me Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës – Pakoja e Ahtisaarit. Pakoja është inkorporuar në Kushtetutën e Kosovës. A mendoni se Kushtetuta e Kosovës i përmbush standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në lidhje me komunitetet jo shumicë?

Po, mendoj se Kushtetuta e Kosovës është mbrojtëse e pakicave, me Ahtisaarin kemi ulëse të rezervuara dhe jemi të motivuar pozitivisht në raport me komunitetin shumicë. Një nga momentet që e bën Kushtetutën tonë veçanërisht unike në raport me kushtetutat në shtetet rajonale.

2. A respektohen të drejtat e komuniteteve në Republikën e Kosovës?

Sipas Kushtetutës, në Kosovë kemi shqiptarë, serbë dhe komunitete të tjera. Sipas Ahtisarit, kanë mbetur boshnjakë, turq, romë, ashkali, egjiptianë dhe goranë. Ne punojmë shumë për respektimin e të drejtave tona, veçanërisht në fushën e arsimit dhe të drejtës për arsimim, kemi vështirësi që dalin, por besoj se të drejtat tona respektohen në masë të madhe.

3. A mendoni se respektohet kuota e përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në institucionet e Republikës së Kosovës?

Pjesërisht, ne i përgatisim të rinjtë tanë në baza ditore për të qenë konkurrues në tregun e punës në mënyrë që të plotësojnë kushtet dhe të arrijnë më lehtë në vendet e përcaktuara për ne.

4. A u mundësohet komuniteteve Jo shumicë në Kosovë, shkollimi në gjuhën e tyre amtare?

Si në të gjitha komunat ku popullata jonë kalon kuotën prej 5% në gjuhën boshnjake, kemi paralele në Prizren, Pejë, Dragash dhe disa shkolla në Prishtinë

5. A janë raportuar raste të diskriminimit në punësim në institucionet e Republikës së Kosovës për shkak të përkatësisë etnike? Nëse po, a janë adresuar këto raste për zgjidhje?

Në rastet kur ka shkelje të të drejtave tona ne reagojmë, konkretisht në një numër të madh rastesh kanë efekt pozitiv.

6. Ju si kryesuese e komisionit për të drejtat e njeriut, a keni hasur në ndonjë rast që institucionet kanë hezituuar, që rekomandimet e juaja që të mos zbatohen apo amandamentohen?

Marrëdhënia ndërmjet komisionit dhe institucioneve është shumë e mirë, të gjitha mesazhet që dërgojmë në konsultim me Avokatin e Popullit, në shumicën e rasteve respektohen dhe zbatohen.

7. Çka kishit ndryshuar në Kosovë në lidhje me respektimin e të drejtave të komuniteteve Jo shumicë?

Transparencë më e madhe në gjithçka që ndodh në fushën e të drejtave të minoriteteve, si ato pozitive ashtu edhe ato negative. Mendoj se kemi shumë për të qenë krenarë, ka gjithashtu diçka për të cilën duhet të punojmë ende. Do të filloja me arsimin....Intervista e plotë ne Shtojcë.

Intervistën e realizuar me Avokati i Popullit –“Omduspersoni ”është përgjigjur, dhe njëherit kanë dorëzuar raport vjetor si në vijim:

1. A mendoni se institucionet e Kosovës kanë bërë mjaftueshëm për respektimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut? E themi standardeve ndërkombëtare pasi që të drejtat e njeriut janë kategori universale dhe Kosova i ka inkorporuar instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejtë në Kushtetutë dhe legjislacionin pozitiv?

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut është obligim i çdo shteti. Ato duhet t’iu përmbahen marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe t’i ratifikojnë dhe t’i zbatojnë ato.

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës shprehimisht garantohet zbatimi i drejtpërdrejtë i instrumenteve ndërkombëtare.

2. A ka Kosova mekanizma institucional të mjaftueshme që merrem me monitorimin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut?

Republika e Kosovës, në mënyrë që të monitorojë zbatimin e garancive për të drejtat e njeriut të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ka krijuar disa mekanizma të cilët janë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Disa nga institucionet kryesore janë: Kuvendi i Republikës së Kosovës; Institucioni i Avokatit të Popullit, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Agjencia për Barazi Gjinore.

3. Në raportet e juaja hulumtuese, a keni gjetur raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut nga institucionet e Kosovës? Nëse po, a i keni adresuar këto raste të organet përgjegjëse? A janë evituar shkeljet e tilla të raportuara?

- *Përmes Letër Rekomandimeve dhe Raporteve Ex. Officio (me vetë-iniciativë) të cilat i adreson drejtpërdrejte tek institucionet përgjegjëse*
- *Përmes Raportit Vjetor, i cili i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe paraqet situatën e përgjithshme me të drejtat e njeriut në vend nga prizmi i punës së Avokatit të Popullit.*
- *Këto raporte janë publike në ueb faqen e Institucionit të Avokatit Popullit: www.oik-rks.org*

4. A e penalizon procesin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë, mos anëtarësimi në Këshillin e Evropës?

Mos-anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës paraqet një hendek të madh në procesin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Kosova edhe pse e ka përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Kushtetutë, qytetarët e saj nuk mund t'i drejtohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nëse konsiderojnë se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre nga shteti i Kosovës, apo cilido shtet anëtar i Këshillit të Evropës.

5. Cilat janë sfidat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga institucionet e Kosovës?

Një ndër sfidat që po na përcjell kohëve të fundit është mos nxjerrja e akteve nënligjore që po e pamundëson zbatimin e rregullt të ligjit nga ana e institucioneve të vendit të cilat ndikojnë në të drejtat e qytetarëve. Sfidë tjetër mbetet mungesa e vet kontrollit brenda

institucioneve për të luftuar dukuritë negative në këtë rast vet trajtimin të qytetarëve nga ana e institucioneve kur ata paraqesin ndonjë kërkesë për të realizuar ndonjë të drejtë.

6.Çfarë rekomandoni të ndryshohet?

Duhet të ketë një kontroll më të shtuar parlamentar sa i përket zbatimit të ligjeve ndërsa qeveria duhet të nxjerr në mënyrë më të shpejtë aktet nënligjore. Proceset e ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve duhet të jenë të atilla që mos të lejojnë ndërhyrje nga grupet e interesit por të punohet që ligjet të jene të zbatueshme në praktikë.....Shif shtojcën.

Intervistën e realizuar me Ministrin e Administratës Publike, njëherit përfaqësues i minoritetit Ashkali dhe Egjyptas z. Elbert Krasniqi është përgjigjur si në vijim:

1. Republika e Kosovës ka shpallur Pavarësinë më 17 shkurt 2008 në përputhje me Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës – Pakoja e Ahtisaarit. Pakoja është inkorporuar në Kushtetutën e Kosovës. A mendoni se Kushtetuta e Kosovës i përmbush standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në lidhje me komunitetet jo shumicë?

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është paraparë që instrumente/konventa të ndryshme ndërkombëtare që kryesisht ndërlidhen me të drejtat e njeriut, zbatohen drejtpërsëdrejti edhe në Republikën e Kosovës. Prandaj, nëse mund të ketë zbrazëti eventuale në çështjet që ndërlidhen me komunitetet jo-shumicë, të njëjtat mbulohen nga këto instrumente.

2. A respektohen të drejtat e komuniteteve në Republikën e Kosovës?

Mendoj që ende ka shumë hapësirë për përmirësim dhe angazhim. Problemet me të cilat ballafaqohen komunitet jo – shumicë në Republikën e Kosovës janë shumë specifike, por në të njëjtën kohë ka edhe probleme të përbashkëta me komunitetin pakicë, siç është çështja e punësimit.

3. A mendoni se respektohet kuota e përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në institucionet e Republikës së Kosovës?

Në përgjithësi mendoj se respektohet, por duhet kujdes i shtuar që të përfshihen sa më shumë përfaqësues nga komunitetet e ndryshme pakicë. Sidoqoftë, për këtë çështje, është më mirë të merren informacionet dhe statistikat zyrtare nga institucionet kompetente.

4. A stimulohen në kuptimin financiar përmes projekteve të ndryshme komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian?

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në një rën ndër thirrjet e saj për mbështetje financiare të Komunave, në programin për zhvillim socio-ekonomik ka bërë thirrje për mbështetje të investimeve që përmirësojnë kushtet sociale dhe ekonomike të pjesëve në të cilat banojnë komunitet pakicë. Disa Komuna kanë aplikuar dhe kanë përfituar nga ky program, i cili qëllim kryesor ka pasur përkrahjen e këtij komuniteti. Sigurisht që ne jemi duke punuar edhe aktualisht në këtë drejtim.

5. A janë raportuar raste të diskriminimit në punësim në institucionet e Republikës së Kosovës për shkak të përkatësisë etnike? Nëse po a janë adresuar këto raste për zgjidhje?

Në periudhën në të cilën unë jam Ministër në krye të këtij institucioni, nuk ka pasur raportime të tilla zyrtare.

6. Çka kishit ndryshuar në Kosovë në lidhje me respektimin e të drejtave të komuniteteve Jo shumicë?

Janë disa çështje veçanërisht të rëndësishme të cilat Ministri dhe Ministria I adreson në kuptim të avancimit të rolit të komuniteteve jo-shumicë, e që si një ndër më primaret është përfshirja në edukim. Duke filluar që nga edukimi I hershëm (kopshte) dhe po ashtu shkollimit të vajzave e grave të këtij komuniteti. Duhet më shumë mbikëqyrje e këtij fenomeni dhe ngritje të vetëdijesimit në raport me këtë çështje.

Për më shumë- shih intervistën e plotë në shtojcë

Sa i përket minoriteti Serb ,ne kemi kontaktuar disa përfaqësues të Listës Serbska, ku kanë hezituuar që të përgjigjën. I vetmi që i është përgjigjur kërkesës sime për intervistim ishte; Nënkrjetari i komunës së Kamenicës Zot. Bojan Stamenkoviç.

Intervistën e plotë në të dy gjuhët e gjeni në shtojcë.

Në intervista të planifikuara është realizuar edhe intervista me **Prof. Ass. Dr. Gjylbehare Murati, profesoreshë pranë Universitetit Publik “Haxhi Zeka” në Pejë në lëmin e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane .**

Fokusimi i pyetjeve në këtë intervistë kishte të bënte me të drejtat e pakicave, se si i sheh ajo nga këndvështrimi, si profesoreshë e të Drejtës Evropiane dhe Ndërkombëtare. Sa respektohen ato të drejta duke u bazuar në konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në praktikë.

Intervistën e plotë e gjeni në shtojcë.

Po ashtu është realizuar edhe intervista me përfaqësuesit e KMDLNJ-s.

Ndër pyetje të cilat janë parashtruar këtij institucioni, i cili është i thirrur për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut, kane theksuar se :

Ekzistojnë ligjet të avancuara sa I përket të drejtave të njeriut, por sfidë e shëtit duhet të jetë kthimi I besimit te qytetaret. Jo vetëm në rastet është nemite ndonjë dite të veçantë ose në raste të ndonjë ndodhie të merren me mbrojtjen e të drejtave, por të jetë në kontinuitet.

Intervistën e plotë e gjeni në Shtojcë

Duke analizuar literaturën, legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar si dhe në bazë të pyetjeve kërkimore dhe intervistave të realizuar, kemi arritur në përfundim se Hipotezat e ngritura në këtë punim diplome janë vërtetuar si në vijim:

Në hipotezën e parë të ngritur se: Institucionet publike në Republikën e Kosovës janë të përkushtuara gjerësisht në Mbrojtjen e Lirive Themelore të Njeriut.

Duke Analizuar legjislacionin në fuqi Kosova është liderë ne Ballkan, por në bazë të anketës dhe intervistave duhej ta koma vetëdijesim institucional dhe zbatime efikas në praktikë.

Në hipotezën e dytë e cila e vërteton se: Akti më i lartë juridik i ngërthen standardet ndërkombëtare në fushën e problematikës në fjalë.

Po, kushtetuta e RKS-së i ka të inkorporuar të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, po ashtu edhe pakon e Ahtisaarit.

Hipoteza e tretë në lidhje me Gjykatën Kushtetuese e Republikës së Kosovës, se a ndjek dhe ndërmerr aktivitete, gjegjësisht në raste të shkeljeve eventuale të drejtave dhe lirive të njeriut.

Duke u bazuar në analizën e bërë përmes të anketuarve dhe të intervistuarve, ka një ngecje të vogël, pasi që individët hezitojnë të ushtrojnë të drejtën e vetë Kushtetuese. Kështu që duhet një sensibilizim më i madhe të k popullata që të fitojnë besimin në këtë institucion vital të shtetit.

Shteti ligjor në Republikën e Kosovës, është në shërbim të njeriut dhe mbrojtjes së lirive individuale në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e vendit.

Në hipotezën e katërt është vërtetuar se:

Ekzistojnë ligjet të avancuara sa i përket të drejtave të njeriut, por sfida e shtetit duhet të jetë kthimi i besimit të qytetarit. Jo vetëm në raste të shënimit ndonjë dite të veçantë ose në raste të ndonjë ndodhie të merren me mbrojtjen e të drejtave, por të jetë në kontinuitet .

Kurse tek Hipoteza e pestë e cila ngritë dilemën se shteti ynë, Republika e Kosovës avancoon në kontekst të garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave edhe lirive të pakicave kombëtare, krahasuar me vendet e rajonit!

Duke analizuar intervistat e të intervistuarve dhe në bazë të analizave të bëra me shtetet në rajon, e sidomos në Ballkanin Perëndimor, Kosova është liderë në rajon. Ka sfiduar dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Pakicave sepse kushtetuta jonë ka promovua parimin e diskriminimit pozitiv cili parasheh të drejtat e papara për komunitetet pakicë që nuk i ka asnjë kushtetutë Evropiane.

Përfundime dhe Rekomandime

Të drejtat e njeriut vazhdojnë të jenë top tema e diskutimeve në qarqe të ndryshme, qoftë akademike, e sidomos brenda organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare. Sot në botë më shumë se për çdo çështje tjetër, ekzistojnë mekanizma ndërkombëtar që merren me trajtimin dhe mbikëqyrjen e të drejtave të njeriut. Rëndësia e të drejtave të njeriut në shekullin tonë, paraqet esencën e funksionimit të çdo shteti demokratik.

Respektimi i akteve themelore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, paraqitet si domosdoshmëri për secilin shtet. Me të drejtë thekson edhe Marek Piechowiak kur thotë: “u bë një kategori e zakonshme në mosmarrëveshje të ndryshme, jo vetëm në fushën e së drejtës, por edhe në politikë, moral dhe fe. Koncepti modern i të drejtave të njeriut është i rrënjësor në përvojat e “paligjshmërisë juridike” kur krimet kryheshin me autorizimin e ligjit dhe kur disa qenieve njerëzore u mohoj statusi i tillë. Si përgjigje ndaj këtyre përvojave ishte shfaqja e të Drejtës Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut. Koncepti i të drejtave të njeriut i cili u pranua atëherë tani siguron paradigmen për kuptimin e të drejtave të njeriut, jo vetëm në të drejtën ndërkombëtare por edhe në fusha të tjera të kulturës” (Piechowiak M. , 1999, p. 3).

Përjetimi i dy luftërave botërore për më pak se gjysmë shekulli, bëri që akademikët e kohës dhe udhëheqësit shtetëror, të trajtojnë seriozisht gjendjen e krijuar. Që të krijohet një qasje ndryshe ku njerëzimi të mos përjetoj një tmerr të papërshkrueshëm, çfarë ishte lufta e Parë dhe lufta e Dytë botërore. Në këtë drejtim, “të çmuarit e vlerës unike të çdo qenieje njerëzore nga ana e bashkësisë ndërkombëtare çoi jo vetëm kah përpjekjet për eliminimin e elementeve destruktive për individin, por edhe kah ato për krijimin e kushteve të cilat do t'i mundësonin atij ose asaj që të zhvillohet dhe përparojë” (Piechowiak M. , 1999, p. 4). Veç tjerash, duhet kuptuar qartësisht që “secili prej aspekteve të ndryshme të njeriut (fizik, psikologjik, moral, shpirtëror, shoqëror, etj.) meriton vëmendje. Zhvillimi individual kërkon kushte të duhura shoqërore, politike, ekonomike, kulturore dhe ekologjike” (Piechowiak M. , 1999, p. 10).

Bazuar në kërkimet dhe hulumtimet e bëra, dhe në trajtimin e këtij punimi, logjikisht rrjedhin disa përfundime:

- ☒ Bota demokratike që nga përfundimi i luftës së dytë botërore ka ndërtuar institucione të shumta dhe të ndryshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Që nga deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut e deri më sot, janë miratuar me dhjetëra akte me

karakter ndërkombëtar dhe regjional në gjithë botën, ku promovohen dhe mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të promovuar që nga Deklarata e Përgjithshme.

- ☐ Impakti i të drejtave të njeriut sot, gjënë shtrirje të jashtëzakonshme në të gjitha fushat e jetës politike dhe institucionale, ku përveç trajtimit institucional ndërkombëtarë dhe shtetëror, me qindra organizata qeveritare dhe jo-qeveritare vazhdojnë të merren intensivisht me të drejtat dhe liritë e njeriut.
- ☐ Shtetet demokratike, si dhe shtetet që aspirojnë zhvillimin e demokracisë, kanë ndërtuar institucione të posaçme për të drejtat e njeriut. Thënë specifikisht, zhvillimi i të drejtave të njeriut sot në botë merret si matës i zhvillimit të demokracisë në vendet përkatëse.
- ☐ Krahasuar me vendet fqinje dhe vendet e tjera të rajonit, Republika e Kosovës ka avancuar jashtëzakonisht shumë sa i përket legjislacionit të të drejtave të njeriut, dhe respektimit të standardeve ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
- ☐ Kushtetuta e Republikës së Kosovës është baza themelore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Duke pasur parasysh që Republika e Kosova nuk mund të bëhet zyrtarisht palë në konventat dhe mekanizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, me Kushtetutë është përcaktuar që tetë instrumente të drejtave të njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe rajonale zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë, duke ofruar kështu burime plotësuese ligjore që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e njeriut në Kosovë.
- ☐ Deri më tani, Republika e Kosovës ka miratuar një gamë të gjerë të legjislacionit sa i përket të drejtave të njeriut, dhe po ashtu, ka themeluar edhe institucione të veçanta që merren me mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e realizimit të të drejtave të njeriut, siç është Avokati i Popullit.
- ☐ Zbatimi i legjislacionit kërkon vëmendje të shtuar domosdoshmërisht t, në këtë kuptim përkundër legjislacionit mjaft të avancuar, zbatimi i tij vazhdon të mbetet sfidë për institucionet e shtetit të Kosovës.

Rekomandime:

- Republika e Kosovës, gjegjësisht, institucionet publike duhet të rrisin përgjegjësinë kundrejt detyrave që kanë, në mënyrë që të krijohet efikasitet në sistemin e shërbimeve publike ndaj qytetarëve që jetojnë në Kosovë.
- Ngritja e nivelit të demokracisë dhe sundimit të ligjit duhet të jenë prioritet dhe përkushtim i secilës qeverisje në të ardhmen. Të drejtat e njeriut nuk mund të realizohen pa ofrimin e një qeverisje pa korrupsion dhe pa keqpërdorime të pushtetit. Krijimi i legjislacionit pavarësisht që është jashtëzakonisht i mirë, zbatimi i tij ende ka probleme serioze në Republikën e Kosovës.
- Rritja e vetëdijes shoqërore për të reaguar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre mbetet tejet e rëndësishme në realizimin e të drejtave të qytetarëve. Natyrisht, në këtë drejtim edhe bashkëpunimi me institucionet gjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Fuqizimi i pavarësisë dhe paanësisë së sistemit gjyqësor, dhe largimi i ndikimit politikë në proceset gjyqësore, vazhdon të mbetet ndër sfidat kryesore në realizimin e të drejtave dhe posaçërisht parandalimin e rasteve të korrupsionit.
- Liria e medias duhet të jetë në fokusin kryesor. Mosndërhyrja në lirinë e medias vazhdon të jetë temë kryesore në të gjitha raportet e jashtme, andaj, në këtë drejtim duhet shtuar kujdes i veçantë për krijimin e mediave të pavarura dhe të paanshëm.

Conclusions and Recommendations

Human rights continue to be a top topic of discussion in various circles, whether academic, and especially within international organizations and institutions. In the world today, there are more international mechanisms dealing with the treatment and oversight of human rights than any other issue. The importance of human rights in our century, represents the essence of the functioning of any democratic state.

Respect for basic international human rights instruments is a necessity for every country. Marek Piechowiak rightly points out when he says: “it became a common category in various disputes, not only in the field of law, but also in politics, morality and religion. The modern concept of human rights is rooted in the experiences of "legal illegality" when crimes were committed with the authorization of the law and when some human beings were denied such status. In response to these experiences was the emergence of International Human Rights Law. The concept of human rights which was then accepted now provides the paradigm for the understanding of human rights, not only in international law but also in other areas of culture ”(Piechowiak M., 1999, p. 3).

Experiencing two world wars for less than half a century, made the academics of the time and state leaders, take the created situation seriously. To create a different approach where humanity does not experience an indescribable horror, such as, First World War and the Second World War. In this regard, “the appreciation of the unique value of every human life by the international community led not only to the efforts to eliminate the destructive elements for the individual, but also creating the conditions that would enable him or her to develop and progress ”(Piechowiak M., 1999, p. 4). Among other things, it must be clearly understood that “each of the various aspects of the human (physical, psychological, moral, spiritual and social, etc.) deserves attention. Individual development requires appropriate social, political, economic, cultural and ecological conditions” (Piechowiak M., 1999, p. 10).

Based on the research done, and in the treatment of this paper, logically several conclusions are drawn:

. The democratic world since the end of the Second World War has built numerous and different institutions for the protection of human rights. Since the Universal Declaration of Human Rights to date dozens of acts of international and regionally have been adopted

around the world, promoting and protecting the fundamental human rights and freedoms promoted since the Universal Declaration.

. The impact of human rights today, finds tremendous reach in all areas of political and institutional life, where in addition to international and state institutional treatment, hundreds of governmental and non-governmental organizations continue to deal intensively with human rights and freedom.

. Democratic states, as well as states aspiring to the development of democracy, have built special institutions for human rights. Specifically, the development of human rights in the world today is taken as a measure of the development of democracy in the respective countries.

. Compared to neighboring countries and other countries in the region, the Republic of Kosovo has advanced tremendously in terms of human rights legislation, and compliance with international standards of fundamental human rights and freedoms.

. The Constitution of the Republic of Kosovo is the basic basis for the protection of fundamental human rights and freedoms. Given that the Republic of Kosovo cannot formally become a party to international human rights conventions and mechanisms, the Constitution stipulates that eight United Nations and regional human rights instruments are directly applicable in Kosovo, providing thus complementary legal resources that protect and promote human rights in Kosovo.

. So far, the Republic of Kosovo has adopted a wide range of legislation regarding human rights, and has also established special institutions dealing with the protection and supervision of the realization of human rights, such as The People's Advocate.

. The implementation of legislation requires increased attention, in this sense, despite the highly advanced legislation; its implementation continues to be a challenge for the institutions of the state of Kosovo.

Recommendations

- The Republic of Kosovo, respectively, public institutions should increase the responsibility towards their duties, in order to create efficiency in the system of public services provided to the citizens living in Kosovo.
- Raising the level of democracy and the rule of law should be a priority and commitment of every government in the future. Human rights cannot be realized without providing governance without corruption and without abuse of power. The creation of legislation, despite being extremely good, its implementation still has serious problems in the Republic of Kosovo.
- Increasing social awareness to react to violations of their rights remains extremely important in the realization of citizens' rights. In this regard, the cooperation with relevant institutions for the protection of human rights is necessary.
- Strengthening the independence and impartiality of the judiciary, and removing political influence in the judicial process, continues to be one of the main challenges in exercising rights and especially preventing corruption cases.
- Media freedom should be the main focus. Non-interference in the freedom of the media continues to be a major topic in all external reports, therefore, in this regard, special care should be taken to create an independent and impartial media.

Shtojcë:

Intervistë e realizuar me Prof. Arsim Bajrami ;Bashkë hartues i Kushtetutës se Kosovës.

- 1. Meqë keni qenë një nga draftuesit e Kushtetutës së Republikës se Kosovës, a mendoni se Kushtetuta është një dokument *modern* dhe i avancuar në fushën e mbrojtjeve dhe lirive të njeriut në raport me vendet e BE-s ?**

Sa i përket segmentit të mbrojtjes të lirive dhe të drejtave të njeriut, Kushtetuta e Republikës së Kosovës padyshim që është liderë rajonale. Pra është ndër Kushtetutat më të avancuara, do të thuhet edhe në Evropë jo vetëm në Ballkanin Perëndimor. Por faktin se ajo ka akceptuar standardet më të larta sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut, duke akceptuar gjitha konventat Evropiane për të drejtat e njeriut, plotësisht i ka implementuar parimin e mos diskriminimit dhe parimin e barazisë së plotë para ligjit. Ka implementuar të gjitha liritë dhe të drejtat e njeriut duke filluar nga: Liritë personale, Liritë politike, Liritë sociale, Liritë ekonomike. Në mënyrë të veçantë Kushtetuta jonë ka përcaktuar një standard mbi kushtetues sa i përket lirive dhe të drejtave të komuniteteve pakicë. Kështu dhe në këtë segment ne kemi sfiduar dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Pakicave, sepse kushtetuta jonë ka promovuar parimin e diskriminimit pozitiv i cili parasheh , te drejtat e papara për komunitetet pakicë që nuk i ka asnjë kushtetutë Evropiane. Të drejta këto që praktikisht kanë qenë edhe pjesë e negociatave për Pavarësinë e Kosovës, por të cilat fatkeqësisht , këto të drejta sistematikisht janë keqpërdorur nga ana e komunitetit Serb. Sepse ato nuk po përdoren siç është rasti në Maqedoni me shumicën e dyfishtë shqiptare apo me shumicën e Badienterit, ku shqiptarët nuk kanë arritur t'i shfrytëzojnë të gjitha të drejtat që i parasheh Marrëveshja e Ohrit. Këtu serbët i kanë keqpërdorur në konsistencë të drejtat e parapara me kushtetutë për të bllokuar shtetin, për të bllokuar vendimmarrjen. Sepse nuk po i përdorin këta mekanizëm për të mbrojtur identitetin e vet, por i kanë shndërruar në mekanizma bllokimi të shtetit të Kosovës. Kështu që, dhe njëherë po përfundoj përgjigjen në këtë pyetje, sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut, e sidomos lirive dhe drejtave të pakicave. Kushtetuta e Kosovës është kushtetuta më e avancuar në Evropë, dhe mund të shërbejë si model edhe për vendet e tjera të rajonit. Sidomos për Serbinë ku shkelën në mënyrë sistematike të Drejtat e Shqiptarëve, për

Maqedoninë ku Shqiptarët akoma nuk janë komb shtet formues. Por edhe vendet e tjera shumë etnike ku ka shkelje të drejtave të komuniteteve jo shumicë.

2.Në mungesë të anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, a konsideroni se Gjykata Kushtetuese përbën një mekanizëm i cili në mënyrë efikase i mbron të drejtat dhe liritë e njeriut, pasi këto vendime nuk mund të sfidohen në Gjykatën evropiane ?

Fatkeqësisht, në mënyrë të padrejtë Kosova nuk është shtet anëtare e Këshillit të Evropës. Nuk është dhe anëtare e Bashkimit Evropian për shkak divergjencave të 5 shteteve. Por në mënyrë të veçantë anëtarësimi në Këshill të Evropës, Kosovës i kishte dhënë qasje edhe tek Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut. Në këtë situatë akoma nuk e ka subjektivitetin ndërkombëtar, për t'ju drejtuar drejtpërdrejt gjykatës evropiane në mënyrë të veçantë qytetarët e saj, ku ju shkelën të drejtat e parapara në konventë. Dhe si adresë të vetme nacionale, kombëtare mbetet Gjykata Kushtetuese. E cila është garant dhe interpretues final i kushtetutës dhe ku qytetarët mund të drejtohen për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese. Pra, mbrohen vetëm të drejtat që përcakton kushtetuta. Ku ka pasur disa raste, po fatkeqësisht jo sa duhet nuk e kemi akoma atë. Një kulturë të avancuar që të adresohen sa më shumë raste tek gjykata kushtetuese përveç nismave. Në mënyrë të veçantë shfrytëzohet autoriteti i avokatit të popullit, i cili ka të drejtë të nisë një procedurë direkt tek Gjykata kushtetuese, sa herë që qytetarët kërkojnë mbrojtje juridike. Por fatkeqësisht adresimi tek Gjykata kushtetuese mund të bëhet vetëm pasi të bëhet ezaurimi i të gjitha mjeteve juridike në procedura. Dhe gjithnjë duke pasur parasysh ngecjen e gjykatave tona, shpesh herë qytetarët deprimohen apo nuk kanë një vullnet për të shkuar në Gjykatë kushtetuese. Sepse me vite nuk mund të realizohet një të drejtë, pra në sistemin e gjykatave të rregullta.

3. Cilat veprime i konsideroni të nevojshme të ndërmerren nga institucionet përkatëse, që secili organ gjyqësor dhe administrativ të jetë në zbatim të dispozitave kushtetuese në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut?

Po, në fakt institucionet e Kosovës mund të bëjnë shumë në avancimin e standardeve, të afirmimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Por mes monitorimit që bëhet në nivel të qeverisë, domethënë mes monitorimit që bënë parlamenti përmes komisioneve parlamentare, mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve për lirinë e të drejtave të njeriut. Në mënyrë të veçantë këtu një rol pro aktiv duhet ta ketë avokati i popullit, i cili për çdo vjet del me raporte vjetore. Ku përpos përshkrimit të gjendjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, njëkohësisht konstaton edhe shkeljet edhe institucionet e niveleve se ku po shkelen. Fatkeqësisht këto rekomandime të avokatit të popullit jo rrallë nuk zbatohen. Domethënë Avokati i popullit jep pasqyrën e shkeljes në çdo sferë të lirive dhe të drejtave të njeriut. Pasi që ky raport diskutohet dhe miratohet vetëm një herë në vjet në Kuvend , do të ishte mirë që pas miratimit të këtij raporti, qeveria dhe parlamenti të bëjnë gjithë presionin e mundshëm që të zbatohen konkluzionet, sa i përket shkeljes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Zakonisht, një shkelës me i madh i lirive dhe të drejtave të njeriut mbetet administrata publike, ku qytetarët presin, abuzojnë. Pastaj institucionet e pushtetit lokal, sistemit gjyqësor. Pra, janë gjithmonë adresa ku konstatohet shkelja e lirive dhe të drejtave të njeriut.

4. A mendoni që Kosova përveç Avokatit të Popullit dhe OJQ-ve, duhet të ketë mekanizma tjerë institucional për mbrojtjen dhe lirinë e drejtave të njeriut?

Mendoj se spektri i institucioneve që duhet kujdesur për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë, është mjaft i gjerë. Janë avokati i popullit, shoqëria civile, mediat. Do të thoja dhe partitë politike nganjëherë kanë një rol pozitiv. Ne nuk kemi një ministri të veçantë sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut, por në një mënyrë kjo është një standard që vlen për gjitha institucionet tjera. Ndoshta do të ishte mirë, tek reformat e sistemit gjyqësor të instalohen pranë gjykatës supreme, gjykatave themelore dhe gjykatave të panelit të veçanta. Që me prioritet diskutojnë lëndët që kanë të bëjnë me shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut .Pra jo se pritjet 5-6 vjet adresimi i një shkeljeje, por në një mënyrë të ketë një panel i

veçantë, që i merr vetëm këto lëndë dhe që praktikisht të zgjidh lëndë më shpejt. Dukë përfshirë dhe të drejtën e lëshimit të masave të përkohshme apo edhe dënimeve. Pastaj shtimi i nivelit të mbikëqyrjes përmes inspektorateve, të gjitha ministrive. Gjykata kushtetuese në një mënyrë, komisioni për të drejtat e njeriut i Kuvendit të Kosovës, janë një varg institucionesh që duhet të bashkëveprojnë, në mënyrë të harmonizuar. Qe secila ta luaj rolin e vetë për sa i përket mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut .

5.Kuvendi i Kosovës a duhet të jetë më aktiv në identifikimin e shkeljeve eventuale të drejtave të njeriut dhe raportimin e tyre?

Kuvendi i Kosovës është organi kryesor që duhet të ngritë në Kosovë standardet. Pra, duhet të jetë institucioni kryesor që promovon dhe mbron standardet e lirive dhe të drejtave të njeriut. Sepse e ka detyrim kushtetues për shkak se Kuvendi i Kosovës është organ kushtetutdhënës dhe organ që zbaton kushtetutën. Fatkeqësisht, nuk është në nivelin e duhur të trajtimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Sepse koncentrimi i Kuvendit është tek politikat tjera, të agjendat politike, agjendat politike ditore. Dhe ndoshta dhe vonesat në procesin e integritimit Evropian vinë edhe si pasojë e trajtimit të duhur të lirive dhe të drejtave të njeriut. Në fakt, vetëm kur vinë raportet vjetore të avokatit të popullit, apo edhe raportet e progresit të Bashkimit Evropian, kjo temë aktualizohet dhe mbahet në fokus, ndoshta për 2 javë. Fokus sidomos kur konstatohet ndonjë shkelje e lirive dhe të drejtave të njeriut , dhe pastaj kjo është temë e dorës së dytë. Edhe mendoj që një shoqëri që aspiro integrimin në BE , duhet tërë kohën ta ketë vëmendjen e fokusuar tek respektimi sa më i madh dhe më i lartë i standardeve të lirive dhe të drejtave të njeriut.

6. Çfarë rekomandoni të ndryshohet me qëllim të avancimit të zbatimit të Kushtetutës në raport me të drejtat e njeriut?

Po, mendojnë që ndoshta duhet në rastin e ndryshimeve kushtetuese kurdo që behet. Sepse behën amendamente, me përcaktua përgjegjësinë politike të gjitha institucioneve që bëjnë shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Në atë mënyrë që jo vetëm me ngritë në një nivel të përgjegjësisë, po në nivel dhe të përgjegjësisë mosrespektimin e lirive dhe të drejtave të

njeriut. Dhe në këtë drejtim ky obligim duhet të adresohet në radhë të parë të tri pushtetet, tek pushteti legjislativ, gjyqësor dhe ekzekutiv. Por në anën tjetër duhet me procesin e Vetingut, i cili na pret me kërkua prej gjykatave që të tregojnë një performancë më të mire, sa i përket konteksteve që kanë, t'i bëjnë me lirinë dhe të drejtat e njeriut. Dhe t'i trajtojnë ato me prioritet. Domethënë të kërkohet që sistemi gjyqësor të jetë më mobilizues në respektimin e lirive dhe të drejtat e njeriut. Përpos reformave ligjore dhe kushtetuese kjo është edhe çështje e kulturës. Pra, kulturës se përgjithshme se çfarë niveli kulturor e ka një shoqëri, sepse në shtete Skandinave p.sh që janë kampione sa i përket respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut , jo gjithçka është e përcaktuar me ligj dhe me kushtetutë. Po është ndërtuar si standard moral i shoqërive demokratike, që ato duhet të respektojnë dhe të promovojnë plotësisht liritë dhe të drejtat e njeriut. Mund të them që Kosova nuk është më së keqti në rajon, gjendja është shumë më e keqe në Serbi, gjendja është shumë më e keqe në Shqipëri, gjendja është shumë më e keqe në Maqedoni sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut. Duke filluar nga liria e informimit, liria e shtypit, liria e shprehjes se mendimit, liria e lëvizjes, liria e bashkimit, liria e protestës e drejta në peticione e kështu me radhe. Por, Kosova duhet të ecë dhe më shpejt, sepse duhet të fillojë gjitha taborët që ka pas. Edhe me praninë e Bashkësisë Ndërkombëtare për një dekadë të tërë, në proceset e ndërtimit. Përvojat që i ka marrë prej Bashkësisë ndërkombëtare dhe ka mundësinë që të ecë shumë më shpejt. Sektori i të drejtave të komuniteteve është një diskutim kritik dhe është një pikëpyetje se deri kur Kosova mund promovoj diskriminimin pozitiv. Qoftë sistematikisht kemi keqpërdorim të të drejtave kushtetuese sidomos të pakicës Serbe , e cila jo vetëm qe nuk është falënderuese për të drejtat që ua jep Kushtetuta jonë, por ato në vazhdimësi keqpërdorën për të krijuar kriza politike dhe për të penguar shtet ndërtimin e Kosovës.

Intervistën e realizuar me Bekim Sejdiu-Ish gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, njëherit Profesor në Universiteti Publik: "Hasan Prishtina" Prishtinë.

Ai është përgjigjur ;

1. Kosova ka inkorporuar standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Kushtetutë dhe legjislacion. Cilat janë sfidat kryesore të implementimit të këtyre standardeve nga institucionet e Republikës së Kosovës?

Mbrojtja ligjore e të drejtave të njeriut ka tri dimensione. Së pari, duhet të ketë një kornizë ligjore adekuate, duke përfshirë Kushtetutën, ligjet përkatëse dhe për rëndësimin në rendin juridik kombëtar të instrumenteve përkatëse ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Pastaj duhet të ketë mekanizma efikas për zbatimin e kësaj kornize ligjore, duke përfshirë gjykata, institucionet e administratës dhe institucionet tjera ligj zbatuese. Institucionet efikase nënkupton në radhë të parë profesionist që kuptojnë konceptin e të drejtave të njeriut. Së treti, mbrojtja e të drejtave të njeriut mbarët edhe nga niveli i emancipimit shoqëror. Në këtë kuptimin e fundit, të drejtat e njeriut janë barometër civilizues. Pra, tregojnë nivelin e qytetërimit të një shoqërie.

Unë mendoj se Shteti Kosovës është mirë në aspektin e parë, pra atë të legjislacionit. Por sfidat kryesore kanë të bëjnë me profesionalizmin në gjykatave dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat kanë rol kyç në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nuk duhet harruar se mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut është dukuri relativisht e re në vendet ish-komuniste, ndërsa në Republikën e Kosovës një gjë e tillë ka filluar pas vitit 1999. Sfidues është po ashtu sfondi i përgjithshëm socio-kulturor dhe trashëgimia kulturore dhe politike që nuk favorizon konceptin e lirisë së individit dhe mungesën e paragjytimeve identitare.

2. Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, janë inkorporuar drejtpërdrejtë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me çka përbën një rast të veçantë. A mendoni se Kosova e meriton të pranohet si anëtar i barabartë në Këshillin e Evropës?

Një prej padrejtësive të mëdha që i bëhet Kosovës dhe qytetarëve të saj është mos pranimi ende në Këshillin e Evropës. Padyshim që Kosova do anëtarësohet në Këshillin e Evropës dhe kjo, përveç aspektit politik do ketë një efekt thelbësor në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të Kosovës. Kjo duke qenë se me anëtarësim në Këshill të Evropës shtetet me automatizëm behën pjesë e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Kur jemi këtu, duhet potencuar se Kosova është rast unik në këtë aspekt, sepse në mënyrë të njëanshme ka përfshirë dhe zbaton Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, së bashku edhe me instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 22 i Kushtetutës). Kushtetuta e Republikës së Kosovës po ashtu në nenin 53 përcakton detyrimin që të drejtat e njeriut të përcaktuara më Kushtetutë të interpretohen në përputhje me praktikën e GJEDNJ. Në këtë kuadër, e themi më bindje se Kosova është para shumë vendeve anëtare të Këshillit të Evropës për sa i përket aplikimit të standardeve të të drejtave të njeriut të përcaktuara nga KEDNJ.

3. Pranimi i Kosovës në Këshillin e Evropës do të mundësonte që rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut, qytetarët e Kosovës t'i referonin në Gjykatën Evropiane të të drejtave të njeriut në Strasburg. Si do të mund të përballej shteti i Kosovës me këto raste?

Padyshim që anëtarësimi në K i E dhe GJEDNJ do paraqes sfidë për shtetin e Kosovës, por përparësi të madhe për qytetarët e saj. Mendoj se, sidomos në një periudhë fillestare, GEDNJ do gjej shkelje të të drejtave të njeriut të garantuara nga KEDNJ, nga autoritetet e Kosovës. Kjo, në shumicën e rasteve, do ketë implikime financiare sepse në praktikën e GJEDNJ zhdëmtimi në masë të madhe është në formë të kompensimit monetar. Por, kjo do i disiplinonte, në kuptimin metaforik të fjalës, institucionet e Kosovës – sidomos gjykatat. Ato do detyroheshin që të jenë me efikase dhe profesionale. Kjo do të avanconte sistemin e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve. Sidomos një aspekt i punës së sistemit gjyqësor ku Kosova çalon është tej zgjatja e procedurave gjyqësore. Kjo lidhet me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, që garantohet në nenin 6 të KEDNJ. Sikurse ju ka ndodhur shumë shteteve të rajonit, GJEDNJ do i gjej shkelje në vendimmarrjen gjyqësore në Kosovë, në këtë aspekt.

4. Cili është roli i Gjykatës Kushtetuese në zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut në Kosovë?

Në zanafillën e tyre historike, Gjykatat Kushtetuese nuk janë krijuar për të shërbyer si institucione gjyqësore që mbrojnë të drejtat e individëve, por janë themeluar për të garantuar funksionimin kushtetues të ndarjes dhe kontrollit të pushteteve dhe kushtetutshmërinë e ligjeve. Sidoqoftë, në ditët e sotme Gjykatat Kushtetuese janë shndërruar në gardian të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim, edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka rol të pazëvendësueshëm në garantimin se gjykatat e rregullta, sikundër edhe të gjitha institucionet tjera publike në Republikën e Kosovës zbatojnë me konsistencë gradacionet kushtetuese të të drejtave të njeriut. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese ka rolin e një transmetuesi të standardeve të GJEDNJ, në jurisprudencën e Kosovës.

4. Të drejtat e njeriut janë kategori universale, a mendoni se institucionet e Republikës së Kosovës kanë bërë mjaftueshëm në respektimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut?

Gjithmonë ka vend për përmirësime dhe avancime të të drejtave të njeriut nga autoritetet shtetërore. Mund të bëhen hapa legjislativ, siç është, ta zëmë, zgjerimi i mandatit të Avokatit të Popullit, apo krijimi i mekanizmave të veçantë për luftimin e diskriminimit etj. Po ashtu, institucionet shtetërore mund të bëjnë më shumë në promovimin e të drejtave të njeriut-aspektin preventive të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, unë mendoj se Shteti i Kosovës ka bërë hapa gjigand drejt mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

6. Çfarë rekomandoni të ndryshohet apo të plotësohet ?

Mendoj se duhet të fokusohemi më tepër në ngritjen e kapaciteteve profesionale përkitazi me konceptin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e tyre gjyqësore. Nuk duhet harruar se koncepti i të drejtave të njeriut është dinamik dhe, si tillë, kërkon avancim të vazhdueshëm të njohurive profesionale.

Intervistën e realizuar me Avokati i Popullit –“Omduspersoni” është përgjigjur, dhe njëherit kanë dorëzuar raport vjetor si në vijim:

- 1. A mendoni se institucionet e Kosovës kanë bërë mjaftueshëm për respektimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut? E themi standardeve ndërkombëtare pasi që të drejtat e njeriut janë kategori universale dhe Kosova i ka inkorporuar instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejtë në Kushtetutë dhe legjislacionin pozitiv?**

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut është obligim i çdo shteti. Ato duhet t’iu përmbahen marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe t’i ratifikojnë dhe t’i zbatojnë ato.

RKS-ë i ka përfshirë në Kushtetutën e saj shumicën e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare më të rëndësishme për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat njëkohësisht janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë. Në rast konflikti ato kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike të Kosovës. Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës shprehimisht garantohet zbatimi i drejtpërdrejtë i instrumenteve ndërkombëtare,

2.A ka Kosova mekanizma institucional të mjaftueshme që merrem me monitorimin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut?

RKS-ë, në mënyrë që të monitorojë zbatimin e garancive për të drejtat e njeriut të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ka krijuar disa mekanizma të cilët janë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Disa nga institucionet kryesore janë:

- 1) Kuvendi i Republikës së Kosovës, edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktima Seksuale të Luftës dhe Peticione si një nga komisionet e përhershme me mandatin për të hartuar ligje që ndërlidhen me të drejtat e njeriut dhe për të monitoruar implementimin e atyre ekzistuese.

- 2) Institucioni i Avokatit të Popullit.

- 3) Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos diskriminim (ZQM),

4) Agjencia për Barazi Gjinore, është përgjegjëse për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, në Kosovë.

2. Në raportet e juaja hulumtuese, a keni gjetur raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut nga institucionet e Kosovës? Nëse po, a i keni adresuar këto raste të organet përgjegjëse? A janë evituar shkeljet e tilla të raportuara?

Institucioni i Avokatit të Popullit të gjitha rastet e shkeljeve i adreson përmes dy mënyrave:

- 1) Përmes Letër Rekomandimeve dhe Raporteve Ex. Officio (me vetë-iniciativë) të cilat i adreson drejtpërdrejt tek institucionet përgjegjëse
- 2) Përmes Raportit Vjetor, i cili i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe paraqet situatën e përgjithshme me të drejtat e njeriut në vend nga prizmi i punës së Avokatit të Popullit.

Këto raporte janë publike në ueb faqen e Institucionit të Avokatit të Popullit: www.oik-rks.org

3. A e penalizon procesin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë, mos anëtarësimi në Këshillin e Evropës?

Mos-anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës paraqet një hendek të madh në procesin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Kosova edhe pse e ka përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Kushtetutë, qytetarët e saj nuk mund t'i drejtohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nëse konsiderojnë se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre nga shteti i Kosovës, apo cilido shtet anëtar i Këshillit të Evropës.

4. Cilat janë sfidat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga institucionet e Kosovës?

Një ndër sfidat që po na përcjell kohëve të fundit është mos nxjerrja e akteve nënligjore që po e pamundëson zbatimin e rregullt të ligjit nga ana e institucioneve të vendit të cilat ndikojnë në të drejtat e qytetarëve. Sfidë tjetër mbetet mungesa e vet kontrollit brenda institucioneve për të luftuar dukuritë negative në këtë rast vet trajtimit të qytetarëve nga ana e institucioneve kur ata paraqesin ndonjë kërkesë për të realizuar ndonjë të drejtë. Sfidë tjetër është mbrojtja e të drejtave gjyqësore për shkak të zvarritjeve të procedurave në gjykatë, me arsyetimin se ka ngarkesë të madhe të lëndëve, por si rrjedhojë krijohet

pamundësia që të trajtohen në kohë të arsyeshme këto lëndë në mënyrë që t'u ofrohen qytetarëve të Republikës së Kosovës gjykim të drejtë e të paanshëm.

5. Çfarë rekomandoni të ndryshohet?

Duhet të ketë një kontroll më të shtuar parlamentar sa i përket zbatimit të ligjeve ndërsa qeveria duhet të nxjerr në mënyrë më të shpejtë aktet nënligjore. Proceset e ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve duhet të jenë të atilla që mos të lejojnë ndërhyrje nga grupet e interesit por të punohet që ligjet të jene të zbatueshme në praktikë. Sa i përket sistemit gjyqësor, Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon që disa vite me radhë tek Kuvendi i Kosovës që të hartohet një ligj që të njihet e drejta për kompensim palëve të cilëve iu zvarritet procedura gjyqësore në kohë të paarsyeshme, e që është në pajtueshmëri edhe me standardet e përcaktuar me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjë që deri më tani nuk ka ndodh. Sa i takon shëndetësisë, kemi dal me raport me rekomandime, ku kemi kërkuar shtim të buxhetit për plotësim të punëve, disa veprimeve konkrete që do të kishin përmirësuar situatën, si krijimi i qendrës së të dhënave për kartelat mjekësore të integruara që padyshim kjo mungesë ka shkaktuar vështirësi gjatë pandemisë.

6. Dhe në fund ju lutem që përmes administratës suaj, të me i siguron (Statistikat në mënyrë tabelore) rastet e trajtuara dhe përgjigjet (2019-2021)

Statistikat lidhur me rastet e trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit si dhe rekomandimet dhe statusi i zbatimit të tyre, janë të paraqitura në mënyrë tabelore në fund të çdo raporti vjetor, të cilat mund t'i gjeni në këtë link: <https://oik-rks.org/raportet/raportet-vjetore/>

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit konsideron se duhet të merren veprime urgjente që në Gazetën Zyrtare të vendosen njoftimet për të gjitha ligjet, të cilat, pjesërisht apo në tërësi, janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, për shkak se nuk janë në pajtim me Kushtetutën dhe se çdo vazhdim i zbatimit të tyre përbën shkelje të Kushtetutës.

-Sistemi gjyqësor

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se çdokush ka të drejtë për mbrojtje gjyqësore në rast të shkeljes apo të mohimit të ndonjë të drejte, që është e garantuar me Kushtetutë dhe të drejtën për mjete efektive juridike, nëse konstatohet se e drejta i është shkelur. Secilit i është garantuar e drejta për gjykim të pavarur, të paanshëm dhe të bazuar në ligj. Mbrojtjen e të drejtave të njeriut në gjykatë e plotëson edhe kontrolli gjyqësor i administratës apo kontrolli i ligjshmërisë së akteve të organeve të administratës, me të cilat vendoset për të drejtën, obligimin apo interesin e bazuar në ligj. Me vendosjen e kësaj mbrojtjeje, qytetarët në masë të caktuar janë të siguruar nga aktet e paligjshme të administratës. Një sfidë e vazhdueshme e sistemit gjyqësor mbetet moszbatimi i standardeve për të drejtat dhe për liritë e njeriut, siç parashihet me nenin 53 të Kushtetutës, sipas të cilit interpretimi i të drejtave dhe i lirive themelore të njeriut duhet të bëhet në pajtim me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj). Referimet në praktikën e GjEDNj-së janë të pakta dhe, në rastet kur kjo ndodh, ato bëhen në mënyrë të përgjithësuar, por pa përcaktuar në mënyrë konkrete vlerësimet e GjEDNj-së dhe lidhshmërinë e rrethanave të rastit në praktikë.

Përmbauesit privatë

Të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e që në vete ngërthen edhe çështjen e vendimeve të formës së prerë në procedurën administrative dhe gjyqësore, përmbauesit privatë e kanë fuqizuar duke e përmirësuar nivelin e ekzekutimit të vendimeve administrative dhe gjyqësore³⁸ dhe qytetarëve u është ofruar mundësi më efikase dhe efektive në realizimin e të drejtave të tyre. Por në disa raste përmbauesit privatë i kanë tejkaluar normat ligjore, të cilat i përcaktojnë kufizimet dhe përjashtimet lidhur me ekzekutimin e vendimeve, ³⁹ duke lëshuar urdhra përmbauesit për ekzekutimin e vendimeve në bankat komerciale, me ç'rast kanë bllokuar llogaritë bankare të ankuesve.

Avokati i Popullit gjatë hetimit ka vërejtur se palëve u janë bllokuar llogaritë bankare nga përmbauesi privat, për shkak të mos shlyerjes së borxheve, ndërsa kanë qenë shfrytëzues të pensioneve dhe këto të hyra janë bllokuar në procesin e ekzekutimit në kundërshtim me ligjin, ku përcaktohen kufizimet ligjore për shumat të cilat nuk mund të jenë objekt i ekzekutimit.

Pas ndërmjetësimit të Avokatit të Popullit me përmbauesin, për riprogramimin e borxhit, është arritur zgjidhja e çështjeve të ankuesve që llogaritë bankare të tyre të zhbllkohen dhe ndalesat të bëhen në pajtim me ligjin.

Pushteti ekzekutiv

Qeverisja e mirë, miradministrimi dhe të drejtat e njeriut ndërlidhen në atë mënyrë që fuqizojnë njëra tjetrën. Puna e organeve shtetërore lidhet ngushtë me të drejtat dhe me liritë e njeriut. Institucioni i Avokatit të Popullit, si mekanizëm i kontrollit të administratës shtetërore, ka rol të rëndësishëm në forcimin e përgjegjshmërisë së administratës shtetërore, gjithashtu mund të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së administrimit nga zbulimi i rasteve të “keqadministrimit” dhe ngritjen e vetëdijes së nëpunësve civilë në pritjet e publikut në lidhje me qeverisjen e mirë dhe miradministrimin, duke ndikuar që sistemi administrativ të jetë më transparent dhe më i qasshëm për të gjithë qytetarët.

Vlen të përmendet këtu se një numër i konsiderueshëm i ankesave ndaj pushtetit ekzekutiv kanë të bëjë me kufizimin e qasjes në dokumentet publike.

Avokati i Populli ka hapur për hetim 29 raste ex officio, prej të cilave një numër i konsiderueshëm i çështjeve kanë të bëjë me punën e ekzekutivit në të dyja nivelet qeverisëse, lidhur me të cilat Avokati i Popullit ka nxjerrë rekomandime apo ka shprehur qëndrimet e tij, me ç’ rast vlen të përmenden rastet në vijim:

- detyrimet pozitive të shtetit përkitazi me mbrojtjen nga dhuna në familje për të drejtën në jetë,
- detyrimet pozitive të garantuara me Kushtetutën e RKS-sës, si dhe me nenin 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
- çështja e fëmijëve në situatë rruge;
- vlerësimi i sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale në Kosovë;
- situata e personave me aftësi të kufizuara në komunën e Gjilanit;
- rritja e numrit të zyrtarëve policorë në Janjevë;
- mungesa e mjeteve juridike efektive për zgjidhjen e kontesteve të punës nga nëpunësit civilë

dhe nga kandidatët për pranim në shërbimin civil- trajtimi i personave me HIV dhe AIDS në Kosovë etj.

Përveç çështjeve të sipërpërmendura, Avokati i Popullit ka nxjerrë rekomandime apo ka shprehur opinionet e tij lidhur me ankesat e paraqitura nga personat fizikë a juridikë, e që kanë të bëjnë me:

- harmonizimin e Ligjit nr.06/L-012 për Kryeqytetin e Republikë së Kosovës, Janë 41 rekomandime që Avokati i Popullit ia ka drejtuar qeverisë dhe resorëve të saj, prej të cilave deri më tani janë zbatuar vetëm 9, ndërsa të tjerat nuk janë zbatuar ose janë në pritje për zbatim. Duhet sqaruar këtu se Avokati i Popullit e ndan çështjen e zbatimit të rekomandimeve dhe përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit gjatë hetimit të rasteve. Me përgjigjen në kërkesat e Avokatit të Popullit, gjatë fazës së hetimit situata është relativisht e kënaqshme. Megjithatë, disa nga resorët qeveritar janë krejtësisht të papërgjegjshëm ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit, me ç' rast duhet të veçohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.

Sa i përket qeverisjes lokale, Avokati i Popullit ka adresuar 18 rekomandime, prej të cilave janë zbatuar vetëm 3, ndërsa përgjegjshmëria e komunave ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit gjatë fazave të hetimit është mjaft e kënaqshme. Avokati i Popullit thekson se shumë nga çështjet e paraqitura në Raportin Vjetor të vitit 2018, sa i përket pushtetit ekzekutiv, kanë mbetur të pa trajtuara nga autoritetet përkatëse, por edhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh se Raporti Vjetor i vitit 2018 nuk është shqyrtuar nga Kuvendi, megjithëse është paraqitur brenda afatit.

Reforma në administratën publike Avokati i Popullit përshëndet iniciativën për rregullimin e sektorit publik për nga aspekti organizativ ashtu edhe për nga aspekti i rregullimit së çështjes së pagave, duke çmuar këtu edhe ndihmën e Bashkimit Evropian në reformën e administratës. Një administratë publike e reformuar në pajtim me Kushtetutën, parimin e ndarjes së pushteteve dhe sundimit të ligjit përbën bazamentin e funksionimit të shtetit. Sidoqoftë, sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, pakoja e ligjeve për reformën e administratës, në veçanti Ligji nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe Ligji nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, duket se nuk janë në pajtim me Kushtetutën dhe as me sundimin e ligjit në përgjithësi.

Duhet të përmendet fakti se Avokati i Popullit, në raportin e vitit 2017, e kishte njoftuar Kuvendin për qëndrimet e tij rreth rritjes së pagave të kabinetit qeveritar, për të cilat akoma konsideron se ka qenë e pabazuar në ligj dhe në kundërshtim me Kushtetutën. Një rritje e tillë

e pagave ka shkaktuar efekt negativ në sektorin publik, me ç' rast është rritur presioni mbi qeverinë, por edhe mbi Kuvendin, me rastin e hartimit të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik dhe se ky ligj ka pësuar ndryshime të atypëratyshme duke degraduar kështu vetë qëllimin e ligjit dhe duke e vënë në rrezik qëndrueshmërinë buxhetore dhe vetë zbatimin e tij.

Intervistën e realizuar me Ministrin e Administratës Publike, njëherit përfaqësues i minoritetit Ashkali dhe Egjyptas z. Elbert Krasniqi.

1. RKS-ë ka shpallur pavarësinë më 17 shkurt 2008 në përputhje me Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës – Pakoja e Ahtisaarit. Pakoja është inkorporuar në Kushtetutën e Kosovës. A mendoni Kushtetuta e Kosovës i përmbush standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në lidhje me komunitetet jo shumicë?

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është paraparë që instrumente/konventa të ndryshme ndërkombëtare që kryesisht ndërlidhen me të drejtat e njeriut, zbatohen drejtpërsëdrejti edhe në Republikën e Kosovës. Prandaj, nëse mund të ketë zbrazëti eventuale në çështjet që ndërlidhen me komunitetet jo-shumicë, të njëjtat mbulohen nga këto instrumente.

2. A respektohen të drejtat e komuniteteve në Republikën e Kosovës?

Mendoj që ende ka shumë hapësirë për përmirësim dhe angazhim. E mira është që ekziston një infrastrukturë e konsiderueshme ligjore, për të cilën duhet të ndërmerren edhe më shumë veprime dhe të përfshihen më shumë artere, në mënyrë që të arrihen nivel i kënaqshëm i zbatueshmërisë. Problemet me të cilat ballafaqohen komunitet jo – shumicë në Republikën e Kosovës janë shumë specifike, por në të njëjtën kohë ka edhe probleme të përbashkëta me komunitetin pakicë, siç është çështja e punësimit.

3. A mendoni se respektohet kuota e përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në institucionet e Republikës së Kosovës?

Në përgjithësi mendoj se respektohet, por duhet kujdes i shtuar që të përfshihen sa më shumë përfaqësues nga komunitetet e ndryshme pakicë. Sidoqoftë, për këtë çështje, është më mirë të merren informacionet dhe statistikat zyrtare nga institucionet kompetente.

4. A stimulohen në kuptimin financiar përmes projekteve të ndryshme komunitetet; Rom, Ashkali dhe Egjipt as?(statistika mundësisht)

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në njërën ndër thirrjet e saj për mbështetje financiare të Komunave, në programin për zhvillim socio-ekonomik ka bërë thirrje për mbështetje të investimeve që përmirësojnë kushtet sociale dhe ekonomike të pjesëve në të cilat banojnë komunitet pakicë. Disa Komuna kanë aplikuar dhe kanë përfituar nga ky program, i cili qëllim kryesor ka pasur përkrahjen e këtij komuniteti. Sigurisht që ne jemi duke punuar edhe aktualisht në këtë drejtim.

5. A janë raportuar raste të diskriminimit në punësim në institucionet e Republikës së Kosovës për shkak të përkatësisë etnike? Nëse po, a janë adresuar këto raste për zgjidhje? (statistikë mundësisht)

Në periudhën në të cilën unë jam Ministri në krye të këtij institucioni, nuk ka pasur raportime të tilla zyrtare.

6. Çka kishit ndryshuar në Kosovë në lidhje me respektimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë?

Janë disa çështje veçanërisht të rëndësishme të cilat Ministri dhe Ministria ia dreson në kuptim të avancimit të rolit të komuniteteve jo-shumicë, e që si një ndër më primaret është përfshirja në edukim, duke filluar që nga edukimi i hershëm (kopshte) dhe po ashtu shkollimit të vajzave e grave të këtij komuniteti. Duhet më shumë mbikëqyrje e këtij fenomeni dhe ngritje të vetëdijesimit në raport me këtë çështje.

-Intervista me Nënkryetarin e komunës së Kamenicës Zot. Bojan Stamenkovic-

1.RKS-ë ka shpallur Pavarësinë më 17 shkurt 2008 në përputhje me Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës – Pakoja e Ahtisaarit. Pakoja është inkorporuar në Kushtetutën e Kosovës. A mendoni se Kushtetuta e Kosovës i

përmbush standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në lidhje me komunitetet jo shumicë?

1/1 Republika Kosova je 17 Februara 2008 godine proglasila nezavisnost u skladu sa sveobuhvatnim predlogom za rešavanja statusa Kosova – Ahtisarijevim Paketom. Paket je ugrađen u Ustav Kosova. Da li mislite da Ustav Kosova ispunjava međunarodne standarde ljudskih prava u odnosu na nevećinske zajednice?

Iako najveći broj kosovskih Srba nije srećan zbog proglašenja nezavisnosti Kosova, u svakom slučaju svi oni koji su ostali da žive na ovim prostorima, nemaju mogućnost da takvo realno stanje promene. To podrazumeva da se bore za što bolje uslove u ovakvim okvirima Kosova. Ustav Kosova i svi zakoni koji su usvojeni od strane Skupštine Kosova i međunarodni dokumenti na koje se obavezalo Kosovo, trebali bi da budu garant za sva prava i sloboda na Kosovu. Znamo da je doneto niz zakonskih propisa koji se tiču garancije prava i sloboda nevećinskih zajednica, ali nažalost njihova implementacija u praksi u velikom broju nije ispoštovana. Konkretno zakoni kao napisana slova na papiru imaju dosta dobre odredbe koje bi trebale da garantuju standarde ljudskih prava, ali nisu dovoljno primenjena i problem je što nema ili se monitoring nad tim zakonima ne sprovodi u dovoljnoj meri.

Edhe pse shumica e serbëve të Kosovës nuk janë të kënaqur me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, sido që të jetë, të gjithë ata që kanë mbetur të jetojnë në këtë zonë nuk kanë mundësi të ndryshojnë një situatë kaq reale. Kjo do të thotë të luftojmë për kushte më të mira në një kornizë të tillë të Kosovës. Kushtetuta e Kosovës dhe të gjitha ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe dokumentet ndërkombëtare ndaj të cilave Kosova angazhohet, duhet të jenë garantues i të gjitha të drejtave dhe lirive në Kosovë, por fatkeqësisht zbatimi i tyre në praktikë në masë të madhe nuk respektohet. Konkretnisht, ligjet si letrat e shkruara në letër kanë dispozita mjaft të mira që duhet të garantojnë standarde të të drejtave të njeriut, por ato nuk zbatohen sa duhet dhe problemi është se nuk ka monitorim në masë të mjaftueshme.

2. Komuniteti serb në Kosovë në bazë të Pakos Ahtisaari të inkorporuar në Kushtetutë, ka fituar të drejta shtesë dhe i janë garantuar pozita udhëheqëse në institucionet e Republikës së Kosovës. Sa jeni të kënaqur me privilegjet që u janë dhënë me Kushtetutën e Komuniteti serb në Kosovë në bazë të Pakos Ahtisaari të inkorporuar në

Kushtetutë. Ka fituar të drejta shtesë dhe i janë garantuar pozita udhëheqëse në institucionet e Republikës së Kosovës?

2/2 Srpska zajednica na Kosovu, na osnovu Ahtisarijevog paketa ugrađenog u Ustav, stekla je dodatna prava i zagartovana su im vodeće pozicije u institucijama Republike Kosova. Koliko ste zadovoljnisa privilegijama koje su date Srpskoj zajednici sa Ustavom na Kosovu na osnovu Ahtisarijevog paketa ugrađenog u Ustav, stekla je dodatna prava i garntovane su vodeće pozicije u institucijama u Republici Kosova.

Da, postoje određene institucije u kojima su zagartovana mesta i pozoicije Srba u njima.Svedoci smo da se i ova obaveza nedovoljno poštuje i ne sprovodi,tamo gde se poštuje imamo samo formalne funkcije ,ali veoma nizak uticaj sa tih pozicija ,gde najčešće pozicije služe za zadovoljavanje individualnih potreba ili ti malog broja ljudi.Ne to što čovek koji bude na takvoj funkciji ne želi nego nemože,iz raznih razloga nemogu se ostvariti kolektivna prava i interesi zajednica.Čast izuzetcima gde donekle dobro funkcioniše.

Po, ka disa institucione në të cilat janë të garantuara vendet dhe pozitat e serbëve në to. Ne jemi dëshmitarë se ky obligim është i pamjaftueshëm i respektuar dhe i pazbatuar, aty ku respektohet kemi vetëm funksione formale, por ndikim shumë të ulët nga ato pozita, ku shumica e pozitave shërbejnë për plotësimin e nevojave individuale ose të një numri të vogël njerëzish. Jo se një person që është në një pozicion të tillë nuk dëshiron por nuk mundet, për arsye të ndryshme, të drejtat dhe interesat kolektive të komuniteteve nuk mund të realizohen. Respekt të veçuarve ku deri diku funksionojnë mirë.

3.A mendoni se respektohet kuota e përfaqësimit të komuniteteve Jo shumicë në institucionet e Republikës së Kosovës?

3./3 Da li mislite da se poštuje kvota zastupljenosti nevećinskih zajednica u institucijama Republike Kosova?

Na centralnom nivou institucija taj zakonski procenat nije ispoštovan u najvećem delu slučajevima,posebno ne u mnogim institucijama,Agencijama i slično.

Na lokalnom nivou je taj procenat veći i razlikuje se od opštine do opštine.

Në nivelin qendror të institucioneve, kjo përqindje ligjore nuk është respektuar në shumicën e rasteve, veçanërisht jo në shumë institucione, si dhe në agjenci të ngjashme.

Në nivel lokal, kjo përqindje është më e lartë dhe dallon nga komuna në komunë.

4. A janë raportuar raste të diskriminimit në punësim në institucionet e Republikës së Kosovës për shkak të përkatësisë etnike? Nëse po, a janë adresuar këto raste për zgjidhje?

4/4 Da li su prijavljeni slučajevi diskriminacije pri zapošljavanju u institucijama Republike Kosova zbog etničke pripadnosti? U slučaju da jesu, da li su ovi slučajevi upućeni za rešavanje?

